

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

“TOPONIMIA SHQIPTARE
NË MAQEDONI”

(sesion shkencor – 03.06.2013)

- V -



Shkup, 2014

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi V – 2014

Biblioteka: **SCUPI**

Kryeredaktor:
Dr. Zeqirija Ibrahimi

Këshilli redaktues:
Dr. Shëfqet Zekolli
Dr. Sefer Tahiri
Dr. Mixhait Pollozhani
Mr. Hidajete Azizi

Sekretar i redaksisë:
Mr. Agron Salih

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright© ITSHKSH, 2014
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–14–1
www.itsh.edu.mk

Ky libër u shtyp me ndihmën e Komunës së Çairit

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

“TOPONIMIA SHQIPTARE
NË MAQEDONI”

(sesion shkencor – 03.06.2013)

- V -

Shkup, 2014

TRYEZA E LËNDËS:

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM	7
AVZI MUSTAFA: TOPONOMIA DHE MIKROTOPONOMIA E REKËS SË EPËRME	9
QEMAL MURATI: DIKTATURA NË TOPONIMI.....	27
XHEMALUDIN IDRIZI: PËR ETIMOLIGJINË E DISA TOPONIMEVE TË FSHATRAVE TË RRETHIT TË SHKUPIT	43
BEGZAD BALIU: TOPONIMIA SHQIPTARE NË MAQEDONI NË STUDIMET ONOMASTIKE	57
ASLLAN HAMITI: TOPONIMIA DHE MIKROTOPONIMIA SHQIP- TARE NË MAQEDONI – DËSHMI E AUTOKTONISË	101
IZMIT DURMISHI: VËSHTRIME FONETIKE MBI TOPONIMINË E POLLOGUT TË EPËRM	125
ISMET OSMANI: TOPONIMIA E DERVENIT TË SHKUPIT	137
MUSTAFA IBRAHIMI: OJKONIMET ZYRTARE DHE ATO BURIMORE TË SHQIPTARËVE NË RAJONIN E PELAGONISË (PRILEP, DOLLNEN, RESNJË DHE KRUSHOVË)	145
NAIM HALIMI: TOPONIMET NË RAJONIN E KUMANOVËS – DËSHMI PËR AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE	157
BERTON SULEJMANI: PËRDORIMI I TOPONIMEVE SHQIPTARE NË TEKSTET SHKOLLORE SHQIPE (1981 – 1989) TË BOTUARA NË MAQEDONI	165
SKENDER ASANI: MBI DISA EMËRTIME TË LAGJEVE TË SHKUPIT NË SHEK.XIX – XX	171
ZEQIRIJA IBRAHIMI: STANDARDIZIMI I TOPONIMISË SHQIPTARE NË MAQEDONI	177
BESNIK EMINI: DISA ASPEKTE TË MIKROTOPONIMEVE NË HAPËSIRËN E FSHATIT ÇELLOPEK TË TETOVËS	185
AGRON SALIHI: TOPONIMIA E FSHATIT SLLATINË TË TETOVËS	191

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM

Toponimia, si një çështje që i tejkalon kornizat e studimeve gjuhësore dhe prek edhe në segmente të tjera të organizimit të jetës shoqërore, veçmas është temë aktuale dhe e ndjeshme në rrethana të Maqedonisë, ku – duke jetuar në një shoqëri multientike – shpeshherë ka qenë arsye që ka përçuar edhe pasoja të padëshirueshme afatgjata.

Megjithatë, pa ndërhyrë në dimensionet e tjera të toponimisë, por duke dashur ta japim kontributin tonë shkencor në trajtimin e kësaj teme në kuadër të rrethanave të vendit tonë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, më 3 qershor të vitit 2013 organizoi një sesion shkencor me temë “Toponimia shqiptare në Maqedoni”. Ideja themelore e këtij sesiioni ishte që në një tryezë të ulen bashkë specialistët e kësaj fushe, sidomos gjuhëtarët, por edhe historianët, që të diskutojnë rreth gjendjes së toponimisë shqiptare në Maqedoni, për ruajtjen e kultivimin e saj, por edhe për afirmimin e studimeve në këtë fushë. Megjithëse në këtë sesion kishim ftuar edhe kolegë gjuhëtarë maqedonas, që bashkërisht të diskutojnë për këto çështje, kësaj radhe ata munguan.

Me këtë rast u lexuan gjithsej 14 kumtesa nga studiues të të gjitha institucioneve shkencore e arsimore më relevante në vend, por kishim edhe mysafirë nga Kosova, ndërsa mesazhi i përgjithshëm ishte se toponimia duhet të shkëputet nga interpretimet politike e të tjera, ndërsa për atë duhet të diskutojnë, të propozojnë dhe të marrin vendime vetëm specialistët e saj.

Sidoqoftë, ashtu siç tashmë e kemi bërë traditë, kumtesat e këtilla po botohen në një vëllim të veçantë të edicionit SCUPI, i cili është krijuar enkas që ta plotësojë këtë boshllëk. Në këtë mënyrë jemi të bindur se ne si institut kemi hapur një faqe të re në këtë fushë, ndërsa mbetemi me shpresë se tash e tutje edhe faktorët e tjerë në vendin tonë, qofshin shkencorë a jo, do të reflektojnë më ndryshe kur të jetë fjala për toponiminë shqiptare në Republikën e Maqedonisë.

Shkup, mars 2014

Redaksia

AVZI MUSTAFA

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski" – Shkup

TOPONOMIA DHE MIKROTOPONIMIA E REKËS SË EPËRME

Studiues të ndryshëm krahinën e Dibrës e ndajnë në dy pjesë, në Dibrën e Epërme dhe Dibrën e Poshtme. Një ndarje të këtillë bën edhe Myler, i cili gjithashtu e ndan atë në dy krahina, në Dibrën e Epërme dhe Dibrën e Poshtme¹.

Në Lindje të Dibrës, rrethuar nga malet Korab, Velivar dhe Kërçin, në të dyja anët e lumit Radika, shtrihet një krahinë shumë e bukur e magjepsëse, me shumë ujë, kullota të shumta, lisa e klimë të mirë.

Në këtë krahinë, gjegjësisht në fshatrat e Rekës, jetonin shqiptarë që i përkisnin besimit të krishterë ortodoks, të cilët më vonë u konvertuan në myslimanë, por të gjithë ishin shqiptarë. Kjo përçarje ishte rezultat i shumë grabitjeve e sulmeve të ndryshme, që zgjatën deri në shekullin XX. Masakrimet, djegiet e vjedhjet bënë, ashtu siç shkruan një gazetë, "...u shkret fare prej rrëmbimesh.... rrembejin, repin, pjekin". Prandaj ata filluan të quhen të shkretë (Shkretë)².

Fshatrat e kësaj zone janë të vendosura në shpatet e malit Korab dhe të maleve lidhur me të, si malet e Kabashit (2395 m), Bradasit (2168m), Lerit (2197m), Ostricës (1717m) dhe malit të Kus–Babait (2200m).

¹ Deferi i Dibrës dhe i Matit, Stamboll, dosje 508 pranë AIH të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

² "Shqypja e Shqypnis, Sofje, 21. 10.1909, nr. 10

Territori i Rekës së Epërme përfshin rrjedhën e epërm të Lumit Radikë, ku janë të vendosura 16 fshatra: Beliçica, Bibaj, Bogdi, Grekaj, Kiçinica, Krakornica, Nishtrova, Niçpuri, Nivishta, Rinnica, Senca, Tanushaj, Vau, Valkovia, Vërbeni, Zhuzhnja, Dufi, Stezimiri, Reçi, Spiroglica, Bibaj, Grekaj e etj. Përgjatë rrjedhës së epërme të lumit Radikë dhe në shpatet e maleve shtrihen së paku 17 fshatra të banuara me popullsi shqipfolëse. Kjo krahinë e vogël nga veriu kufizohet me malin Vraca dhe Republikën e Kosovës, nga lindja me malet Bistrica e Kozhuf dhe Liqenin e Mavrovës, nga jugu mbaron me fshatin Sencë, i cili shtrihet në anën e majtë të lumit Radikë dhe nga perëndimi ka përballë malin e Korabit dhe krahinën simotër të Lumës³.

Rekën e Epërme, në bazë të një dokumenti të kohës, ku përmendet krahina e Dibrës, e përmend Pukëveli, por edhe regjistrat turk të vitit 1467 e ndajnë gjithashtu krahinën e Dibrës në dy pjesë Dibra e Poshtme dhe Dibra e Epërme⁴. Po ashtu kemi shfrytëzuar edhe defterët e shek. XV– XVI, të përkthyer e të botuar nga Arkivi i Maqedonisë, të përkthyesve nga Dr. Aleksandër Stojanovski dhe Metodija Sokollovski, edhe pse nuk përjashtohet mundësia e subjektivizmit të përkthyesve dhe redaksive të tyre.

Të dhënat janë për fshatrat: Beliçica, Bogdevo, Volkovi, Vërbena, Girqan, Kiçinica, Krakornica, Nishtrova, Niçpuri, Rinnica (Luminca siç e quajnë anasit), Senca dhe Zhuzhla ose Zhuzhnja. Për secilin fshat, në bazë të defterëve, do të japim një pasqyrë për vendbanimin dhe popullsinë, ashtu siç janë të shkruar, përkthyer dhe adaptuar në gjuhën maqedonase.

³ Nebi Dervishi Dëshmitë e Rekës shqiptare sipas regjistrimeve nëpër shekuj

⁴Cit. sipas R. Matotës, Josif Bageri, f. 4

BELIÇICA – në regjistrimin e vitit 1467 është shënuar me emrin Bliçicë. Është fshat i krishterë, i pabanuar (hali). Shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1519 numëronte 18 familje; në vitin 1536–1539 janë regjistruara 18 familje, ndërsa në regjistrimin e vitit 1583 fshati futen në Nahinë e Rekës së Epërme (të Madhe), që bënte pjesë në sanxhakun e Ohrit dhe numëronte 30 familje të krishtera me 56 persona. Fshati posedonte 4 mullinjtë.

BOGDEVA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 Bogdeva është “has” i Karagjoz beut dhe hyn në përbërje të Vilajetit të Rekës; në regjistrin e vitit 1467 është shënuar me emrin BOGDV. Në regjistrimin e vitit 1519, fshati është regjistruar me emrin BOGDEVË, me 16 familje të krishtera, që nuk ndryshojnë as në regjistrimin e vitit 1536–1539; ndërkaj në regjistrimin e vitit 1583 fshati shtrihet në Rekën e Madhe ose të Epërme, hyn në Nahinë e Rekës dhe bën pjesë në Sanxhakun e Ohrit. Fshati numëronte 10 familje të krishtera.

VOLLKOVA – në vitin 1467 fshati ka qenë derven e i krishterë; shtrihej në verilindje të Dibrës, i takonte Nahisë së Rekës. Në defterin themeltar të këtij viti është regjistruar në kuadër të Vilajetit të Rekës si “has” i “zaimit”. Pra, bënte pjesë në Zaimet e Rekës së Karagjoz Beut dhe numëronte 6 familje të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1519 i ka të regjistruara 13 familje të krishtera. Fshati Vollkovi në vitet 1519–1583 ishte derven, shtrihej në Rekën e Epërme ose të Madhe, pranë fshatrave Tërnica e Debovë (fshat i zhdukur). Edhe në regjistrimin e vitit 1583 fshati Vollkovi është fshat derven, që bën pjesë në Nahinë e Rekës.

GIRQANI ose **GREKAJ** – është fshat i krishterë. Shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës, në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Në regjistrimin e viteve 1536–1539 fshati ka të evidentuar 11 familje, ndërsa në vitin 1583 fshati numëronte 20 familje dhe ka pasur 2 mullinj, që kanë punuar tërë vitin.

VËRBENI – shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati ka numëruar 9 familje të krishtera, me 722 akçe të ardhura dhe ishte “has” i Karagjoz Beut. Është shënuar me emrin VIRBNI. Në regjistrimin e vitit 1536/39 fshati numëronte 93 familje të krishtera dhe 1 familje myslimane. Në defterin osman për Sanxhakun e Ohrit të vitit 1583, mes tjerash, thuhet se: “fshati është i evidentuar me emrin VIRBEN me 50 familje të krishtera dhe 20 familje myslimane, prej të cilave 13 të islamizuara; fshati shtrihet në verilindje të Dibrës, ndërmjet fshatrave Shtirovicë dhe Sencë.” Me këtë regjistrim fshati ka numëruar 165 persona ose 120 familje të krishtera.

KIÇINICA – është derven dhe kryesisht i krishterë. Ai shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 ka qenë i shkretuar e i pabanuar, ndërsa në vitin 1519 fshati ishte mera dhe në të ishin vendosur 8 familje të krishtera. Pra, fshati shtrihej në Rekën e Epërme (të Madhe). Në regjistrimin e vitit 1583 fshati Kishnicë është derven dhe ka ruajtur e mirëmbajtur rrugën Tetovë–Dibër dhe i takon Nahisë së Rekës që hynte në Sanxhakun e Ohrit dhe ka të evidentuar 12 persona ose 6 familje të krishtera.

KRAKORNICA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati

ka qenë “has” i Karagjoz Beut dhe bënte pjesë në Vilajetin e Rekës. Ai ka numëruar 3 familje të krishtera. Në vitin 1519 fshati ka numëruar 12 familje çifte të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1583 fshati Kakornicë është në kuadër të Nahisë së Rekës, që shtrihej në verilindje të Dibrës në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Fshati ka numëruar 33 persona, 1 familje jobesimtare, 20 familje të krishtera dhe aty ka punuar 1 mulli .

NISTROVA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në Vitin 1467 Nistrova është “has” i Karagjoz Beut, bënte pjesë në kuadër të Vilajetit të Rekës dhe numëronte 11 familje të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1519 fshati është evidentuar me emrin NSTROVË dhe ka numëruar 36 familje të krishtera. Në vitin 1583 fshati Nistrovë, hyn në përbërje të Nahisë së Rekës, në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Numëron. Ai numëronte 83 persona, 70 familje të krishtera dhe ka pasur 3 mullinj që kanë punuar tërë vitin.

NIÇPURI – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës. Ai bën pjesë në kuadër të Nahisë së Rekës. Në vitin 1467 është “has” i Karagjoz Beut dhe ka qenë në kuadër të Vilajetit të Rekës. Në regjistrimin e vitit 1536/39 fshati ka numëruar 16 familje. Në vitin 1583, fshati Niçipur është në kuadër të Nahisë së Rekës në Sanxhakun e Ohrit, numëronte 28 persona, 20 familje, 2 tjerretore leshi dhe 1 mulli.

RIBNICA – është fshat i krishterë në Nahinë e Rekës dhe shtrihet në verilindje të Dibrës. Në shek. XV–XVI kanë qenë dy fshatra fqinje, Ribnica e Madhe (Byjuk Ribnica) dhe Ribnica e Vogël (Kuçuk Ribnica). Në vitin 1467 Rinnica e madhe numëronte 10 familje, në vitin 1536/39 fshati ka të

evidentuar 34 familje të krishtera, ndërsa në regjistrimin e vitit 1583 Ribnica e Madhe nuk është e evidentuar. Si duket, ato vite ajo u bashkua me Rinnicën e Vogël.

RIBNICA E VOGËL (Kuçuk Ribnica) – është fshat i zhdukur dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 është evidentuar me emrin Ribiqicë dhe ka numëruar 4 familje. Në regjistrimin e viteve 1536/39 është shënuar me emrin Ribiqica e Vogël dhe ka pasur 42 familje, mes tyre 1 familje muslimane. Ndërkaq në regjistrimin e vitit 1583 fshati nuk është evidentuar ose së paku mund të jetë i evidentuar me emër tjetër.

SENCA – është kryesisht fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 në regjistër është shënuar me emrin SENÇI. Ka qenë “has” i Karagjoz Beut, ka numëruar 4 familje, ka pasur 1 mulli. Në vitin 1519 fshati i ka evidentuar 42 familje të krishtera e 1 familje muslimane. Regjistrimi i vitit 1583 për fshatin Sencë është i plotë. Fshati është në kuadër të Nahisë së Rekës, në Sanxhakun e Ohrit. Ai numëronte 42 persona ose 30 familje.

ZHUZHLE – është fshat i krishterë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati është “has” i Karagjoz Beut, në përbërje të Vilajetit të Rekës. Në këtë regjistrim ka 5 familje dhe 2 mullinj. Në vitin 1519 fshati i ka numëruar 14 familje të krishtera dhe shtrihej në Rekën e Madhe (Epërme) pranë fshatit Nistrovë.

Në bazë të regjistrimit, që është kryer nga përfaqësues të shtetit bullgar në fillim të viteve 1900–të, në fshatrat e Rekës kemi 2861 shqiptarë ortodoksë dhe 2262 shqiptarë të fesë

myslimane. Interesant është fakti se në Rekë kemi tre fshatra që banoreshin nga shqiptarët ortodoks, si në Z'LVAJSKO, KIÇENICA, BELIÇICA dhe tre fshatra të banuara vetëm nga shqiptarë myslimanë, si: SHTIROVICA, 400 shqiptarë mysliman, STROJÇA me 300 shqiptarë myslimanë dhe TANU-SHA me 350 shqiptarë myslimanë. Për Shtirovicën kemi dëshmi edhe nga Bajazid Doda dhe Nopça.⁵

Më poshtë po sjellim emrat e fshatrave që kanë banuar shqiptarët ortodoks të Rekës ashtu siç janë shkruar nga autorët bullgarë, serb dhe grek duke ruajtur originalitetin e tyre:

1. V'RBEN, ka pasur 300 shqiptarë ortodoksë dhe 360 shqiptarë myslimanë
2. V'LKOVIJA, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 150 shqiptarë myslimanë
3. GREKANE, 25 shqiptarë ortodoksë dhe 14 shqiptarë myslimanë
4. Z'LVAJSKO, 35 shqiptarë ortodoksë
5. ŽUŽNE, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 160 shqiptarë myslimanë
6. KIČENICA, 120 shqiptar ortodoks
7. BELIČICA, 450 shqiptar ortodoks
8. BIBANE, 32 shqiptarë ortodoksë dhe 90 shqiptarë myslimanë
9. BOGDEVO, 180 shqiptarë ortodoksë dhe 108 shqiptarë myslimanë
10. BRODEC, 360 shqiptarë ortodoksë dhe 150 shqiptarë myslimanë
11. NIVIŠTA, 170 shqiptarë ortodoksë dhe 180 shqiptarë myslimanë
12. NISTROVO, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 230 shqiptarë myslimanë
13. NIČPUR, 250 shqiptarë ortodoksë dhe 220 shqiptarë myslimanë
14. D'BOVO, 24 shqiptarë ortodoksë dhe 90 shqiptarë myslimanë
15. REČ, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 140 shqiptarë myslimanë
16. RIBNICA, 120 shqiptarë ortodoksë dhe 200 shqiptarë myslimanë
17. SENCE, 195 shqiptarë ortodoksë dhe 120 shqiptarë myslimanë

Sa i përket Rekës së Epërme, kjo trevë shqiptare me popullsi autoktone shqiptare është dyndur shumë herë nga vatrata e veta. Dyndjet e këtyre banorëve kanë kaluar në katër faza. Këto fshatra denbabaden kanë gjallëruar, mirëpo shkaqet eko-

⁵ Bajazid Doda dhe Nopça, Jeta fshatare shqiptare ne Rekën e Epërme, Tetovë, 2012

nomike benë që lëvizja migruese të bëhet brenda trojeve shqiptare për të kërkuar të ashtuquajtur “tokë pa zot”.

Sa i përket Rekës së Epërme dyndjet e para filluan menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut. Këtë mendim e arsyetoj me një citat të nxjerr nga Marin Baleti: “Për besnikërinë dhe trimëritë e shumta dhe të shënuara që banorët kishin treguar për hir të mbretërisë së t’et, Gjonit në kohën kur i binte në qafë Otomani”⁶. Mirëpo dyndja më e madhe e këtyre fshatrave filloi në shekullin XVIII, pas humbjes së një lloj autonomie të fituar më 1467. Nga një defter turk kuptojmë se figurojnë të boshatisura 13 fshatra, të cilat u vendosën rreth malit të Thatë dhe në Karshiakë e deri në Veles, ku ata tani formojnë një kurorë të fshatrave të migruara nga Reka e Epërme.

Sipas disa të dhënave, deri në vitet e ’60-ta të shekullit XIX Reka e Epërme fliste vetëm shqip. Këtë e na e përshkruajnë më së mirë udhëpërshkruesit bullgarë. Sipas profesorit universitar të Sofjes, Jordan Ivanov: “Popullsia shqiptare e Gostivarit, e krishtera, është bullgarizuar në kontakt me bullgarët”⁷.

Mizoritë me format më të ulëta, si: përdhunimet, plaçkitjet, djegiet, vrasjet e torturat, që i kjo popullatë përjetoi më së miri i përshkruan Edit Durhami,⁸ e sidomos shkrimtari Haki Stërmilli, i cili i ka parë me sytë e tij dhe i ka përjetuar këto skena ferri. Ai do të shkruajë se: “terri i natës ishte zhdukur nga drita e zjarrit të katundeve të djegun prej serbëve ...”⁹.

Studiuesi Hamit Kokallari kur bën fjalë për vendbanimet shqiptare ortodokse në viset lindore, gjegjësisht për Rekën e Epërme, pyet: “Përse në shumë katunde të Shqipërisë etnike

⁶ Marin Barleti. “Histori e Skënderbeut”, Vatra Shkup, 2004, f. 164

⁷ Cit. sipas Mark Tirtës në vepren Echo de Bulgarie, Sofia, 1913, nr. 4 f. 12

⁸ M. E. Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballanike, Tiranë, 1944, f. 247

⁹ Haki Stërmilli, Dibra në prag të historisë, Tiranë, 1940. f. 95

lindore (Maqedoninë Perëndimore), sikur kam mundur të vërtetoj vet, pleq e plakat e folshin me droe shqipen tonë me një të folmer të kthjellët e të kullueme, kur mirshin vesh seai qi kuvendonte me ta nuk ishte bullgar ose tjetër kush përveç shqiptar” që më pas të përgjigjet: “Vetëm puna, pse ata pleq e plaka na e folshin me dashje e me sy të përlotun shqipen”¹⁰. Dyshimi i tyre ishte sepse të huajit më qellime të caktuara i “masakrofshin pa mëshirë në shtëpitë e tyre natën”¹¹. Kësaj popullate askush nuk i doli në ndihmë – ata mbetën gjatë gjithë historisë së tyre si të shkretë, andaj edhe sot e kësaj dite nga tjerët quhen të shkret “Shkrete”.

Për të zhdukur gjurmët e shqiptarëve të kësaj ane, përpjekjet nuk janë ndalur as në kohën e Jugosllavisë së Titos, kur pushtetarët maqedonas të përkrahur nga disa antishqiptarë vazhdonin edhe më tej shkombëtarizimin e ortodoksëve shqiptarë¹². Me këtë rast po ofrojmë një dokument arkivor, që mban datën 4.12. 1967. Edhe pse shumica e shqiptarëve ishin shpërngul, ata që kishin mbetur në vitin 1967 kërkuan që në fshatin Sencë të mësojnë në gjuhën amtare. “Sivjet për here të parë prindërit nëpërmjet referendumit u deklaruan që mësimi të zhvillohet në gjuhën mësimore shqipe, duke mos u futur në zgjedhjen e kësaj çështje, megjithatë sjellja e disa shokëve nga Senca se ky akt nënkupton aksion që të shpërngulen maqedonasit nga Senca është i dëmshëm dhe për lloj kritike”¹³. Çfarë absurdi – të gjithë ishin shqiptarë, por qëllimi

¹⁰ Arkivi Qendror Shqiptar, F. 203. Pa vit, D.1409, f. 21 cit, sipas Qerim Litës.

¹¹ Po aty

¹² Qerim Lita, Disa burime arkivore për Rekën e Epërme, botuar në gazetën ditore Lajm.

¹³ ДАРМ – отделение Тетово, Ф. ОК на СКМ Гостивар, Извештај на Општинскиот комитет меѓу I и II Општинска конференција, Гостивар, 1967

ishte që popullsia me fe ortodokse të asimilohet dhe ata ia arritën qëllimit. Sot në tërë Rekën mund të gjesh vetëm turistë dhe barinj në stinën e verës.

Edhe pse nuk ka banorë që jetojnë ose ka shumë pak sosh, nga toka e Rekës del gjuha dhe vendi stërgjyshor i këtyre shqiptarëve. Këtë më së miri e dëshmon emërtimi i vendeve. Këtu do t'i japim vetëm ato që kemi mundur t'i evidentojmë, sepse në fakt kjo punë kërkon angazhim ekipor.

Makrotoponomia

Në klasifikimin e materialit nuk e kemi ndjekur asnjë kriter, por vetëm i kemi evidentuar, sepse qëllim ynë nuk është që të mbështetemi në kriteret e klasifikimit, as në prejardhjen e as në pikëpamjen shtresore e lesiko-semantike, por vetëm që të evidentohen ashtu si i përdorin banorët lokal dhe si janë të evidentuar në hartat topografike: Bgjeska e Rudovës, Bgjeshka e Bistrës, Bgjeshka e Kabashit, Bgjeshka Vërbeni, Bgjesha e Vaut, Leri, Guri i Zi, Sutovica, Gjolet Karkornicës, Guri Kush, Guri Dashit, Vorri Shkaut, Stanet e Baltës, Bgjeshka e Reçit, Gropza, Skrel. Guri i Markut, Kodra e Fudanit, Rast e Ngult, Gjini Voda, Golem Argat, Guri i Zi i Vogël, Çesma e Zhypit, Kodra e Made, Taume e Ali Baklavës, Krasta, Kulla e Asanit, Qafa e Kadisë, Strezimirski Çam, Kisha e Dingozi, Gun Gabash, Kushi Baba, Guri i Deplnis, , Kepi Bard, Guri i Zhytetit. Manastiri (ec), Korabi i Nistrovës, Cuselija, ¹⁴, Bgjeshka Tuentes. Shumica e këtyre emetimeve janë shkruar në gjuhën maqedonase me deformime si grafike ashtu edhe drejtshkrimore, që sot me të vërtetë të kemi një

¹⁴ Map-cart, ([www. Gorna Reka](http://www.GornaReka))

kakokofoni të turpshme jo vetëm për shqiptarët, por edhe për vetë maqedonasit.

Mikrotoponomia

Kështu është bërë vetëm evidentimi i tyre sipas fshatrave dhe materiali është marrë nga njerëz, gjegjësisht bashkëbisedues drejtpërdrejt. Në vazhdim do t'i japim ashtu siç i quajnë këto mirkotoponime banorët lokalë në të folmen e tyre.

Duf: Guri i Xhinit, Uji i Zanave, Ajozma e Merzivecit, (edibe), Gropa e Shabanit, Bgjeska e Madhe, Bgjeska e Vogël, Kisha e Dingozi, Argaqi i Katunit, Koriya i madh, Koriya i Livadheve, Guri Cakut. Tolej, Brozovec, Çajane, Ballaban Jerqevish,¹⁵ Grika, Sulo, Livadhi Karshi, Livadhi Garipit, Livadhi Torit, Te Arat e Dervishit, Te Arat e Izvorit, Te Lenishta, Te Rrafsha e Llambit, Te Bataranka, Te Kroj i Xhemës, Te Kroj i Gjonit, Te Guri i Kulenit, Te Jazi i Mullinit, Ujta e Melcës, Te Prroi i Kojës¹⁶.

Zhuzhnjë: Vorret e Llatinëve, Groshticë, Bigori i Nivishtes, Bgjeska e Nistrovës, Bgjeska e Tutens(Nopça), Gun Gubash, Sila Vort, Prue i Likës, Alnishtë, Prroi Thell, Përroi i Bukovenit, Hurda te Zabelet, Klenjt¹⁷

Niçipur: Shullo, Guri Gorit, Mulla Ambl, Kroj Ftoet, Fushija, Guri Stomit, Guri Shushes, Kumlla e Rediti, Guri Kush (Kuq), Vorret e Mlla, Kroj i Dullës, Kroj i Smilit, Darda e Made, Prroi i Panës, Ara e Alisë, Ura e Dubanes, Kroj i

¹⁵ Vitomir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben.

¹⁶ Shahidie Ahmeti, e lindur në Duf, 86 vjeçare

¹⁷ Enis Jakupi Reka – vendi im, Tetovë, 2007,f. 57

Verrinit, Llomba e Neselkut, Kroj i Similverit, Guri Shtjafit, Livadhi Kagjos, Guri Vërcakut, Bregu i Botës (dheut), , Guri i Katilit, Ara e Lagut, Kroj i Kustaret, Guri Zhypit. Kroj Elinakët, Kroj i Pecit,¹⁸ Kisha e Shumtanasit¹⁹. Livadhet e Niçpurit, Guri i Shushesh, Ara e Ivanit, Guri i Katillit, Vorri i Gjurchinit, Kurti i Kishës

Bogdë: Kroj i Shushes, Reka e Endigos, Boget .Shavare, Vorri i Bibës, . Gorishta, Përroi i Folit, Pëçushta, Legala, Rrasa e Haxhisë, Livadhi i Gjures, , Mërizi i Llopfve, Shpella e Madhe, Kandova, Llombet, Reçicat, Lugu i Priftit, Tallonbazi, Reshkia, Leret, Bgjeshka e Bogdit, Livadhet e Tërshanës, Rrasa e Kushe, Ligatat e Shpatit, Çuka, Karapushi, Guri i Dardhish-tës, Vorret Rimjan, Korja, Lloqet, Livadhi i Plakut, Bogëze²⁰. Stani i Sadikut, Stani i Dairt, Merizi i Vjetër²¹, Kroj i Vanes

Beliçicë; Kroj i Madh, Kisha e Shumkollit, Koriya, Ballaban, Brezovec, Goverdanik, Toljane, Korilja e Vjetër.

Krakornicë: Kroj Katundit. Gjolet e Karakornicës, Kisha e Endigos, Guri I Kojës , Shtëpia e Pashës, Guri i Kush, Livadhet e Pashës²² . Tumba, Guri i Ukut, Gropsa, Guri i Dashit, Llomba, Dradha , Çeshma e Katundit, Çeshma e Sollomonit, Çeshma e Pashës, Çeshma e Nuses së Re, Skrel, Strazhnik,

¹⁸Enis Jakupi, Reka – vendi im, Tetovë, 2007

¹⁹ Edibe Osmani, Rite e besime popullore ne viset e Tetovës dhe Gostivarit, Shkup, 1997

²⁰ Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç, .Punon në Shkup në kompaninë “Life com” si patron i shitores për kadaif.në Gjorçe Petrov.

²¹ Life, K.po ai.

²² Vitomir Taneski,

Guri Kush, Guri Bullit, Arat e Vasilit, Kaliba e Zhypit, Stogjet, Livadhet, Bigori, Vasilja, Krroi i Tomes, Llofka i Janes.

Vau: Ujë të Vaut, Bgjeska e Vaut, Bulli Vau, Livadhi Madh, Guri Bigorit (Bigorski Kamen), Dedebeq, Zenelbeq, Bgjeska e Brodashit ²³. Guri Bunarit (Bunarski Kamen).Ligata e Madhe, Boge, Radovec, Tumba, Proska, Fudan, Rasilla, Livadhi i Nidës, Bunar, Bigori, Shpella e Helvës, Shpella e Shtirovicës, Guri Deshat²⁴

Vallkavija: Ura e Vallkavisë, Përroi i Thellë, Guri i Gostilës. Ara e Nelit, Kazana, Bandera, Ligata e Madhe, Delmna, Kroj i Ukut, Kroj i Madh, Rrafsha e Epërme, Kroj i Sharitun, Kroj i Ftoftë, Guri i Andonit, Gropa, Ara e Bilallit, Ara e Madhe, Vorret e Eperta, Murizi, Ara e Vegjisë, Kërçelja, Guri i Minit, Te Ara e Zheshkut, Guri Abazit, Sadoli, Ligata e Madhe, Dardhat e Brenit, Guri i Orlit, Kroj i Kakudës, Sllana, ²⁵

Sence:Ura e Shtremët, Qafa e Sencës

Gregaj: Përroi i Gregajt, Qafa e Belart(dalje për tu lidhur me fshatrat Gregaj dhe Tanushe ²⁶.

Tanushë: N’Pirg, Meniku, Skretec, Lisenj, Tri Sinure, , Guri i Arushës, Skretec, Bacili, lakët Zhypet, Livadhet e Tanushës,

²³ Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914).

²⁴ Enis Jakupi, Reka Vendi im, Tetovë, 2007, f.54

²⁵ Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç. Punon në Shkup në kompaninë “Life com” si patron i shitores për kadaif.në Gjoçe Petrov.

²⁶ Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914),

Maja e Madhe, Guri i Lam, Hurdet, Laktar, Bregu i botës, , Ligatat e Medhaja, , Ligata e Tanushës, , Q(shaja)afa Barallavit, Kykul, Shall t' Rinnicëces, Krroi i Dushkut, Krroi i bregut, Krroi i Barallavit, Krroi i Ftohet, Krroi te Mullinjt, Krroi i Skertecit, Krroi i Marleshit, Hurzet, Te Burinni, Bregu botës, Shpella e Dinkos, Shpella e mehmetit, Guri Kush (j), Guri i Memet, Guri Mexhit, Krroi Bibe, Ujt Kalar, Krroj Bibe, Te Jurukut²⁷

Nistrovë, Rrafshi i Madh, Bgjesbaka e Nistrovës, Kodra e Kullës, Mali i Grabovës, Gunga e Bashës (Kjuselija), Kodra Kulla, Mali i Grabovës, Livadhet e Grabovës, Ara e Korabit, Pirgu Radomir, osog, Strung, Mollka, Kisavica, Livadhi i Priftit

Belicë: Bigori i Ternicës, Manisterishte, Kazan, Korija

Vërben: Livadhet e Turkut, Trauli, Livadhet e Traulit, Jonxha e Tanallarëve, Livadhi Hajdarit, Fusha e Llukovës, Bozhina, Guri i Damanit, Arat e Damanit, Krroi i ftoht te Bgjeska e madhe, Krroi i Markut, Krroi i Varaçes, Guri Hulës, Manastiri Kozha, Kozha e Vërbenit, Molla e ambëll (ogradë), Kroj i Vogël, Kryet e Livadhet, Ograda e Kryshes, Jonxha e Nazisë, Kisha e Vogël, Beli Kovaç, Ograda e Kostas, Ograda e Dojçit, Kroj i Hoxhës, Voret e Muslimaëve, Voret e ortodoksëve²⁸. Mëlla e Epërme, Mëlla e Mjedisme, Mëlla e Poshtme.²⁹

Shtirovicë: Kroj i Razhnikut, Fusha e Korabit, Belanxha, Stanet e Niçpurit, Rasa e nguljt, Ura e Torbeshve, (Torbeski

²⁷ Enis Jakupi, ve. E cit. f. 61

²⁸ Vitomir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben

²⁹ Vitomir Taneski

Most), Qafa e Kadišë, Kuqi Baba, Guri Bardh, Guri zi, Stani i Baltës, Silanski Kamen, Mengallova Kulla, Karpa, Skalsi Rid, Guri Madh. Gropsa, Guri i Deplnis (Dhelpës), Kepi Bard (Bardh), Strezimirski Çam, Guri i Dutetit (Zhuteti,)Vorri Osmanit, Guri Kush.

Rimnicë: Pralluka, Shullo, Kroj i Xhamisë, Kroj i Shahides, Kroj i Shtutkajve, Shpella e Veljanit, Livadhet e Priftit, Guri Gjatë, Krroi i Ftohohëet, Krroi i Azemicës, Rrasat e Zeza, Vorret e Kondes, Ujt e Shumes, Vorret e Vashave, Guri i Shqypes, Skalica, Kunorçe, Ara e Gjatë, Ragapec, Mihavec, Gradinec, Bregu,

Leskova: Dikur ka qenë si lagje më vete afër Vaut. Ky fasht është boshatisur. Banorët e këtij fshati një pjesë janë shpërngulur në Verbjan dhe një pjesë në Jabollçishtë të Velesit.³⁰ Tani këtë fshat, siç thotë bashkëbiseduesi, e kanë zaptuar gjarpërinjtë, që dalin nga themelet e shtëpive. Aty kemi vetëm livadhe dhe i quajmë Livadhet e Leskovës, Përroi i Rimnicës.

Reç: Hurdha e Idrizit, Bgjeska e Reçit, Kodra e Kulsit, Guri i Shtyttrit, Ujmisht , Llukovo Pole, Nishirova (Nikiforovo), Leunova. Në këto dy fshatra jeton një pjesë e shqiptarëve të Rekës së Epërme. Këto dy fshatra i takojnë Rekës së Vogël: Sendaktash, Golema Krasta, Crn Kamen, Izvorçe, Baçilishte, Zhezhnica, Radimost, Prisoj, Livada, Dukesh, Dominoo, Livajca, Jaori, Masllarica, Ogragje, Lekoec, Gjuroec, Petilep³¹.

³⁰ Lifet. K. Informator nga Gostivari i lindur në Verbjan.

³¹ Danica Milloshevska, 59 vjeçe) e lindur ne Gostivar, por prindërit e saj janë nga Nikiforova.

Toponimet e Rekës së Epërme, si çdo toponimi tjetër, pasqyrojnë imazhin e vendit, të banorëve, të gjuhës, të historisë etj. Prandaj ne nuk do të ndalemi në këtë punim në klasifikimin e toponimeve ose në mbështetjen e klasifikimeve të ndryshme që ekzistojnë në literaturën shkencore, por do t'i ndaj toponimet e Rekës në toponime natyrore dhe në toponime kulturore. Pra, në toponime që pasqyrojnë reliefin e vendit dhe toponime që pasqyrojnë historinë e vendit, të cilat me gjuhën e tokës na dëshmojnë për autoktoninë tonë.

Ne bazë hartave dhe në botime të autorëve të ndryshëm, toponimet e Rekës së Epërme i gjejmë edhe me emra të ndryshëm si. p.sh, fshatin: Zhuzhnje e gjejmë si: Zhuzhnja, Zhezhen, Zhuzhnje; po shtu Verbjani dhe Vrbjane; Gurin e Qytetit si: Guri Dutetit dhe si Zhutetit; Gurin e Kuq si Guri Kush; Shen Pjetrin si Shen Qetri. Ne Shtirovice toponimin Guri i Dhëlnës si “Guri Dëlnis”, Gurin e Bardh si “Guri Bard”, “Sila Vort” (tautologji interesante), pastaj Beliçicën si: Beliçica dhe Belçica, Bogdi si Bogdevë, Gryken si Grikë, Kepi Bardhë si “Kepi Bard” (Mapcarte) Valkovija si Volkovijë Në botimet e ndryshme të autorëve të vendit dhe të huaj toponimet e Rekës së Epërme i gjejmë edhe në këto forma: fshatin Sence si SENÇI, Ribnicen si Rinnicë dhe si Luminicë³², Mllakin si Ligata, Gregejn si Girqani, Vaunën si Brodec, Kishën e Shën Nikollës si Kisha e Shumkollit, Kishën Shën Pjetrit si Kisha e Sheqentrit³³, Bogdin si Bogdevo³⁴.

³².Enis Jakupi, Reka – vendi im, një tjetër këndvështrim, Gostivar 2007

³³Edibe Osmani, Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit, Shkup, 1997

³⁴Sefedin Haruni, E folnja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit, Shkup, 1994,

Në këtë regjion sot ndeshemi me shumë toponimi të burimeve të ndryshme shqipe, romake, turke, sllave. Janë këto toponime të formuara me fjalë të parme, me parashtesa dhe prapashtesa, me paraftalë, me kompozita, por edhe më keq – edhe me përkthime prej një gjuhe në një gjuhë tjetër. Bashkëbiseduesit tim me inicialet Vitko T. më pohojnë: “se ne kur folim me të qetrat (të tjerit) i “rrotullojmë” (që to të thotë se i përkthejmë) aty ku mundemi. Kjo shihet qartë te toponimi që gjendet në Shtirovicë. Ai që e ka “rrotulluar” nuk e ka ditur se si i thonë çamit, andaj e ka bërë Strezimirski çam e jo Stezimirski bor”; “Mahija e Madhe” në vend të Nahisë së Madhe ose Gjini Voda për Uji i Gjinit, Kodra Made në vend të Kodra e Madheetj. Është shumë interesant edhe një toponim që mendojmë se do të zgjojë interes dhe diskutim. Toponimi “Guri nguljt”, me të cilin banorët lokalë të dikurshëm të Shtirovicës e quajnë vendin e tyre, kurse banorë të fshatrave përreth këtë toponim e emërtojnë si “Guri Shtrum” e dikush “Rasa ngult”. Tani shtrohet pyetja se cili emërtim është i drejtë dhe si do të përdoret.

Duke përfunduar do të themi se duket se ka ardhur koha që toponimet të gjejnë zgjidhje të drejtë që ato të përdoren ashtu siç i emërtojnë banorët e vendit dhe të standardizohen. Ndryshe do të ndodhë ashtu siç i shkruan një mik Milan Kunderës, Hubel: “Për të asgjësuar popujt fillohet duke asgjësuar kujtesën e tyre. Shkartohen librat, kultura dhe historia e tyre. Dhe, dikush tjetër shkruan libra të tjerë, i përcjell një kulturë tjetër shpik për to një tjetër histori. Mbas kësaj populli fillon dalëngadalë ta harrojë atë që është dhe atë që kishte. Dhe, bota përreth tij harron më shpejt se akoma”.

Burimet:

Arkivi Qendror Shqiptar, F. 203. Pa vit, D.1409, f. 21 cit, sipas Qerim Litës. Barleti Marin, “Histori e Skënderbeut”, Vatra Shkup, 2004, f. 164

Defferi i Dibrës dhe i Matit, Stamboll, dosje 508 pranë AIH të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

“Shqypja e Shqypnis, Sofje, 21. 10.1909, nr. 10

Dervishi Nebi, **Dëshmitë e Rekës shqiptare sipas regjistrimeve nëpër shekuj**

Doda Bajazit & Nopça Franc, Jeta fshatare shqiptare ne Rekën e Epërme, Tetovë, 2012

Durham, M. E., Njëzet vjet ngatërresa ballanike, Tiranë, 1944,f. 247

Jakupi Enis, Reka – vendi im, Tetovë, 2007

Haruni Sefedin, E folnija shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit, Shkup, 1994,

Lita Qerim, Disa burime arkivore për Rekën e Epërme, botuar në gazetën ditore Lajm.

Osmani Edibe, Rite e besime popullore ne viset e Tetovës dhe Gostivarit, Shkup, 1997

Stërmilli Haki, Dibra në prag të historisë, Tiranë, 1940. f. 95

ДАРМ – отделение Тетово, Ф. ОК на СКМ Гостивар, Извештај на Општинскиот комитет меѓу I и II Општинска конференција, Гостивар, 1967

Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914)

Vitomir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben.

Shahidie Ahmeti, e lindur në Duf, 86 vjeçare

Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç

Danica Milloshevska, 59 vjeçe) e lindur në Gostivar, por prindërit e saj janë nga Nikiforova.

QEMAL MURATI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

DIKTATURA NË TOPONIMI

Toponimet dhe përpjekjet për të manipuluar me këtë materie

Ajo që duhej të bënin së paku onomasticienët, gjuhëtarët dhe intelektualët maqedonas është kjo, të distancoheshin nga histeria e luftës së marrëzishme ndaj përdorimit të detyrueshëm të toponimeve në gjuhën shqipe me format maqedonase, që promovonte dikur establistshmentin politik komunist maqedonas. Dhe t'u kërkonin shqiptarëve falje për këtë marrëzi groteske, jo të vazhdojnë ta projektojnë këtë ideologji edhe në realitetin e sotëm. Diktatura në toponimi nuk mund të jetë më funksionale, sidomos jo në kohën e sotme. Maqedonizmi nuk duhet të ndërtohet mbi degradimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit të tjetrit, por në ruajtjen e identitetit të vet. Toponiminë shqiptare nuk mund ta zhbënin dhe ta shlyenin dot as regjimin komunist, e nuk mund ta zhbëjnë as institucionet e sotme maqedonase. Sikundër shprehet R. Katiçiç, onomastika është një sistem relativisht i pavarur nga pjesa tjetër e gjuhës.

Toponimet janë gjuhë

1. *Toponimet janë gjuhë, histori, gjeografi, psikologji, shenja të komunikimit. Si të tilla, ato janë formuar historikisht dhe janë të qëndrueshme, të ngurosur, të ngulitura, më shumë se sa çdo element tjetër gjuhësor, se sa leksiku apelativ, i përgjithshëm. Prandaj, përpjekja për ta ndryshuar toponiminë e një vendi, për të bërë “pastrim të relievit nga e huaja”, si dhe për t’ia imponuar një komuniteti tjetër format vetjake të toponimeve, për të fituar prestigj lingvistik, janë jo vetëm të kota, të paqëndrueshme e kundërproduktive,*

por paraqesin dhe linguisticid gjuhësor. Kjo, sepse asgjë nuk mund të bëhet me forcë, sidomos në gjuhë, në toponimi, për zhbërjen e memories kolektive. Duhet që proceset të rrjedhin natyrshëm, sipas natyrës së vetë gjuhës.

Toponimia e çdo vendi është shumëshiresore, sidomos në rajonin e Ballkanit dhe në arealin e Maqedonisë, ku në një territor aq të ngushtë historikisht janë rrasur mbi njëra-tjetrën shumë gjuhë e shumë popuj, shumë kultura e religjione, që kanë marrë e kanë dhënë me njëra-tjetrën. Te komunitetet dhe elitat politike të Ballkanit, për shkak të provincializmit të thekur arkaik dhe të një patriotizmi primitiv, janë të njohura përpjekjet për ndryshimin e toponimeve dhe për t'ia imponuar tjetrit format vetjake të emërve. Kjo dukuri cilësohet si *donkishotizëm në toponimi*. Te popujt e Ballkanit ky fenomen ka gjetur formën e vet më agresive e më stupide sidomos te grekët, te serbët e te maqedonasit, të cilët kanë ndërmarrë fushata për ndryshimin e toponimisë dhe riemërtime me format e gjuhëve të tyre. Përpjekje të tilla ka pasur e ka dhe tek shqiptarët, si në kohën e Mbretit Zog dhe në kohën e komunizmit, e si në zhvillimet e sotme “demokratike”. “Gjatë periudhës së Mbretërisë të Ahmet Zogut një komision specialistësh u ngarkua për të bërë studim për zëvendësimin e emrave të huaj me emërtime shqipe. Rekomandimet e komisionit, që zënë gati gjysmën e numrit të emrave të fshatrave, u miratuan nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 753, datë 6 korrik 1938 dhe u botuan në Fletoren Zyrtare të 26 gushtit 1938. Ky vendim nuk arriti të vihet në jetë për shkak të pushtimit fashist. Gjatë periudhës së sundimit të Partisë së Punës dhe të ideologjisë së saj u bënë ndryshime edhe në fushën e toponimeve. Në vitin 1983 u krijua pranë Presidiumit të Kuvendit Popullor një komision i posaçëm studiuesish nga fusha e gjuhësisë, historisë, kulturës popullore etj., i cili u ngarkua të merrej me emërtimet e fshatrave” (Bici 1995: 100). Porse ato fushata janë kundërshtuar nga studiuesit e mirëfilltë dhe nga elita intelektuale shqiptare dhe nuk kanë pasur sukses. Për më tepër, madje mund të thu-

het se kanë qenë dëmsjellëse, sepse u zëvendësuan shumë emra fshatash që ruanin gjurmë të vjetra antroponimike dhe elemente arkaike gjuhësore, si: *Manastirec, Murtajas, Sëmuraj, Dervishas, Shënmëri, Shënmërtir, Shënpjetër, Shënpremte, Qenas, Shijan, Shënvasil, Pustec*, etj. dhe u zëvendësuan me emra të rinj abstraktë: *Dritaj, Çlirim, Pëllumbas, Fshat ri Ri, Burinas, Fushë, Çlirim, Afrim, Agim, Blerim, Blerinas, Përparim, Ligenas*.

Toponimet nuk duhet të shërbejnë si sinjal autoktoniciteti “për të përvetësuar territore”, në kuptimin e asaj se i kujt është toponimi, i atij është dhe vendi. Toponimi është shenja me të cilën komunikohet, që jo domosdoshmërisht tregon posesivitetin. Emrat e vendeve janë ndërruar sa herë janë ndërruar dhe sunduesit. Se sa është e rrezikshme kjo sëmundje e linguisticidit toponimik, të kujtojmë këtu se vetëm për shkak të pretendimeve për të përvetësuar emrin antik *Maqedoni*, çfarë lufte absurde bëhet ndërmjet grekëve dhe maqedonasve për përvetësim të trashëgimisë antike, me pasoja të paparashikueshme, të cilat i vuajnë të gjithë popujt e këtij rajoni edhe sot e gjithë ditën.

Rreth çështjes së përdorimit zyrtar të toponimeve tek popullata shqiptare në Maqedoni dhe refleksionet e shtypit maqedonas

2. Në këtë vështrim do të ndalemi në çështjen e përdorimit zyrtar të toponimeve tek popullata shqiptare në Maqedoni, të kontestuar dhe të politizuar nga pala maqedonase, me pretendimin se toponimet përkatëse të Maqedonisë edhe tek popullata shqiptare duhet të përdoren vetëm me format maqedonase, sepse, mendja e gjuhëtarëve maqedonas, këto toponime na qenkan posesivitet i tyre! Sipas kësaj logjike të gjuhëtarëve maqedonas, shqiptarët në gjuhën e tyre edhe Maqedoninë duhet ta quajnë *Makedonija*, sepse gjithnjë sipas tyre ky vend na qenka i maqedonasve. Kjo jo vetëm që do të ishte e palogjikshme, por dhe e marrëzishme. Sa për kuriozitet: “*Afrika e Jugut ka njëmbëdhjetë gjuhë zyrtare dhe shteti ka njëmbëdhjetë*

emra” (Naser Aliu), dhe atje kurrkujt nuk i shkon ndërmend të përdoret një emër i vetëm. Për shkak të ndjeshmërisë linguistike, *Konfederata zvicerane në aspektin e politikave gjuhësore* madje dhe për emërtimin e vendit përdor latinishten *Confœderatio Helvetica*, në mënyrë që t’i iket favorizimit të njërës prej katër gjuhëve zyrtare të Zvicrës.

Për ta paraqitur Maqedoninë si vend dhe si shtet ekskluzivisht vetëm të maqedonasve, domethënë se në Maqedoni çdo gjë është e maqedonase: edhe toka, edhe qielli, edhe uji, atëherë edhe emërtesa gjeografike, emrat e vendeve, të qyteteve, të fshatrave, të maleve, të lumenjve, patjetër duhet të jetë maqedonase ose me forma gjuhësore të maqedonishtes (!) Kjo do të thotë që nëse shqiptarët e kanë quajtur Shkupin Shkup e Ohrin Ohër së paku qysh prej më se dy mijë vjetësh, ata kanë bërë gabim që s’falet, sepse këto qytete është dashur t’i quajnë me format e sotme maqedonase Skopje e Ohrid! Ky është konkluzioni më manipulativ i gjuhëtareve Elka Jaçeva–Ulçar dhe Ubavka Gajdova të Institutit të Gjuhës Maqedonase “Krste Misirkov” të Shkupit, artikuluar në një faqe në gazetën e përditshme “Dnevnik” të Shkupit (5 mars 2012), në rubrikën *Aktuale: Nikoj ne go menuva albanskiot prevod na makedonskite toponimi: Ohrid si ostanuva Ohër, Star Dojran – Dojrani i Vjetër* (*Aktuale: Askush nuk e ndryshon përkthimin shqip të toponimeve maqedonase: Ohri mbetet Ohër – Star Dojran – Dojrani i Vjetër*).

НИКОЈ НЕ ГО МЕНУВА АЛБАНСКИОТ ПРЕВОД НА МАКЕДОНСКИТЕ ТОПОНИМИ

Охрид Си Останува Ohër, Стар Дојран - Dojrani i Vjetër

Од Институтот за македонски јазик „Крсте Петков Мисирков“ неколкупати алармирале дека во преводот на албански јазик на Законот за територијалната организација на локалната самоуправа на Република Македонија од 2004 г. е направе-

на толку голема збрка што на албански јазик се преведени дури и имиња на населени места каде што никогаш не живеело албанско население, но тој си останува до денешен ден.

Dojran i Vjetër, Ratevo, Tetovë, Haracina, Manastir, Ohër се само неколку топоними во земјава преведени на албански јазик кои се користат во официјална употреба, а со тоа директно се повредува македонскиот јазик, алармираат научниците од Институтот за македонски јазик „Крсте Петков Мисирков“. Топонимите не се преведуваат никаде во светот, велат тие. Исклучок се прави само за одомаќени зборови кои имаат традиција и населението ги користи со години. Според македонистите, направена е толку голема збрка, што на албански јазик се преведени дури и топоними во Беровско, каде што никогаш не живеело албанско население.

Проблемот е направен во 2004 година кога беше донесен Законот за територијалната организација на локалната самоуправа на Република Македонија, објаснува Елка Јачева—Улчар, виш научен советник и раководител на одделението за ономастика при Институтот.

— За да биде побргу работата, за да излезе „Службениот весник“ на македонски и на албански јазик и тоа да се официјализира, се направи катастрофален превод на Законот на албанскиот јазик. Веројатно им бил даден на тројца—четворица преведувачи кои направиле карма—каша со топонимите. Не само што биле преведувани на албански јазик, туку тоа е направено без никаков ред, ниту доследност — вели Јачева—Улчар.

Studiuesit e Institutit të Gjuhës Maqedonase “Krstе Petko Misirkov”, sipas artikullit në vështrim, kanë dhënë alarmin për toponimet e përdorura në gjuhën shqipe, të cilat sipas tyre po e dëmtojnë rëndë gjuhën maqedonase. Në mediet maqedonase, ata insistojnë që toponimet të mos përkthehen, përveç se në raste kur bëhet fjalë për emërtime popullore që përdoren tradicionalisht nga vendasit.

Në studimin e tyre, ata vënë në dukje se problemi ka lindur që në vitin 2004, kur hyri në fuqi *Ligji i ndarjes territoriale*. Studiuesit janë të shqetësuar nga përdorimi zyrtar i toponimeve të tilla si Ohër, në vend të “Ohrid”, Kërçovë në vend të “Kiçevo”, *Hasanbeg* në vend të “*Singeliq*”. Ata i quajnë idiotësi përdorimet e kësaj forme, sidomos për ato zona në të cilat nuk ka shqiptarë. Në njërin prej neneve të Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë, ndër të tjera thuhet se riemërtimi i toponimeve konsiderohet si dëmtrim i trashëgimisë kulturore. Por mungesa e sanksioneve ligjore ka favorizuar abuzimet me maqedonishten, – ankohen studiuesit maqedonas.

Me këtë mendësi operon dhe gjuhëtarja Lidija Tanturovska (Tanturovska 2013: 23, 30), e cila po kështu shfaq mospajtimin e saj që në *Ligjin e ndarjes territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë* (2004), në variantin shqip, krahas formave maqedonase *Gorno Orizare*, *Nova Konjareva*, përdoren dhe format shqipe *Orizare e Epërme*, *Konjareva e Re*. Ajo e ndjen si një fatkeqësi që pas vitit 2001 maqedonishtja duhet të bashkëjetojë me shqipen në fushën e të drejtave gjuhësore: “*Za žal, po 2001 godina, makedonskiot standarden jazyk e prinuden da bide “vo dvoystvo” so albanski-ot jazyk na svojata teritorija, vo republika Makedonija*”. Ajo që nuk kupton linguistja Tanturovska është kjo, se areali gjuhësor maqedonas nuk mund të jetë i njëjtë me arealin gjuhësor të shqipes për sa kohë që shqipja dhe maqedonishtja janë dy gjuhë të ndryshme që fliten nga dy popuj të ndryshëm. E kjo vlen dhe për lëmin e toponimisë, ku çdo popull ka të drejtën e tij të përdorimit të toponimeve sipas gjuhës së vet. E, nga ana tjetër, sepse edhe gjuha shqipe është në territorin e vet në atë që quhet Republika e Maqedonisë, dhe nuk jeton aty me qira.

Edhe ndonjë akademike maqedonase që e ka humbur rrugën në “shkençë”, si Katica Qullafkova (Катица Кулафкова), në pyetjen e gazetares Александра М. Бундалевска: “*Како ги коментирате промените на топонимите*”? (Si i komentoni ndryshimet e toponimeve?), nuk denjon të japë një përgjigje të tillë aspak

akademike dhe aspak shkencorte: “Употребата на топоними – те е повеќе од катастрофална. Таа е првиот и клучен сигнал дека нешто не е во ред со статусот на еден јазик и со односот на субјектите (граѓани, институции, партии) спрема тој јазик. Незамисливо и недопустливо е да се преведуваат топонимите. Во Р. Македонија се преведени топонимите од македонски на албански (направена е translација). Тоа не се случувало ни во Отоманската Империја, а денес се озакони до акт на македонското Собрание. Топонимите се транслитерираат, односно буква по буква се пишуваат на друго писмо, да речеме од кириличното (како официјално писмо во РМ), на латиничното, во случајот со албанскиот или турскиот јазик. Во актите за заштита на културното наследство требаше да биде донесена забрана за транслитерација или превод од еден на друг јазик на топонимите. Топонимите се меморија на територија – та и меморија на народите, и таа треба да се почитува” (Академик Ќулавкова: Албанското малцинство врши психолошка пресија врз Македонците, intervistë, publikuar në numrin 83 të javores Република, 4.04.2014, Shkup). Në fakt, kjo përgjigje historike dëshmon qartë jo vetëm shkallën e intolerancës të akademikëve maqedonas ndaj gjuhës dhe kulturës së tjetrit, por dhe nivelin e tyre tejet të ulët prej sharlatani në fushën e dijes. Qullafkova ose nuk e di, ose shtiret se nuk e di se toponimet janë memorie, gjuhë, kulturë dhe histori jo vetëm për maqedonasit, por për të gjitha popullatat, pra edhe për popullatën shqiptare në Maqedoni. Ndonëse nuk është gjuhëtare dhe nuk i di ligjësitë e gjuhës, por si intelektuale, më e pakta që duhej të bënte akademikja Qullafkova është kjo, të distancohej nga histeria e luftës së marrëzishme ndaj përdorimit të detyrueshëm të toponimeve në gjuhën shqipe me format maqedonase, që promovonte dikur stabilishmenti politik komunist maqedonas. Dhe t’u kërkonte shqiptarëve

falje për këtë marrëzi groteske, jo t'i projektojë këto në realitetin e sotëm. *Diktatura në toponimi nuk mund të jetë më funksionale, sidomos jo në kohën e sotme. Maqedonizmi nuk mund të ndërtohet mbi degradimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit të tjetrit, por me ruajtjen e identitetit të vet.*

Në përdorimin e toponimeve shqiptarët nuk abuzojnë aspak me maqedonishten, e as me ndjenjat nacionale të maqedonasve, por flasin gjuhën e tyre sipas ligjeve e rregullave të saj vetjake. Në këtë pikëvështrim, destruktivitetet vijnë nga pala maqedonase, që kërkon të vërë rregulla në gjuhën shqipe. *Normalisht, si një rregull e përbotshme, secili komunitet ka të drejtë ta quajë si të dojë ndonjë vendbanim, është çështje gjuhësore, por kjo nuk i obligon komunitetet e tjera ta quajnë me të njëjtën formë gjuhësore, gjithnjë derisa kanë shprehjen e vet.* “Sikur shqiptarët të kishin pasur inat, nuk do të kishin lejuar që edhe sot e kësaj dite qyteti pranë liqenit të Ohrit, të quhet me rrënjë sllave – Pogradec, ose nuk do të kishin lënë fshatra si Novo Sella në brendi të Shqipërisë. Por, ama, Manastir e quajnë këtë qytet gjithë shqiptarët e botës, siç e quajnë edhe Pogradecin si të tillë” – shprehet gjuhëtari Zeqirja Ibrahim (‘‘Politika larg toponimeve’’, Koha, 7. 3. 2012). Toponimet që janë sot në përdorim zyrtar, nuk janë variante të përkthyer në shqip, por emërtime tradicionale të gjuhës shqipe. Tradicionalisht, Tetovës i kemi thënë Tetovë, Ohrid – Ohër dhe në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet fjalë për përkthim, por për forma burimore shqipe (Valbona Toska, Koha, 7. 3. 2012).

Ç’është e vërteta, gjuhëtarët maqedonas të Institutit të Gjuhësisë, të Akademisë së Shkencave, etj. kanë të drejtën e tyre të japin këshilla e udhëzime se si do të shkruhen dhe shqiptohen toponimet në gjuhën maqedonase, të hartojnë fjalorë për drejtshkrimin e toponimeve në gjuhën maqedonase, por nuk kanë kurrfarë të drejte të japin urdhëresa dhe receta se si do të shkruhen dhe shqiptohen emrat e vendbanimeve, qyteteve, fshatrave, etj. në Maqedoni në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Gjuha shqipe, bartëse e njëres

prej popullsive më të vjetra në Gadishullin e Ballkanit dhe rrënjëse në arealin e Maqedonisë, ashtu sikurse dhe çdo gjuhë tjetër, i ka ligjet dhe rregullsitë e veta fonetike, morfologjike, sintaksore, në bazë të të cilave ajo funksionon dhe komunikon, dhe nuk pranon interferime e diktate të tilla nga jashtë, qofshin ata dhe gjuhëtarë-gjeni të Institutit të Gjuhës Maqedonase. Kështu, dhe në arumanishten *Vardari* quhet *Avardarul*, emrat e qyteteve *Radovish* – *Arduvishi*, *Resnjë* (maq. *Resen*) – *Aresani*, *Manastir*, maq. *Bitola*, – *Bitule*, *Shkup*, maq. *Skopje*, – arum. *Skopia*, apo në turqishten *Tetova* quhet *Kalkandelen*, *Shkupi*–*Yskyp*, etj., pra ndryshe nga format maqedonase, sepse këto janë gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja dhe kanë rregullsitë e veta. Këtyre gjuhëve nuk mund t’ua ndryshosh natyrën e tyre që toponimet përkatëse t’i përdorin me format sllave, siç pretendojnë gjuhëtarët maqedonas, ngaqë kjo do të ishte edhe e pamundur, edhe qesharake. Gjuhëtarëve maqedonas që angazhohen për politizimin e toponimeve u ka ngecur ora në epokën famoze të komunizmit, kur me diktate politike urdhërohej që te popullata shqiptare *Kërçova* me përdhunë të *quhej* *Kičevo*, *Shkupi* – *Skopje*, *Ohri* – *Ohrid*, etj. Diktateve të tilla absurde të “*new speech*–it” maqedonas, modeluar sipas groteskut të “*Fermës së Kafshëve*” të Oruellit, u ka kaluar koha si stupiditete të llojit të vet. Në qoftë se maqedonasit e sotëm kanë probleme me çështjen e identitetit të tyre, prandaj dhe çdo toponim që kanë në gojë ata duhet të shkruhet dhe të shqiptohet si i tillë edhe në gjuhën shqipe, shqiptarët nuk e kanë këtë kompleks; këta as nuk ua imponojnë të tjerëve se si do t’i përdorin toponimet që janë në gojë të tyre si *Shkup*, *Manastir*, *Kërçovë*, etj., por as nuk do të lejojnë që t’ua imponojë dikush atyre se si do t’i artikulojnë emrat e vendeve në gjuhën e tyre. Posesiviteti politik dhe etnik i vendbanimeve me popullsi maqedonase nuk mund të presupozojë dhe posesivitetin ekskluziv të emërtesës toponimike sllave në gojë të shqipfolësve.

Manastiri – qytet me shumë emra

3. Toponimet janë një përzierje e trashëguar nga të gjitha kohërat dhe përpjekja për të manipuluar politikisht me këtë materie krijon shumë probleme identitare. Kështu, po ta marrim emrin e qytetit të *Manastirit* (maqedonisht *Бумола*, arum. *Bitule*), do të mund të vërejmë se në rrymë të shekujve, në varësi nga sundintarët e ndryshëm, ky qytet ka pasur shumë emra. Gjatë periodës së sundimit osman, turqit dhe shqiptarët e kanë quajtur *Manastir*, emër që e huan nga grekët *Μοναστήρι*. Emërtimi sllav *Бумола*, onomasticienët sllavë shprehen të ketë dalë nga *Обумел* “familje”, që në mesjetë përdorej me kuptimin “bashkësi e monasve, familje përkatësisht manastir”, pra nga manastiret e shumta që ka pasur në qytet dhe rrethinë. Sipas tyre, në rrjedhën e kohës, zanorja *o* do të ketë rënë nga shqiptimi i fjalës „*Обумел*“, dhe emri i qytetit mbeti *Бумола*, por nuk shpjegojnë si ka mundur të bjerë ai tingull i theksuar në fillim të fjalës, dhe *e* të jepte *o*. Sipas shënimeve të Marko Cepenkovit, qyteti *Бумола* emrin e vet e ka marrë sipas poseduesit të madh të pronave (feudit) *Толбо*, i cili ka pasur kështjellën e vet afër vendbanimit të sotëm *Буково*.

Në fakt, topiku *Bitola* duhet të përmbajë një emër veçjak homonim, me burim shqiptar ose roman, *Butil*, *Bitol*, khs. dhe topikun *Butell* në Shkup, si dhe antroponimin roman *Bitiola* uxor Petri Mote, në Rab 1342 (Jireček 1962: 150), dhe patronimin *Bitoljanu* (*Vanja Bitoljanu*). Kjo dëshmon që tek maqedonasit ruhet forma shqipe ose romane e këtij emërtimi *Бумола* (nga *Butil*, *Bitol*), kurse te vetë shqiptarët forma greke *Manastir* (*Μοναστήρι*). Porse, pavarësisht etimologjisë së këtij emri, tanimë këto janë procese të përfunduara, dhe nuk mund të ndiqet ndonjë rrugë e ndryshimit a rikthimit të formës parake *Butil*, *Bitol* te shqiptarët, apo e formës sllave *Bitola*, sepse kështu do të krijonim kaos në toponimi.

Toponimet e përkthyer – karikaturë gjuhësore

4. Si kundërvënie ndaj politikave toponimike maqedonase, dhe në emër të një patriotizmi primitiv (parak), në përdorimin e toponimeve bëhen dhe përkthime arbitrare, krejt të pambështetura dhe të paqëndrueshme, që nuk i hyjnë në punë askujt. Janë të vërejtshme përkthimet që si pasojë e mungesës së njohurive gjuhësore, kanë rezultuar me gabime të tilla si *Novo Sello* të quhet *Fshati i Ri*, *Sveti Nikola – Shën Nikollë*, *Makedonski Brod – Anija Maqedonase*, *Star Dojran – Dojrani i Vjetër* e të tjera. Në këto raste, toponimet e tilla nuk janë veçse një karikaturë e shëmtuar gjuhësore.

Për “patriotizmin” shqiptar në fushën e toponimisë e kemi një porosi: të mos bëhen karikatura përkthimore të toponimeve me burim joshqiptar me topoleksma përbindështa të shqipes, të tilla sikurse ajo që në disa botime toponimin *Çellopek* (për *Çollopek*) ta emërtojnë me *Ballishtë*, sepse këto jo vetëm që janë stupiditete të llojit të vet, por krijojnë dhe konfuzion në komunikim. Kush do ta kuptonte ta zëmë: *Ballishta, fshat i komunës së Tetovës*, kur një fshat i tillë nuk ekziston! “*Në shqipërimin e fjalëve të huaja duhet të ruheni kurdoherë nga një farë simplizmi që mund të vejë në dëm të saktësisë dhe të qartësisë së termiit*” (Leka 2007: 60). E kjo vlen sidomos në shqipërimin e toponimeve, ku në këtë fushë nuk mund të eksperimentohet aq kollaj siç ia merr mendja dikujt, ngaqë toponimia (emërtesa gjeografike) është pronë kolektive, sistem shenjash, nuk është pronë individuale.

Shqiptarët nuk e kanë traditë shovinizmin, e aq më tepër shovinizmin lingistik e toponomastik. Në këtë kuptim, në përdorimin e toponimeve nuk bëhet fjalë për plane për ‘shqiptarizimin’ e Maqedonisë, sepse një gjë e tillë as që mund të arrihet përmes kësaj rruge.

Rreth çështjes së përdorimit të toponimeve sllave në Shqipëri – rasti i Pustec-it

5. Janë me qindra emra sllave në Shqipëri që kanë mbetur nga pushtimet e tyre dhe shqiptarët i kanë ruajtur ndër shekuj. Në shumë zona të Shqipërisë, sidomos në brendësi të territorit të saj jugor, edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të ruhen toponimet sllave, si: *Pogradec, Volorekë, Bistricë, Korçë, Librazhd, Berat, Çorovodë, Novoselë*, etj. Iniciativat e kohëve të fundit nga ndonjë parti politike për t'i ndërruar janë cilësuar si donkishoteske dhe janë kundërshtuar me të drejtë nga intelektualë dhe nga gjuhëtarët shqiptarë, sepse toponimet janë fakte historike. E historia nuk bëhet dhe nuk zhbëhet me dëshira. Nga ana tjetër, edhe popullata maqedonase në Shqipëri i përdor toponimet sipas ligjësive të brunit të vet gjuhësor sllav, si: *Pustec, Leska, Gorica, Zaroshka, Zrnosko, Drač, Valona*, etj. dhe askush nuk i detyron ata të përdorin format shqipe.

Si një histori josuksesive të ndërrimit të toponimeve po sjellim shembullin e topikut *Pustec* (maq. *Пустец*) – fshat dhe qendër komunale në Prespën e Vogël, Qarku i Korçës, që popullohet më së shumti nga komuniteti maqedonas. “Në vitin 1973 në kuadër të luftës kundër ndikimeve të huaja, fshatit iu kthye emri nga *Pustec* në *Liqenas*. Pas Luftës së Dytë Botërore, emri i Lokalitetit dhe i Kooperativës ka qenë “Lokaliteti Pustec” dhe “*Kooperativa Pustec*” dhe pas kësaj nga regjimi komunist u ndryshua në “*Lokaliteti Liqenas*” dhe “*Kooperativa Liqenas*” dhe si rrjedhojë u trashëgua edhe emri i sotëm. Banorët e komunës për shumë vite me radhë kanë kërkuar që emri i fshatit dhe komunës të ndërrohet në *Pustec*, ashtu sikurse është quajtur historikisht” (Gazeta Shekulli, 12. 03. 2013), me mëtimin se ky topik është i burimit gjuhësor sllav. Parlamenti shqiptar, pas kërkesës së këtij minoriteti të deklaruar si maqedonas, më 18 mars 2013 miratoi ligjin duke kthyer emrin e komunës Liqenas në Pustec. Natyrisht që popullata vendore, e çfarëdo etnie qoftë, ka të drejtën e saj ta quajë vendbanimin ku

jeton me emërtimin që dëshiron, krejt sipas rregullave të gjuhës së vet dhe pa imponime politike e administrative. Në këtë përshtjellim të madh, lojë të mbrapshtë me toponimet, shtrohet pyetja: ç'u fitua me "shqiptarizimin" e emrit Pustec në Ligenas dhe, e kundërta, me "sllavizmin" e emrit Ligenas me Pustec? Përgjigjja është e vetëkuptueshme: asgjë, veçse një kaos toponimik dhe përçudnim oreksesh për "luftimin e së huajës". Ç'është e vërteta, tek emri *Pustec* del të ruhet një emër vetjak *Pust* i burimit roman, dhe prapashtesa sllave *-ec*, e jo ndonjë apelativ sllav *pust* "shkretë, vend i shkretë", siç mund të afrohet në ndjenjën gjuhësore në bazë të një përngjashmimi fonetik okazional të sll. *pust* me "shkretë". Për ta mbështetur këtë gjykimin tonin, mund të afrojmë këtu dhe patronimin *Pusterna* – degë e dytë e familjeve të familjeve dubrovnikase *Gozze* e *Bona*, në shek. XV e XVI (Jireček 1962: 328), *Pusta Reka* – fshat në komunën e Krushevës në Maqedoni, *Pusta Reka* – emër fshati në Kosovë, në thelb nga *Lumi i Pust-it*, *Pustina* – mbiemër familjar (Dibër). Në gjithë këtë histori pra, kemi këtë karikaturë groteske: u ndryshua një emër kinse sllav, *Pustec*, por në fakt i proveniencës romane, dhe u rikthye prapë në përdorim në gojën e popullatës maqedonishtfolëse gjoja si posesiv i kësaj bashkësie folëse!

Ndryshohen emrat e fshatrave në komunën e Pustecit

6. Në vazhden e ndryshimit të toponimeve, Komuna Pustec ka ndryshuar edhe emrat e disa fshatrave, me ç'rast mbi 10 fshatra kanë marrë emrat e rinj apo siç thuhet janë kthyer emrat e vjetër: *Lajthizë* në *Leska*, *Diellas* në *Shulin*, *Zaroshkë* në *Zrnosko*, *Gollomboc* në *Glloboçen*, *Kallamas* në *Tuminec*, *Goricë e Madhe* në *Gorna Gorica* dhe *Goricë e Vogël* në *Dolna Gorica*, etj. Partitë maqedonase dhe kryetari i kësaj komune, Edmond Temelko, theksoi se me këtë vendim tashmë është përmirësuar historia dhe se po kthehen emrat e fshatrave që siç tha ai u shqiptarizuan në vitin

1973 nga ana e ish-parlamentit komunist të kohës së Enver Hoxhës. Vendimi për emrat e rinj të fshatrave në afat prej 10 ditëve duhet të miratohet nga Prefektura e Korçës, ashtu që vendimi të hyjë në fuqi (INA, 16. 4. 2013). Për përdorimin e enrave të vendeve vendos popullata vendëse, ashtu siç ka dëshirë ajo. Riemërtimet administrative të toponimeve në vështrim kanë qenë të gabuara, ato as nuk janë sllave, e as nuk kanë mundur të shqiptarizohen. Ta zëmë, topiku *Leska* në thelb rrjedh nga një emër vetjak i proveniencës romane *Lesca*, *Lisca*, *Lisiça* (Jireček 1962: 296), e jo nga apelativi sllav *leska* “lajthi”, që të mund të “përkthehej” me *Lajthizë*. Po kështu, edhe topiku *Shulin* ruan një emër vetjak homonim *Shulin* (*Shul-in*), *Zaroshkë* nga një emër personal *Zaro*, *Golomboç* nga një emër familjar *Colombi*, *Colombis*, *Columbis*, etj. (Jireček 1962).

Toponimia nuk bëhet me urdhra dhe në të s'duhet ndërhyrë

7. Si në asnjë fushëveprimtari tjetër historike e gjuhësore, në debatet për toponimet, të zhvilluara nga institucione dhe individë të ndryshëm, në Maqedoni, në Kosovë, në Shqipëri dhe në vende të tjera të arealit ballkanik etj., në prirjet dhe tendencat e tyre për ekskluzivitet nacional, janë përzier e përzihen shpeshherë diletantizmi dhe grotesku, paçka se në këtë fushë kërkohet profesionalizëm dhe jo ngarkesa emocionale të nacionalizmit primitiv. Gjuhëtarë e onomasticienë, në vend që të ngrihen në nivelin e dijeve moderne linguistike dhe të reflektojnë pozitivitet me gjuhët dhe me kulturat e popujve fqinj, me të cilët bashkëjetojnë prej shekujsh e mijëvjeçarësh, të shpesh të bien pre e propagandës ideologjike dhe suprimojnë të vërtetën shkencore, duke përzier toponimet me politikën. Po kështu edhe mediet dhe establishmenti politik i kanë mëshuar në shumë kultivimit të urrejtjes kundër gjuhës së tjetrit, toponimisë, kulturës, trashëgimisë, identitetit të tjetrit, pa e ditur se asgjë nuk mund të përfitosh nga

fushata të tilla; kjo veçse do të na bënte qesharakë dhe donkishotë. Linguisti i shquar italian Tullio De Mauro thotë me të drejtë se gjuha është më e fortë se ligji. Është e pamundur që një fuqi politike të censurojë fjalë (toponimet) që nuk i pëlqejnë. “*Lirinë tonë gjuhësore mund ta mbrojmë e ta zgjerojmë vetëm duke kuptuar si funksionon organizmi – gjuhë*” – thotë Walter Meyers.

Gjuha ka evolucionin e vet të natyrshëm dhe si e tillë nuk u nënshtrohet ndryshimeve arbitrare të pushteteve politike, qofshin ato dhe diktatoriale. Që gjuha të funksionojë, duhet të ketë një kod të përbashkët të kuptimit të fjalëve. Në fakt, të gjithë shqiptarët kanë ndërtuar një kod të tillë që historikisht *Shkupit* t'i thonë *Shkup* e jo *Skopje*. Nga ana tjetër, kur nuk i përdor fjalët dhe toponimet ashtu si duhet, atëherë “thyen paktin” dhe komunikimi prishet. Le të supozojmë që shqiptarët e Maqedonisë të thonë *Skopje*, kurse shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës *Shkup*, atëherë kodi gjuhësor i tyre prishet. Sa për kuriozitet: në evolucionin gjuhësor emri antik *Scupi* (shq. Shkup) nuk ishte *Skopje* që u bë *Shkup*, por ishte *Shkup* që te grekët u bë *Skopia*, e te sllavët *Skoplje*.

Gjuhëtari Ardian Vehbiu, në një shkrim eseistik “*Gjithnjë nisemi për mirë*”, në përsiatjet e tij për ndërhyrjet në onomastikë shprehet: “*Dëmet e ndërhyrjeve në gjuhë do t'i krahasoja me dëmet e shpyllëzimit të kodrave dhe terreneve të pjerrëta; ti nisesh me idenë që të mbjellësh atje pemë ose të hapësh tokë bujqësore, por në fakt vetëm sa ia ekspozon dheun erozionit dhe mbetesh me gisht në gojë...ndërhyrjet masive në sisteme që nuk i kuptojmë mirë, sjellin gjithnjë pasoja të padëshiruara. Se cilat do të jenë këto pasoja të padëshiruara, në rastin e toponimeve, shpresoj, gjithsesi, të mos e marr vesh kurrë*”.

Për profanët dhe partizanët e toponimisë politike që nuk i dinë mirë ligjet e gjuhës dhe të toponimisë, e nisen me guxim të bëjnë ndërhyrje në këto fusha, gjuhëtari i njohur francez Andre Martine na jep këtë përkufizim për linguistikën: “*Linguistika është njëra nga aktivitetet më të mira. Por ajo mund të përdoret edhe për qëllime*

të dëmtshme. Kjo vlen sidomos për linguistikën “e keqe”. E keqe është ajo linguistikë që nuk është shkencore, që nuk përfaqëson më shkencë. Në qoftë se nisin të hyjnë në të temperament, karaktere dhe paragjykimet të ndryshme, atëherë ajo nuk është më shkencë”. E tillë është dhe toponimia. Në qoftë se edhe këtu hyjnë elementë regresivë: anarkia, arbitrariteti, ideologjia, diletantizmi, sharlatanizmi, ajo bëhet “toponomastikë e keqe”. Toponimia, sikurse dhe historia, nuk bëhet me urdhra dhe në të s’duhet ndërhyrë (Arben Puto). Është me rëndësi të theksohet se toponimia shqiptare në Maqedoni nuk është dhe nuk mund të jetë çështje e brendshme shtetërore maqedonase, ashtu siç nuk është dhe nuk mund të jetë as çështje e brendshme e disa “patriotëve” shqiptarë, të cilët me “shqipërimet” e tyre diletanteske bëjnë karikatura toponimike. “Onomastika është mjaft e gjerë dhe ka hapësira për të gjithë, po vetëm brenda kufijve të njohurive të thelluara. Ajo nuk guxon të shndërrohet në fushë ku mund të thuhet gjithçka nga gjithkush, pa farë përgjegjësie” (Ismajli 1979: 587).

BIBLIOGRAFIA

Академик Ќулавкова: *Албанското малцинство врши психолошка пресија врз Македонците*, intervistë, publikuar në numrin 83 të javores Република, 4.04.2014.

Bici 1995 = Bici, Veli, *Disa probleme të emërtimit të fshatrave*, Gjuha jonë, ASHRSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1–4/1995, Tiranë.

Ismajli 1979 = Ismajli, Rexhep, *Onomastika e Kosovës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1979.

Jireček 1962 = *Zbornik K. Jirečeka II*, Beograd, 1962.

Leka 2007 = Leka, Ferdinand, *Shkrime gjuhësore, letrare, sociale*, Infobotues, Tiranë, 2007.

Tanturovska 20013 = Tanturovska, Lidija, *Jazičen beležnik*, Institut za makedonski jazik “Krstе Misirkov” – Skopje, Skopje, 2013.

XHEMALUDIN IDRIZI

PËR ETIMOLOGJINË E DISA TOPONIMEVE TË FSHATRAVE TË RRETHIT TË SHKUPIT

Shkurtimore

Çështja e toponimeve në Republikën e Maqedonisë është një fushë e trajtuar më pak. Kjo fushë meriton një kujdes dhe trajtim të mirëfilltë nga institucionet shkencore shqiptare dhe nga studiues – onomastë shqiptarë jo vetëm nga Maqedonia por edhe më gjerë. Me etimologjinë e ojkonimeve të fshatrave të rrethit të Shkupit është marrë onomastika sllave. Do përmendim disa prej tyre si Jovan Trifunovski, Jovan Haxhivasileviçi, Petar Skok, Trajko Stamatovski etj., ndërsa nga ajo shqiptare Haki Ymeri, Qemal Murati dhe Xhemaludin Idrizi. Në trajtimin e etimologjisë së disa ojkonimeve të këtij rajoni hasen interpretime të drejta të mbështetura në shkencën e onomastikës, por ka edhe trajtime subjektive që nuk përkojnë me shkencën e onomastikës. Kështu p.sh. Jovan Trifunovski duke trajtuar etimologjinë e fshatit Strugudicë, thotë se emri i këtij ojkonimi rrjedh nga fjala strah – frikë, nekoj imal strav dhe fshatin e emërton Strahojadica, që është i regjistruar në kadastrën e Shkupit. Kështu ndodh edhe me shumë trajtime të tjera të toponimeve të rrethit të Shkupit po edhe më gjerë. Për këtë paraqitet nevoja e mbledhjes dhe trajtimit të toponimeve në baza dhe parime të mbështetura në shkencën bashkëkohore.

1. Toponomia është një shkencë e re. Ajo kërkon punë jokatibetike, por të terrenit. Andaj, materiali toponimik duhet

mbledhur , sistemuar dhe studiuar me kujdes të veçantë nga studiues të mirëfilltë të shkencës së toponomisë.

Në Republikëne Maqedonisë shkencën e toponimisë maqedonase e ka studiuar këtë me një intensitet të forcuar , veçanërisht në kohën më të re duke botuar një numër të konsiderueshëm punimesh, librash e fjalorësh me toponime të mbledhura, të sistemuara dhe të trajtuara nga aspekti semantik, gramatikor, etimologjik etj. Me toponiminë e viseve të banuara me shqiptarë në Republikën e Maqedonisë janë marrë disa studiues shqiptarë nga Maqedonia, të cilët kanë hedhur hapat e para të kësaj shkence të rëndësishme.

2. Në toponiminë e viseve shqiptare në Republikën e Maqedonisë ndikime të veçanta kanë pasur gjuhë të huaja si gjuhët sllave e gjuha turke. Sllavët në Ballkan vijnë dhe vendosen nga shekulli VI–VIII, ndërsa osmanët në shekullin XIV.

Prof. Eqrem Çabej thotë se Osmanët janë dukur në Shqipëri si ushtarë rrogëtarë (mercenarë) para se të vinin si pushtues. Perandori bizantin Androniku III Paleologu , me rastin e një ekspedite ushtarake në Shqipëri në vitin 1330, për të shuar një kryengritje që kish plasur në krahinat jugore, solli me vete edhe mercenarë osmanë. Kjo ndeshje e parë turko–shqiptare ka rëndësi dhe për gjuhësinë, sepse na bën të mendojmë që ndikimi i turqishtes në shqipen ka nisur që përpara sundimit të vendit.(Eqrem Çabej në Studime Gjuhësore, Prishtinë, 1976, f. 64–65.) Në Gadishullin Ballkanik si edhe ndër shqiptarë u përhap edhe feja islame , përhapja e së cilës zgjati disa shekuj me radhë. Besimi i ri, sipas prof. Çabejit i dha shkas të fortë dhe përhapjes së turqishtes e të huazimeve turke në këto anë. Sipas prof. Çabejit, ndikimi turk është një ndikim qytetar, i cili prej qyteteve u përhap dhe në katunde.

3. Përndryshe, në Gadishullin Ballkanik osmanët zunë vend më 1354 duke pushtuar Galipolin afër Stambollit, më 1362 pushtuan Adrianopojën, Edrenenë e sotme, që bëhet kryeqyteti i Perandorisë Osmane. Me luftën e Kosovës më 1389 merr fund mbretëria e serbëve e njëkohësisht edhe koalicioni ballkanik që i kishte shkuar në ndihmë. Gjatë shekullit XV sulltanët, Murati II e Mehmeti II, pushtuan hap më hap tërë Gadishullin Ballkanik.

4. Një nga studiuesit sllavë të toponimisë në rrethin e Shkupit është gjuhëtari i shquar kroat Petar Skok. Ai qëndron në Shkup në vitin 1929 me detyrë mbledhjeje të materialit gjuhësor e toponimik të rrethit të Shkupit. Puna e tij kërkimore shkencore shtrihet në katër drejtime, në drejtim të Karshiakës së Shkupit, lumit Pčinja, Kaçanikut dhe Dervenit drejt Tetovës. Rezultat i këtij kërkimi shkencor në rajonin e Shkupit të këtij studiuesi të dalluar rezulton me veprën “Iz toponomastke Juzne Srbije” Beograd, 1935. Në të përveç materialit të mbledhur e studiuar toponimik, paraqitet edhe një hartë toponomike e fushëgropës së Shkupit me shkallë 1: 400000.

Në këtë hartë legjenda flet mbi fshatrat e banuara me serbë, shqiptarë, osmanë, serbë dhe shqiptarë, serbë dhe osmanë. Në të bie në sy regjistrimi i enrave të fshatrave në gjuhë sllave, si Grushinci (Grushinë), Aldinci, Crni Vrf, Batinci, G. Konjare, S.Konjare, D.Konjare (turq. Gyreler) etj. Suha Gora, Karaxhica, Skopska Crna Gora, Zheden, Shar Planina, mandej krahinat Karshijaka, Torbeshija, Kargalak, Kotorci, Blatija. Në vazhdim do bëjmë fjalë mbi disa ojkonime.

5. Draçeva . – Draçeva është ndër vendbanimet më të mëdha të rajonit të Karshiakës.

Emërtimin e këtij vendbanimi e gjejmë në dokumentet mesjetare. Përmendet që në vitin 1300 . Në shekullin XV Sulltan Mehmedi II këtë vendbanim ia ka dhuruar Isak – beut, ndërsa ky më 13 gusht të vitit 1466 ia ka dhuruar teqes dhe medresesë në Shkup .

Në dokumentet turke të shekullit XV ky vendbanim na del me emrin Draçevo.

Te J.H. Vasileviçi thuhet se gjendet në të djathtë të lumit Markova Rekë, afër fshatrave Axhovë, Lisiçe e Poshtne, Lubosh dhe Studeniçan. Aty kalon rruga Shkup – Zelenikovë. Në veprën e vet e përmend edhe M. Purkoviçi .

Në vitin 1889 (sipas Verkoviçit) ka pasur 1144 banorë, në vitin 1900 (sipas Kënçovit) 1180 bullgarë të krishterë. Tani kryesisht është i banuar me maqedonas.

Etimologjia e emrit na del prej rrënjës draç < Prunus spinosa = murriz dhe prapashtesa posesive sllave – evo. Mirëpo nuk duhet larguar edhe mendimi se ky ojkonom mund të ketë lidhje me toponimin Draç (Durrës) në bazë të migrimeve perëndim – lindje në periudha të ndryshme historike. Hipoteza mbetet për t'u vërtetuar.

6. Vërtekica. Vendbanimi ndodhet në rrafshin e malit Kitkë. Kufizohet me fshatrat Studeniçan dhe Pagarushë. J.H.Vasileviçi konstaton se fshati ndodhet në terren malor me 15 mullinj të ndërtuar me nga një gur . Në fshat ekziston një teqe me 6 varreza shqiptare dhe një xhami. Dikur, shton Vasileviçi, në teqe shkonin të shërohen personat e sëmurë psikikisht ku dënoheshin me uri, burg po edhe me dajak. Ata ,sipas Vasileviçit, i ka rrahur shehu i teqes .

Sipas dokumenteve mesjetare Vërtekica del njaft e vjetër. Emrin e fshatit e gjejmë të regjistruar në dokumentin e vitit 1560 ose 1570 të ruajtur në manastirin e Matkës së Shkupit . Në të janë shkruar emrat e 42 kontributdhënësve nga ky fshat. Për vjetërsinë e Vërtekicës dëshmojnë edhe dokumentet turke të shekullit XV, i shkruar në trajtën V-r-t-k-ç.

Në vitin 1900 (sipas Kënçovit) ka pasur 360 shqiptarë muhamedanë, ndërsa në vitin 1981 229 shqiptarë dhe 7 turq.

Etimoloigia e këtij ojkonimi është e lidhur me fjalën sllave vrutok " gurrë – burim " që mbështetet me burimin që ekziston në këtë fshat. Por mund të shtrohet hipoteza, se mund të ketë lidhje me emrin vrta~ – "xhibër", vend ku fryn era në të tëra anët dhe formohet xhibre (вртача), hipotezë kjo që kërkon hulumtime të më tutjeshme.

7. Pagarusha. Në perëndim kufizohet me Koliçanin e Posh-tëm, ndërsa në lindje me Vërtekicën. Ndodhet në malin e Kitkës. Emrin e këtij vendbanimi shumica e shpjegojnë se rrjedh prej fjalës Pad Urosha, sepse disa e shqiptojnë Padarusha. Sipas J.H. Vasileviçit në fshat dihet vendi i kishës .

Fshati është shumë i vjetër, sepse përmendet në dokumentet mesjetare të vitit 1348 . M.Purkoviçi konstaton këtë : "gjatë ndarjes së pronës së Hilandarit më 12 janar të vitit 1454 si dëshnitarë përmenden : Nikolla Slladanoviç, Bozhidar Dojkoviç, Radosllav Sestromill, Bratan Gradiçeviç dhe Oliveri nga Pagarusha. Petar Skoku emrin e këtij ojkonimi e regjistron në trajtën Padarosha .

Emrin e Pagarushës e gjejmë edhe në dokumentet turke të shekullit XV.

Në vitin 1889 (sipas Verkoviçit) ka pasur 177 banorë, në vitin 1900 (sipas Kënçovit) 15 bullgarë të krishterë dhe 380 bullga-

rë muhamedanë, ndërsa në vitin 1981 283 turq. Banorët e fshatit gjuhë amtare kanë maqedonishten.

8. Draçevica . Ndodhet ndërmjet fshatrave Koliçan i Epërm, Umovë dhe Varvarë. Draçeviçasit mendojnë se fshati i tyre është shumë i vjetër.

Emrin e Draçevicës e hasim në dokumentet turke të shekullit XV. Kështu në vitin 1544 regjistrohet si Pusta Draçevica me 21 familje të krishtera, mirëpo në dokumentet e vitit 1568 nuk del i regjistruar .

Jovan Trifunovski thotë se për shkak të mospasjes së ujit ky vendbanim nga banorët maqedonas thirret edhe Suva Draçevica, " Draçevicë e thatë ".

Etimologjinë e këtij toponimi e ka shqyrtuar Petar Skoku . Ai thotë se ky toponim nuk duhet shqyrtuar veçmas, meqenëse si i tillë haset shpesh në toponiminë e territorit të ish – Jugosllavisë.

Për toponimin Draçevicë bën fjalë J.Schultz, GT, 44. Ai thotë "se "draça" është denominal nga sllavishtja e vjetër dero, dbrati dhe se "draç" paraqitet në toponimi me shumë sufikse". Sipas tij kuptimi themelor i këtij toponimi është " luginë e ngushtë, luginë, grykë ndërmjet kodrave, lugore". Kuptimin e njëjtë e vërtetoi edhe Vasmeri në Greqi në Die slaven in Griechenland, Berlin 1941, f – 216 (21), 225 (18,19) ³ .

Petar Shimunoviçi në veprën e tij "Toponimija otoka Braça", Draçevicën e lidh me emrin draç (prunus spinosa) , që paraqet dru me të cilin rrethohen ara të banorëve të këtyre vendbanimeve.

Draçevica në vitin 1889 (sipas Verkoviçit) kishte 268 banorë, në vitin 1900 (sipas Kënçovit) 150 shqiptarë muhamedanë, ndërsa në vitin 1981 580 shqiptarë.

9. Kalldireci (Kaldirec) ndodhet në rrugën që shpie në malet Karaxhicë e Jakupicë. Në hartën toponimike të punimit të Petar Skokut e gjejmë në formën Kalldirec. Domethënien e këtij toponimi Petar Skoku e nxjerr të paqartë.

Fshati është i ri i formuar prej blegtorëve të fshatrave të afërm në shekullin XIX. Tani nuk ka asnjë shtëpi. Këtu dikur banonte familja e Neze , me prejardhje nga fshati Koliçani i Epërm.

Etimologjia e këtij ojkonimi del e errët.

10. Krusha (Круша). Është vendbanim i formuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX nga blegtorë të fshatit Koliçan i Epërm. Toponimi ka prejardhje sllave dhe lidhet me круша (Pirus communis) "dardhë". Apelativi krusha, krushka haset shumë në toponiminë e Ballkanit si p.sh. Крушеани (në Prilep), Крушевица (Kavadar e Prilep), Крушево (Krushevë, Serez), Крушица (Kërçovë e Sveti Nikollë), Крушје (Veles), Krushopek (Shkup) , Крушевац në Serbi etj.

V.Pjanka këtë ojkonim e nxjerr si një emër topografik primar prej apelativit krusha në emër kolektiv.

Dr. Qemal Murati emrin e vendbanimit Krushje, fshat i rrethinës së Prespës, e nxjerr nga një antroponim Krush me sufiksin – je. Antroponimi Krus haset në regjistrat turke të shekullit XV në varicionin Krusijak (TD IV). Mendim të njëjtë shpreh edhe Blazhe Koneski kur bën fjalë për topikun e Krushevës .

11. Paligradi. Ndodhet në lartësi prej 1000 m. mbi nivelin e detit, në jug të malit Kitkë dhe në anën e majtë të lumit Kadina Rekë. Fshatrat më të afërm janë Tisovica, Alldinca dhe Gaberi. Larg Shkupit ndodhet afro 40 km.

Për vjetërsinë e fshatit flasin rrënojat (muret) në vendin e quajtur Gropa me Ujë që gjendet afër fshatit. Këto gjurmë

mendohet se janë shumë të vjetra dhe se janë shenja vendbanimi ose të ndonjë kalaje. Në lidhje me emrin e këtij fshati Petar Skoku mendon se ai shënon një terren që është formuar me djegie. Njësoj mendon edhe Jovan Trifunovski . Sipas tij fshati është "shkatërruar nga breshëri". Në lidhje me etimologjinë e këtij ojkonomi mendohet se kemi të bëjmë me një kompozitë : Pal—antropomim shqiptar dhe grad (sllav, grad »kështjellë, fortesë«), që do të thotë Fortesa e Palit.

Për lashtësinë e Paligradit flasin edhe gërmadhat e mbetura. Në të ekziston mikrotoponimi Klisa (turq. klise »kishë«) që flet për vjetërsinë e tij.

Emri i këtij vendbanimi del në dokumentet turke të shekullit XV i shkruar në trajtën Pallgrad. Nuk e hasim te Verkoviçi, ndërsa te Kënçovi emri del në trajtën Paligrad me 230 banorë shqiptarë—muhamedanë. Në regjistrimin e vitit 1981 Paligradi kishte 333 shqiptarë, 31 turq dhe 8 myslimanë. Të gjithë banorët e fshatit flasin gjuhën shqipe.

12. Vërzhallë. Ndodhet 500 m. mbi nivelin e detit në juglindje të Shkupit, 30 km. larg tij.

Fshati përbëhet prej katër mëhallave: Zimallarve, Dautallarve, Lamallarve dhe Kasamallarve. Kufizohet me fshatrat Oreshan, Zelenikovë, Gaber, Paligrad, Tisovicë dhe Moranë.

Emrin e këtij vendbanimi të vjetër shqiptar e hasim në veprën e J.H. Vasileviçit të shkruar në trajtën Vrezhallce, duke konstatuar se ai shtrihet në majën e malit Kitkë të Karshiakës . Ky autor i regjistron këto mikrotoponime: Laka, Baskatun, Perçikapa, Torbeshrupasi, Ç'ngene Bunari, Krst, Bagllar, Simonica, Oravllek, Darbata, Shulla, Xheden (Zheden), Troja, Klise dhe Tumba. Turqit emrin e fshatit Vërzhallë e regjistrojnë si Ivri Salgja. Në lidhje me etimologjinë e këtij ojkonomi

T. Stamatovski mendon se emri Vrazhale rrjedh nga: Vrag, sllav. vrag » dreq «.

Në vitin 1889 (sipas Verkoviçit) Vërzhallë ka pasur 164 bano-rë, ndërsa emri i tij është shkruar në trajtën Vrazhane. Në vitin 1900 (sipas Kënçovit) ka pasur 240 shqiptarë muhame-danë, ndërsa emri i tij është shkruar në trajtën Vrazhallce. Në regjistrimin e vitit 1981 Vërzhallë ka pasur 145 shqiptarë dhe 130 të deklaruar si turq.

13. Strugudica. Ndodhet në një shpat të malit Mokër nja 25 km. larg Shkupit. Fshatarët mendojnë se ky vendbanim është i vjetër rreth 350 vjet. Në bisedë me informatorin mësova se ky vendbanim është formuar nga banorët e një vendbanimi tjetër të quajtur Rajko, që ndodheshte dikur në rrugë për në Veles. Prej aty kanë ardhur dy vëllezër, emrat e të cilëve nuk dihen. Fshati është i përbërë prej dy mëhallave: Mëhallës së Epër dhe Mëhallës së Poshtër. Mbi 90% të banorëve janë të një gjaku, të fisit Berishë, ndërsa pjesa tjetër e vogël e banorëve kanë ardhur nga fshati i afërm Tisovicë.

Fshati Strugudicë shtrihet në një lartësi prej 380 m. mbi nivelin e detit.

Jovan Trifunovski mendon se nja 500 m. larg fshatit ndodhet rrënoja më e vjetër, për të cilën fshatarët thonë se ka qenë vendbanim "romak". Aty janë gjetur themele shtëpish, tjegulla dhe monedha të bakrit . Gjithashtu ky autor përmend edhe një rrënojë tjetër të kohës më të re. Në lidhje me emrin e këtij ojkonimi autori shërbehet me të dhëna naive të fshatarëve, të cilët mendojnë se emri Strugudicë (Strahojadica) duhet lidhur me fjalën sllave, strav » frikë « (nekoj umrell od strav) , » dikush ka vdekur nga frika «. Në lidhje me etimologjinë e emrit të këtij fshati nuk është thënë diçka më konkrete.

Për lashtësinë e këtij vendbanimi na mungojnë dokumente nga periudha e Mesjetës dhe nga ajo osmane.

Në vitin 1889 (sipas Verkoviçit) Strugudica ka pasur 171 banorë, ndërsa emri i tij del i shkruar në trajtën Strahoadci. Në vitin 1900 (sipas Kënçovit) fshati ka pasur 240 shqiptarë muhamedanë, ndërsa emri i tij del i shkruar në trajtën Strakojadica. Në vitin 1981 149 banorë u deklaruan shqiptarë, ndërsa 49 si turq .

14. Nerezi. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shkupit pranë Krushapekut dhe Sopishtës, i vendosur në shpatin e malit Vodno, aty ku gjendet manastiri Shën Pantelejmon. Për Nerezin shkruan J.H. Vasileviçi i cili përmend lugun e fshatit "Golemi most", Babindollin në drejtim të Krushapekut dhe ca emërtime të tjera si: Gumenie, Mllaka dhe Kapishtec. Mbi Manastirin e Shën Pantelejmonit në kodrën Foja përmend një burim të fortë që quhet Careva Voda, uji i të cilit është shumë i ftohtë, i pastër dhe me shumë shije. Afër kodrës Foja ndodhen brigjet Saurut dhe Meçkina Dupka. Mikrotoponimin Careva Voda shqiptarët dhe turqit e thirrin Sulltansui.

Në vendin e quajtur Zhdanec hasen rrënoja të vjetra. Vendi nën Zhdanec quhet Gradishte Poshtër, ndërsa mbi Zhdanec Gradishte Epër. Ky vend tani është shndërruar në ara.

J.H. Vasileviçi thotë se Nerezi para Luftës së Parë Botërore ka pasur 103 shtëpi, prej të cilave 38 serbe dhe të tjerat shqiptare. Kisha e fshatit shën Ilja ndodhet në pjesën e poshtme të fshatit. Atë e ka ndërtuar ose meremetuar njëri nga mbretërit bizantinë. Fshati Nerez, bashkë me fshatin Vodno , përmendet në dokumentin e mbretit Millutin, të cilin ia ka dhuruar manastirit Shën Gjorgja Skoropotizhnog të Shkupit.

Emri i këtij vendbanimi del në dokumentet turke të shekullit XV i shkruar në trajtën N-i-r-z.

Sipas fjalëve të fshatarëve ky vendbanim emrin e ka marrë sipas vendbanimit Nerez të anës së Rekës – të Dibrës. Fshat me emrin Nerez ka edhe në Strugë. Mirëpo banorët nuk dinë kur janë vendosur në këtë vendbanim. Thonë se kanë ardhur si ortodoksë, ndërsa fenë islame e kanë marrë këtu.

Në këtë fshat kanë jetuar familje me këto llagëpe: Mushkallarët, Kaçipulët, Dajallarët, Jongallarët dhe Cingallarët, ndërsa tani jetojnë vetëm Dajallarët, Jongallarët dhe ardhacakë nga Setapetka dhe Çifliku.

Në vitin 1900 (sipas Kënçovit) Nerezi i Epërm ka pasur 260 bullgarë të krishterë dhe 300 shqiptarë muhamedanë.

Në lidhje me etimologjinë e këtij ojkonimi ka mendime nga më të ndryshmet. Petar Shimunoviçi mendon se M. Bartoli në "Das Dalmatische II" Vjenë 1906, f. 253, toponimin në formën Nerez gabimisht e nxjerr me origjinë rumune. Petar Skoku pasi i kthehet disa herë kësaj problematike, etimologjinë e këtij toponimi e nxjerr nga baza rëzb, përkatësisht nga kompozita nerëzb "pustopoljina" »tokë e papunuar«. V. Mazhuraniç dhe J. Ostojiç mendojnë se Nerez ka domethënie: "Vreshta të lëna pasdore, që nuk krasiten". Edhe V. Pjanka këtë toponim e sheh të ardhur si apelativ sllav. nerez, që sipas tij ka kuptimin e vreshtës së pakrasitur "nerezhenolozje". Ndërsa Qemal Murati këtë toponim e sheh të prejardhur nga një emër personal Nero. Fshatra me emrin si Nerashtë dhe Nerovë i gjejmë në Tetovë dhe në Prilep.

15. Arnaqi— ja. Është fshat afër Shkupit që mendoj se për bazë ka përbërjen nga gjuha turke arnaut < shqiptar dhe koy < fshat , fshat shqiptarësh, ndërsa Petar Skoku në Toponomastika iz Juzne Srbije mendon se ky emër rrjedh nga gjuha greke,

qengj ose lëkurë qengji (në Iz toponomastike Juzne Srbije f.117, Glasnik Skopskog Naucnog Drustva, Beograd, 1935.)

Përfundim

Pjesa më e madhe e toponimeve që lidhen me emërtimin e disa fshatrave të rrethit të Shkupit janë me prejardhje sllave. Mirepo bie në sy edhe interpretimi i shtrembëruar i disa emërtimeve të fshatrave të rrethit të Shkupit. Duket qartë interpretimi i gabuar i toponimit Paligrad nga Petar Skoku dhe Jovan Trifunovski. Në lidhje me emrin e këtij fshati Petar Skoku mendon se ai shënon një terren që është formuar me djegie. Njësoj mendon edhe Jovan Trifunovski. Sipas tij fshati është "shkatërruar nga breshëri". Në lidhje me etimologjinë e këtij ojkonimi do themi se keni të bëjmë me një kompozitë : Pal-antroponim shqiptar dhe grad (sllav, grad »kështjellë, fortesë«), që do të thotë Fortesa e Palit. Njësoj ndodh edhe me interpretimin e toponimit Strugudicë, maqedonisht me qëllim është shkruar Strahojadicë. Në lidhje me emrin e këtij ojkonimi autori shërbehet me të dhëna naive të fshatarëve, të cilët mendojnë se emri Strugudicë (Strahojadica) duhet lidhur me fjalën sllave, strav » frikë « (nekoj umrell od strav) , » dikush ka vdekur nga frika «. Në lidhje me etimologjinë e emrit të këtij fshati nuk është thënë diçka më konkrete. Për zbrëthimin e drejtë bazuar në parimet shkencore të një numri të toponimeve të disa fshatrave të Shkupit nevojiten hulumtime të mëtutjeshme nga specialistë të kësaj fushe.

Literaturë e shfrytëzuar

1. Çabej E. Studime gjuhësore III, Prishtinë 1976, f. 64–65
2. Demiraj Sh. Gjuhësi Ballkanike, Logos–A Shkup, 1994
3. Skok P. Iz toponomastike Juzne Srbije, Glasnik Skopskog Društva, Beograd 1935
4. Idrizi Xh. Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit, Shkup, 2003
5. Trifunovski J. Slivot na Markova Reka, Filozofski fakultet na Univerzitetot Skopje, Skopje 1958
6. Trifunovski J. Poteçenieto na Kadina Reka, Filozofski fakultet na Univerzitetot Skopje, Skopje 1952
7. Vujaklija M. Leksikon stranih reči i izraza, Prosveta Beograd, 1970
8. Karta na Republika Makedonija, Teritorijalna podelba, NIP “Nova makedonija”, Skopje, 1996
9. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980
10. Vlozhimjezh P. Toponomastika na OPB, Skopje, 1970
11. Purković M. Popis sela u srednjevekovnoj Srbiji, Godišnjak Skopskog filozofskog fakulteta IV, Skopje 1940
12. Stamatovski T. Makedonska onomastika, Skopje 1990

BEGZAD BALIU,

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit, Prishtinë

TOPONIMIA SHQIPTARE NË MAQEDONI NË STUDIMET ONOMASTIKE

Përmbajtja: *Në studimet e gjertanishme albanologjike është shtruar shpesh vendi i formimit të popullit shqiptar dhe i gjuhës shqipe për shkak të, siç thuhej, mungesës së dëshmive të njafueshme në arealin bregdetar. Pavarësisht nga ky konstatim, nuk mund të thuhet se është sjellë njafueshëm një pamje sistematike dhe nuk është paraqitur një strukturë e njafueshme gjuhësore, përmbajtjesore dhe semantike e toponimisë kontinentale të hapësirës shqiptare. Kjo është arsyeja pse në kumesën time do të synoj ta sjell një pamje të plotë të studimeve shqiptare për hapësirën shqiptare në Maqedoni, e cila e plotëson pikërisht këtë qëllim.*

Fjalë dhe shprehje nyjë: *Toponimia shqiptare, hapësira shqiptare, gjuha shqipe, Maqedonia, gjuhët e Ballkanit, strukturat toponimike të arealit ballkanik*

Prej gjeografit serb Jovan Cvijiq te ballkanologët Selishçev e Qemal Murati

Ka disa dekada, për të mos thënë gjatë gjithë shekullit XX, që studiues të huaj: kryesisht serbë, rusë, bullgarë e të tjerë, botojnë studime, materiale dhe vepra shkencore për gjendjen e identitetit të popullsisë dhe vendbanimeve në hapësirën shqiptare nën Maqedoninë e sotme, por deri vonë nuk kishim studime dhe vepra të autorëve shqiptarë për këtë hapësirë, nëse përjashtojmë ato tekste të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit

XX, të cilat botoheshin në shtypin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare të diasporës. Kujtojmë këtu Selishqevin, Blazhe Koneskun, Maksimilian Lambercin, Karlo Taliavinin, dhe vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX studiuesit shqiptarë: Petro Janurën, Fadil Sulejmanin, Remzi Nesimin, Zihni Osmanin, Hamit Xhaferin, Vebi Bexhetin, Naim Bashën, Haki Ymerin dhe në mënyrë të veçantë studiuesit e leksikut e të toponimisë: Qemal Muratin, Asllan Hamitin, Xhemaludin Idrizin, Mustafa Ibrahimit, Vebi Rrustemit, Izmit Durnishit etj.

Tetë dekada më parë në Sofje u botua libri i linguistit të njohur rus Selishqev, *Slavjanskoe naselenie v Albanii*. Dija shqiptare e kohës, me përgatitjet e saj modeste, mund të shkruante ndonjë artikull gazete a reviste të kohës, por nuk e kishte arritur përmasën e shkollës evropiane, me të cilën kësaj vepreje do t'ia tregonte vendin e duhur. Kjo është arsyeja pse këtë detyrë e merr Norbert Jokli, albanologu më i madh i shekullit XX, dhe përgjigjen e tij shumë të gjatë, prej rreth dhjetë tabakësh shtypi, e fillonte me këtë sintezë, me të cilën po e fillojmë edhe ne kumtesën tonë: "Filologjia sllave pothuaj që nga themelimi i saj, sidomos që me brezninë e dytë të gjurmuesve të saj, u ka kushtuar vëmendje plot dashuri studimeve albanologjike fqinje. Nëse Kopitari ishte njëri nga pionierët e gjurmimit të Ballkanit dhe me këtë edhe i hetimit të marrëdhënieve sllavo-shqiptare, nëse Vuku në veprimtarinë e tij mbledhëse mori njëmend parasysh edhe këngën popullore shqipe, por më shumë me një lloj dashurie të fshehtë, Miklosichi nuk është vetëm krijuesi i shkencës gjuhësore sllave, por edhe njëri nga themeluesit më të shquar të gjurmimit të historisë gjuhësore në lëmin e shqipes"¹.

¹ Norbert Jokli, *Slaven und Albaner* (Rezensionsaufsatz zu A. M. Seliščev, *Slavjanskoe naselenie v Albanii*, Sofia 1931). – „Slavia“, 1934, 13, 281.

Duke u marrë me “përcaktimin e rrjedhës së kufirit jugperëndimor të truallit gjuhësor bullgar, pra kufizimin e rajonit kufitar shqiptaro-sllav”, – shkruante Norbert Jokli, – “Selishqev mbështetet këtu në punime më të vjetra, më të reja dhe të fundit, si ato të Hanit, Sainerit, Mlladenovit, Millosavljeviqit (Juzni Progled IV/ 2, Skopje 1929) etj. Me këto vrojtme etnografike–gjeografike gjuhësore, vazhdonte Norbert Jokli, – lidhen parashtrime historike lidhur me çastin e shfaqjes së parë të shqiptarëve në Maqedoni. Në këtë tekst polemizues Norbert Jokli do të hap edhe një paradigmë tjetër të njohur po jo edhe të theksuar gjithnjë në studimet ballkanike, projektin e gjeografit Jovan Cvijiq, si një hap fillestar për të caktuar njëkohësisht edhe kufijtë e një lufte për trojet kinse serbe, e cila do të përsëritet tri herë gjatë shekullit XX. Jashtë projektit të tij, përkatësisht jashtë kufijve të tij nuk do të dalin as përfaqësuesit eminentë të elitës shkencore ruse, të cilët në Ballkan më shumë se sa mision shkencor do të kenë mision politik dhe strategjik. Albanologu i madh Norbert Jokli do të vë re se në këtë vepër të Selishqevit “një paraqitje veçanërisht e hollësishme i kushtohet rrjedhës historike të shqiptarizmit të dy krahinave maqedonase; së pari është Reka e Epërme, e folnja sllave e dikurshme e së cilës karakterizohet si e Maqedonisë Perëndimore. Materiali për paraqitje e konkluzione është marrë nga vepra e Smiljanit “Mijaci, Gorna Reka i Mavrovsko Polje” (“Naselja i poreklo stanovnistva” nr. 20 e Cvijiqit)”.²

Kanë kaluar tetë dekada dhe dija e europianizuar shqiptare, shkenca shqiptare dhe institucionet shqiptare kanë shënuar përmasat universale të nxënies së dijes dhe në mos asgjë tjetër, albanologjinë e kanë bërë shkencë nacionale.

² Shih, po aty.

Por filologjia shqiptare, ndryshe nga filologjia sllave, ende nuk ua ka kushtuar vëmendjen e duhur fqinjëve të tyre (në të gjitha përmasat e duhura: historike, kulturore, etno-psikologjike, gjuhësore etj.) dhe për më tej as në periudhën e parë (kur mundësitë e saj ishin të kufizuara) as në periudhën e dytë (kur i ka pothuajse të gjitha instrumentet bashkëkohore), nuk ua ka dhënë përgjigjen e duhur rezultateve të dijes së fqinjëve grekë e sllavë, për përmasën e kulturës materiale e shpirtërore të shqiptarëve.

Fqinjët tanë për shqiptarët kanë gjurmuar, mbledhur, sistemuar, studiuar e sintetizuar në dosje, në arkiva, në tryeza të fshehta e të hapura, në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, në vëllime popullarizuese, shkencore e ekstrashkencore, në vepra politike e diplomatike, në vepra sintetike e enciklopedike, një lëndë të pasur materiale e studimore albanologjike, siç na thotë edhe Jokli, për më se dy shekuj, ndërsa ne vetëm shekullin e fundit dhe në një përmasë më aktive, vetëm gjysmëshekullin e fundit, gjejmë reagime kryesisht individuale dhe madje individualiste për autorë a vepra të studiuesve sllavë. Fjalën e kemi për reagimet e Profesor Mark Krasniqit ndaj etnografëve serbë (kryesisht Cvijiqit), të Profesor Hasan Mekulit (kulturologëve të viteve '60–'70), të Profesor Rexhep Qosjes (kundër Dobrica Qosiqit dhe studiuesve të tjerë sllavë e maqedonas të viteve '80–'90), të Profesor Agim Vincës (kundër individëve e institucioneve kryesisht shkencore, arsimore dhe kulturore maqedonase e serbe), Profesor Qemal Muratit (kryesisht ndaj linguistëve maqedonas) etj.

Fqinjët tanë sllavë, luftërave tona, kryengritjeve tona antiserbe dhe antimaqedonase, protestave, demonstratave dhe reagimeve të tjera, ju kanë prirë me propagandë të koordinuar (të brendshme dhe të jashtme), me artikuj publicistikë, me tryeza

shkencore, me vepra në gjuhët nacionale dhe ndërkombëtare, ndërsa ne as dje nuk ju kemi prirë me analiza për fatin tonë në ato luftëra, as sot me analiza për fitoren e tyre.

Nuk mund të mos themi ndërkaq se sprovat e bëra (sado të rralla) kanë dhënë rezultate të rëndësishme: vëllimet me dokumente *Serbët dhe shqiptarët* (I–III) dhe vëllimi i kumtesave të studiuesve shqiptarë e atyre jugosllavë *Kosova – Serbia – Jugosllavia*, të gjitha të botuara në Lubjanë, si dhe vëllimi me kumtesa për *Gjendja e onomastikës shqiptare në momentin e tanishëm*, që në të vërtetë, sikur shihet edhe prej kumtesave, i tëri i kushtohet gjendjes së toponimisë shqiptare në Maqedoni, kanë treguar sa e rëndësishme është paraqitja dhe mbrojtja e përbashkët dje kur na mungonin institucionet apo kur institucionet ende nuk ishin në duart tona dhe sa të rëndësishme do të ishin vëllimet e tilla me dokumente, studime, analiza dhe sinteza të tjera sot, të shkruara dhe të botuara nga institucionet shkencore të Kosovës dhe natyrisht të Shqipërisë. Harkun kohor të këtyre kërkimeve e mbyll albanologu Qemal Murati, me kërkimin e parë modest të kësaj natyre, katër dekada me radhë në fushë të onomastikës. Studimet onomastike në këtë fushë ai i ka filluar me studimin *Toponimia e katundit Tuhinë–Kërçovë*, “Përparimi”, nr. 3, Prishtinë, 1971, f. 251–255. Për katër dekada me radhë, albanologu i kësaj ane i formuar në Prishtinë do t’i dalë zot kësaj hapësire me kërkimet në terren dhe me vlerësimet e saj, me krahasimet ndërgjuhësore, po edhe me vlerësimin e studimeve rreth saj.

Qemal Murati dhe arritjet albanologjike

Në botimet albanologjike ka më shumë se tri dekada që i lexojnë studimet dhe veprat e Qemal Muratit,³ me përqendrim të gjëra kërkimi të aspekteve linguistike shqiptare apo edhe me pretendime largvajtëse të ballkanologjisë. Leximi i veprës së tij, për të mos thënë arsyet e një leximi me paradigme paraprake dashamirësie, ndërlidhet jo vetëm me rezultatet e tij shkencore po edhe me një trashëgimi të varfër të kësaj fushe nga autorët shqiptarë. Në të vërtetë, ka disa dekada që marrëdhëniet historike–gjuhësore dhe madje etno–kulturore i lexojmë të hulumtuara e të sintetizuara nga autorë serbë, bullgarë, maqedonas e të tjerë, por rrallë e tek dhe vetëm përgjithësueshëm nga studiues shqiptarë.

Ndërmjet periudhës së ballkanologëve të shkollës austro–gjermane, që erdhi kryesisht deri në çerekun e parë të shekullit XX (Weigand, Malte – Brun, Jokli etj.) dhe shkollës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX (Çabej, Ajeti, Hoxha), ne kemi trashëguar një literaturë të shkollës ruso–bullgaro–serbe (Selishqev, Cvijiq, Urosheviq, Iljevski etj.), e cila nëse në marrëdhëniet serbo–shqiptare shquhet për ndonjë sintezë modeste (por gjithsesi skajshmërisht të politizuar), në

³ Qemal Murati (Tuhin, Kërçovë, 1955), është njëri prej studiuesve të shquar të gjysmës së dytë të shekullit XX, në fushë të marrëdhënieve shqiptaro–sllave, kulturës së gjuhës dhe në fushë të onomasatikës. Ndërsa, në fushë të onomasatikës ka botuar veprat *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, Fan Noli, Tiranë, 1993; *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e enrave të vendeve dhe të familjeve*, Tetovë, 1999; *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2008. Kontribute në fushë të onomasatikës Profesor Qemal Murati ka botuar edhe në vepra të tjera që trajtojnë problem në fushë të historisë së albanologjisë, leksikografisë, dialektologjisë etj.

marrëdhëniet maqedonase–shqiptare, përjashto arritjet e studiueses maqedonase Nasteva, deri te studimet e Qemal Muratit, në krahun e albanologëve, me pak përjashtime arritjet nuk thonë pothuajse asgjë.

Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni

Ky është titulli i njërës prej veprave të studiuesit Qemal Murati, botuar në Tiranë (1993), në një periudhë të rëndësishme dhe shumë aktive në Lëvizjen kombëtare të shqiptarëve në ish–Jugosllavi. Sikur është theksuar edhe në parathënien e saj kjo vepër “u bën sfidë prodhimeve a tezave kuazishkencore të shqiptarizimit të vonë të tokave sllavomaqedonase dhe të asimilimit të sllavëve të krishterë nga ana e shqiptarëve ardhacakë myslimanë në shek. XIX–XX, që kanë gatitur autorët sllavomaqedonas, duke vërtetuar në këtu të kundërtën e këtyre tezave – të sllavizmit të vonë të tokave shqiptare dhe të asimilimit të shqiptarëve nga elementi sllav, ngase ardhësit janë ata që kanë mundur të shtrihen në tokën e huaj shqiptare, e jo vendësit, rrënjësit”⁴.

Vëllimi ndahet në dy pjesë: *Toponomastika* dhe *Antroponomastika*. Pjesa e parë përbëhet nga katër studime “Autoktonia e shqiptarëve në dritën e onomastikës së sotme dhe historike”, “Emërtimet e vendbanimeve mesjetare shqiptare në truallin e Maqedonisë”, “Shënime toponomastike nga rrethina e Kërçovës” dhe “Shënime toponomastike nga tërthoret shqiptare të Maqedonisë”. Dy studimet e para hapën me nga një fjalë

⁴ Qemal Murati, *Dëshmi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, Shb “Fan Noli”, Tiranë, 1993.

hyrëse të karakterit orientues e polemizues njëkohësisht dhe vazhdojnë me korpuse të pasura gjurmimesh, krahasimesh e shpjegimesh të karakterit gjuhësor, historik, dialektor, krahasues dhe etimologjizues. Studimet, si të tilla, përfaqësojnë përgjigjen më të mirë dijes shkencore maqedonase mbi baza të mirëfillta shkencore, si dhe një hulumtim të përqendruar sa në shtrirjen horizontale po aq edhe vertikale në fushë të toponimisë. Dy studimet e tjera në vazhdim janë përgjithësisht një pasqyrë e pasur e mikrotoponimisë së Kërçovës, në rastin e parë, dhe mikrotoponimisë së Maqedonisë, në rastin e dytë.

Pjesa e dytë e vëllimit trajton tema nga fusha e *Antroponimisë*. Atë e përbëjnë dy studime: “Patronimikat shqiptare te sllavomaqedonasit” dhe “Enrrat vetjakë mesjetarë te shqiptarët e Maqedonisë në dritën e defterëve turke të shek. XV”. Që të dyja përfaqësojnë një hulumtim premtues për patroniminë shqiptare jo vetëm në Maqedoni, por edhe në pjesën tjetër të hapësirës shqiptare. Mbështetur në pasurinë antroponimike e patronimike të evidentuar në disa dokumente të mesjetës, autori ubifikon, diskuton dhe për rrjedhojë sjell një pamje shumë të pasur të patronimeve a trajtave të tyre shqiptare në patroniminë sllavo–maqedonase, duke filluar madje që nga etniku shqiptar e deri te patronimet me bazë etimologjike nga flora dhe fauna shqiptare.

Në një shikim më të gjerë studimet e pjesës së parë ashtu si edhe të pjesës së dytë paraqesin projekte të rëndësishme të studimeve me karakter të gjerë monografik, të cilave një ditë mund t’iu kthehet autori me qëllime më largvajtëse.

Çështje të onomastikës shqiptare në truallin gjeografik të Maqedonisë

Sikur mund të shihet prej teksteve të shumta brenda vëllimit *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes*⁵, studiuesi Qemal Murati jo njëherë u është kthyer korpuseve botuara në vëllimin “Dëshmi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni”, dhe jo njëherë në të njëjtin format a me të njëjtin qëllim. Kërkimet e tij të botuara në këtë vëllim përfaqësojnë tekste të thelluara shkencore për konferenca akademike, studime të përkushtuara për botime akademike dhe tekste të rastit për shtypin ditor me karakter kryesisht polemizues e mbështetur në një pasuri të madhe shembujsh të nxjerrë nga dokumentet e arkivave apo mbledhur në tërthoret shqiptare në Maqedoni. Duke vazhduar një traditë të kërkimeve të tij etimologjike kryesisht në fushë të leksikut dhe kryesisht në marrëdhëniet shqiptaro-sllave-maqedonase, në një nga kapitujt e parë i kthehet edhe njëherë historisë së prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, mbështetur gjithnjë në atë strukturë gjuhësore të toponimisë së antikitetit ilir të hapësirës shqiptare në Maqedoni. Studimet e këtij kapitulli shquhen për karakterin polemizues të tyre me studiuesit serbë dhe maqedonas. Në këtë rrjedhë ai polemizon me studiuesen maqedonase Lidija Slavenska, publicistin Kuzman Shapkarev, Filip Kavev etj. Prej kërkimeve dhe rezultateve të tij nuk është vështirë të konstatohet se e mbështetur në tezat më absurde joshkencore të A. M. Selishqevit, Jovan Trifunovskit, Njazi Limanovskit dhe të tajfës së shkencëtarëve të Akademisë Serbe të Shkencave të

⁵ Qemal Murati, *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes*, “Asdreni”, Shkup, 1994.

Beogradit, dija linguistike maqedonase gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, nuk ka bërë gjë veç se ka përplotësuar dijen gjuhësore–historike ruse e serbe të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, si dhe ka imituar dijen mitike të shkencës serbe të kohës.

Në këtë rrjedhë, autori ynë diskuton e polemizon kur me tekste të zgjeruara e kur me tekste kontekstuale për referencat e etnicitetit shqiptar në kontekstin negativ të shkencës onomastike sllavo–maqedonase dhe për oronimet e këtij vendi; për shtruarjen e prejardhjes së popullit shqiptar në Parlamentin e Maqedonisë dhe përjashtimin e disa prej referencave toponimike në fjalorin shtetëror; për emrat e qyteteve me burim shqip në Republikën e Maqedonisë (*Kërçovë, Strugë, Tetovë, Shkup, Resnje, Prespë* etj); për emrat e fshatrave të shumta me burim shqip në rrethinën e Dibrës (*Aleshencë, Dibër, Gari, Duf, Gizino, Grekaj, Gjinoec, Katun, Peresh, Tanushaj e Vau*); për gjurmët e vjetra të termit “llatin” në nomanklaturën gjeografike të Maqedonisë (*Latovë, Varret e llatinve, Selishte, Llatova e Vjetër, Kishavë, Kisha e Sheve, Vorret e Priftit, Vorret e Kërshtene* etj) për emrat vetjakë shqiptarë në truallin e Maqedonisë juglindore në dritën e regjistrave të Perandorisë Osmane të shekullit XV, për patroniminë shqiptare të dalë nga emrat etnikë (*Hrabino, Arna(v)ud, Arvanid, Arbainid, Arbino* etj), për antroponiminë shqiptare të Tuhunit, për regjistrimin e Kërçovës së shekullit XIX (*Ara e Bëcurit, Ara e Darijes, Ara e Bogilës, Arat e Gjumnës* etj), gjithnjë të parë në kontekstin e toponimisë dhe antroponimisë shqiptare; për kultet pagane dhe nomenklaturën gjeografike të Maqedonisë (*Kroj Mirë, Ujmirë. Dobravodë, Ujt e Shejt, Ujt e Mëkurrës, Ujt e Xhumasë, Ujt e Dillës* etj.), të para gjithnjë në kontekst

të toponimisë dhe antroponimisë, si dhe autoktonisë së shqiptarëve në këto tërthore etj.

Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave e të vendeve dhe të familjeve

Majat e kërkimeve të tij të viteve '90, në kolanën studimore dhe polemizuese të tij, Qemal Murati i shënon me veprën *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave e të vendeve dhe të familjeve*, madje edhe me një nëntitull të dytë *Kontribut për autoktoninë e shqiptarëve në raport me ardhësit sllavë*, me të cilin hapet edhe kapitulli i parë i këtij vëllimi.

Kjo vepër është edhe një përpjekje e studiuesit Murati, sa për të sjellë të dhëna të tjera aq edhe për të kurorëzues mendimin gjuhësor të dy shekujve të fundit mbi prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe. Ky konstatim para se gjithash i shkon kapitullit të parë, në të cilin në nëntema të veçanta shkruan mbi rëndësinë që kanë toponimet dhe patronimet në Ballkan; mbi tendencën e shkencës serbe dhe maqedonase që shqiptarët ortodoks t'i shpallë serbë të shqiptarizuar; mbi gjendjen e nomenklaturës shqiptare në gjeografinë ballkanike përballë politizimit të saj në shkencën serbe e maqedonase; mbi ndryshimin e toponimisë shqiptare nga institucionet sllavomaqedonase të përkrahura forcërisht edhe nga shkenca dhe publicistika maqedonase; mbi toponiminë dhe diletantizmin etj., e cila mbyllet edhe me një nëntemë njaft të diskutuar të kohës: diskutimin mbi emrin e Metohisë, të cilin autori ynë e quan emër tipik të periudhës bizantine josllave. Brenda këtij kapitulli Murati ka trajtuar ojkonimet dhe oronimet e antikitetit tashmë të pranuar në dijen e ballkanistikës e më gjerë: *Scupi*, *Skardus Mont*, *Naisus*, *Astibus* etj; gjithnjë duke u mbështetur në dijen paraprake të gjuhëtarëve më të

mëdhenj të shekullit XX: Eqrem Çabej, Petar Skok, Milan Budimir, Milan Shuflaiy, Norbert Jokli, Idriz Ajeti, Vaclav Cimohovski etj. Kjo është edhe arsyeja pse autori i kësaj vepre mban qëndrim mjaft të rreptë jo vetëm ndaj dijes shkencore të fqinjëve po edhe ndaj diletantizmit në fushë të albanologjisë. Në pjesën e dytë të këtij vëllimi studiuesi Qemal Murati merret me një temë sa të errët aq edhe të rëndësishme për studimet albanologjike dhe madje për çështjen shqiptare në Maqedoni. Fjala është për temën e madhe albanologjike *Emri antik i shqiptarëve të sotëm arbën/arbër* dhe diskutimet për mungesën e etnonimit *arbën/arbër*, në dokumentet e njohura ndërmjet shekullit II–XI, të cilat autori ynë jo vetëm i relativizon, por edhe i diskuton, disa prej tyre në përmasa albanologjike dhe ballkanologjike. Shembujt e tij Murati i gjen në shekullin III–IV te emrat vetjakë; te emërtesa *arbanas* në toponomastikën e tërthoreve gjeografike të Maqedonisë; te emri etnik në funksion antroponimi dhe patronimi në lakadredhat gjeografike të Maqedonisë; te emërtesa etnike shqiptare – një sintezë kjo shembullore e kohës; te disa qëmtime onomastike të burimit lashtor shqiptar, të cilat as nuk janë të pakta as të veçanta, por mjaft të shumta dhe shumëherë përgjithësuese e përfaqësuese në gjuhësinë shqiptare.

Fjalori toponimik i tërthoreve shqiptare në Maqedoni

Fjalori toponimik i tërthoreve shqiptare në Maqedoni nuk është njëra nga veprat më të mëdha të studiuesit Qemal Murati, e megjithatë mund të quhet njëra nga veprat më të veçanta të tij për disa arsye: e para, për shkak se është një nga të paktat e kësaj natyre që ndjek traditën e mbledhjes së thesarit të trashëgimisë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar në fushë të gjuhës a të folklorit; e dyta është një nga

veprat e kësaj natyre në zonën kontinentale të hapësirës shqiptare; e treta, është e vetnija e kësaj natyre për hapësirën shqiptare në Maqedoni; dhe e katërta, por jo e fundit, është një model për sinteza shkencore monografike në fushë të gjuhësisë, sado është evidentuar vetëm leksiku i përzgjedhur dhe jo i tëri, gjë që në përmasa të tjera historike nuk e dëshmon gjithë pasurinë leksikore të trojeve shqiptare në Maqedoni.

E megjithatë prej përbërjes gjuhësore, historike, semantike, strukturës gramatikore e fonetike, të leksikut toponimik të këtyre tërthoreve shqiptare në Maqedoni mund të nxjerrim disa veçori gjuhësore e historike të tij, siç janë: toponimia e kësaj ane dëshmon gjithë pasurinë gjuhësore, materiale e shpirtërore të popullit shqiptar; toponimia shqiptare e kësaj ane duke u shpjeguar gjuhësisht vetëm me rregullat fonetike dhe gramatikore të shqipes, njëkohësisht dëshmon edhe për periudhat e hershme historike të jetës së shqiptarëve në këto troje, duke filluar me emrat e antikitetit *Scupi*, *Astibos*, *Skardus Mons* etj., ojkonime e oronime këto të cilat nuk gjenden këtu edhe në trajtat gjuhësore sllave; toponimet shqipe të mesjetës gjëlljnë krahas toponimisë mesjetare të popujve të tjerë, me çka dëshmohet bashkëjetesa e tyre në një periudhë mjaft të errët dhe të ngarkuar me elemente të karakterit jo vetëm gjuhësor, po edhe historik, etnografik, etnopsikologjik dhe religjioz; toponimia e mesjetës së vonë, ndonëse e ngarkuar si edhe toponimia e popujve të tjerë, me elemente të proviniençës orientale, në strukturën e saj boshtore ka ruajtur gjithë pasurinë e saj gramatikore nacionale; toponimia e kohës më të re, pavarësisht ndikimeve dhe huazimeve nga gjuhët fqinje, ka ruajtur karakterin gramatikor nacional të fjalëformimit të saj; toponimia shqiptare në rrethana të caktuara ka marrë nga leksiku i fqinjëve me të cilët ka

bashkëjetuar, por dhe ka dhënë pothuajse në të gjitha periudhat historike të saj etj.

Prej *Fjalorit toponimik* të kësaj vepreje nuk është vështirë të dëshmohet se pasuria onomastike e shqiptarëve në Maqedoni shtrihet në të gjitha nënsistemet e saj: antroponimi (antroponimi, patronimi e ojkonimi); toponimi (ojkonimi, oronimi, hidronimi, fitonimi, zoonimi etj.)

Duke qenë e tillë, toponimia e këtij vëllimi dëshmon edhe njëherë se ato nuk janë as vetëm të kohës së re, sikur pretendon shkencomania maqedonase, as e rastësishme dhe as vetëm e periudhave të caktuara historike dhe madje stinore, sikur pretendon shkenca serbe. Përkundrazi, sythi i fundit i kësaj vepreje me titull “Albanizmat në nomenklaturën e onomastikës maqedonase” e dëshmon pikërisht të kundërtën e pretendimeve të tyre. Kjo pasuri gjuhësore e shqipes, e skajuar në onomastikonin maqedonas të një periudhe historike mjaft të gjatë, e cila sigurisht një ditë do të jetë strumbullar i një monografie të hapur të Qemal Muratit në fushë të ballkanistikës, dëshmon se shqipja edhe në fushë të onomastikës jo vetëm ka marrë po edhe ka dhënë gjallërisht.

Albanologjia dhe albanofobia maqedonase

Në radhorët e studimeve albanologjike, teksti i Qemal Muratit *Enciklopedia maqedonase – një botim i mbushur me frymë thellësisht joshkencore* është një shembull i mirë jo vetëm për diskutimin e njësive albanofobike në *Enciklopedinë e Maqedonisë* nga pozita e referimeve të zërave të saj, por edhe të shumë teksteve të kësaj natyre. Në të vërtetë, fjala është për një sintezë të leximit të saj metodologjikisht kritike dhe hulumtuese njëkohësisht. Teksti hapet me një hyrjeje për veprën si ide dhe si projekt me porosi paraprakisht politike

dhe vetëm pastaj shkencore e kulturore, i cili përmbillet me konstatimin se si e tillë nuk i bën nderë as vetë maqedonasve. Prandaj, autorët e saj dhe sidomos Akademia maqedonase u detyruan ta largojnë nga shpërndarja, pasi që në fillim pati reagime nga institucione shqiptare e të huaja⁶. Mjafton të shihet vlerësimi, diskutimi kritik dhe sintetik, që i ka bërë zërit *Shqiptarët në Maqedoni*, për të parë dy anë të kontekstit: për zërin enciklopedik për shqiptarët në Maqedoni akademikët maqedonas, që në fillim kanë dhënë edhe këto të pavërteta: “*Shqiptarët në Maqedoni – bashkësia më e madhe etnike, pjesë e popullit shqiptar që i banon viset perëndimore të Gadishullit ballkanik. Te popujt e tjerë të Ballkanit njihen dhe si Arbanasi, Arnauti ose Šiptari (Planinci). Për nga religjioni, kryesisht janë të konfesionit mysliman. Selitja (ardhja) e tyre në Maqedoni vihet re kryesisht pas shek. XVI, pasi ishin islamizuar. Imigrimi i tyre ka pasur intensitet më të madh në gjysmën e dytë të shek. XVIII, kur feudalët shqiptarë vepronin për mëvetësinë nga pushteti qendror dhe zgjerimin e sundimit të tyre në Maqedoni. Ali Pasha Janina (nga fundi i shek. XVIII) e zgjeroi pushtetin e tij edhe në viset jugperëndimore të Maqedonisë, me çka në fakt filloi dhe imigrimi i shqiptarëve. Atëherë imigruan nga një ose më shumë familje në rreth 30 fshatra. Të gjitha ato erdhën nga Shqipëria Veriore dhe i takonin fisit Gegë. Në Tetovë, Gostivar dhe në vende të tjera erdhën pashallarë gjysmë të*

⁶ Si kundërpërgjigje ndaj “*Enciklopedisë maqedonase*”, dolën dhe dy botime në gjuhën shqipe: “*Maqedonia Shqiptare*” (2009), nga bashkautorët Nijazi Muhamedi dhe Bardhyl Zaimi, dhe një botim tjetër “*Çmenduria e Akademisë – Enciklopedia – Reagime, përmbledhje shkrimesh*” (2009), edicion i gazetës “Koha”, me reagime njaft emocionale nga autorë të ndryshëm. Nga qarqet akademike një reagim të fortë “*Enciklopedisë maqedonase*” i ka bërë historiani i njohur nga Tirana Kristo Frashëri.

pavarur me prejardhje shqiptare, që i nxitën imigrimet. U përdorën bandat kaçake të cilat e terrorizuan popullsinë maqedonase dhe e detyruan të shpërngulet. Në shtëpitë dhe fshatrat maqedonase u vendosën familje shqiptare. Numri i tyre deri në fillim të shek. XIX arrinte rreth 20. 000 frymë (banorë)". Autori ynë vazhdon më tej me të dhëna për të ashtuquajturat katër periudha të emigrimeve shqiptare nga Shqipëria kryesisht Veriore dhe përgjigjet mbi baza metodologjike e parimore, një model që mund të aplikohet edhe me zëra të tjerë të kësaj *Enciklopedie*, duke ua kujtuar autorëve të saj se më parë sesa të merreshin me emigrimin e shqiptarëve në Maqedoni do të duhej të merreshin me shpërnguljen e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi; se më parë sesa të merreshin me prezantimin e numrit të rrejshëm të shqiptarëve në periudha historike, për të cilat më së paku kanë të dhëna akademikët maqedonas, do të duhej të merreshin me prezantimin e numrit të saktë të shqiptarëve të sotëm në ish-Jugosllavi. Studiuesi Qemal Murati merret gjerësisht edhe me referencat që autori i tekstit Stojan Kiselinovski ka përdorur për shqiptarët. Në këtë studim nuk është vështirë të kuptohet se si qëllimi e mund arsyen në mënyrën më të ultë. Vendin e studiuesve, linguistëve më të mirë të shkollës europiane dhe të gjuhëtarëve që e kanë shënuar majat e studimeve albanologjike: Franc Bopp, Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokl, Franjo Mikloshiç, Vaclav Cimohovski, Radoslav Katiçiç, Eric Hamp, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti etj., e zënë shkencëtarë maqedonas, bullgarë dhe madje renegatë shqiptarë si Vasil Kënçov, Kapllan Buroviç, Jovan Trifunoski, Stojan Kiselinovski, Vasil K. Hnčov, Dr Miloš Konstatinov etj. Një vend të veçantë dhe gjerësisht të shtruar me dokumente e dëshmi të tjera të vjela nga ato, po edhe të komentuara me

kujdes, autori ua kushton toponimeve dhe mikrotoponimeve e ojkonimeve me paradigmë etnoniminë e mesjetës, madje edhe trajtave sllave, si dhe patronimeve me bazë leksikore të shqipes mesjetare; simbiozës sllavo-shqiptare dhe koncepteve të Profesor Çabejt rreth kësaj teme; etnonimit maqedonas në traditën shkencore shqiptare të shekullit XVIII dhe të fillimit të shekullit XIX etj. Duke ju referuar etnografëve e albano-logëve nga radhët e arbëreshëve, Nikollë Keta, Gjergj Guxeta, Engjëll Mashii, autori kujton se ata patën vënë re se termi *maqedonas* është përdorur në kuptimin “shqiptar i hershëm”, domethënë për të treguar popullsitë vendëse jo greke të Gadishullit Ballkanik.

Në studimin e tij Qemal Murati trajton edhe etnonimin maqedonas, përkatësisht trajtat e sotme të tij (kryesisht të shekullit XX), si: *makedonski sloveni* (*maqedonasit sllavë*), *maqedonas sllavë* apo *sllavomaqedonas*, *maqedonas antikë* e *herë si sllavë*, “*grekë të sllavizuar*”, përkatësisht “*bullgarë të maqedonizuar*”, “*krijim artificial*” i krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore”, etj, të diskutuara nga studiues vendorë, ballkanikë dhe të huaj, për të konstatuar se *maqedonasit e sotëm*, *si popull dhe si gjuhë, janë vazhdues të sllavëve*, sjellë e mbjellë prej dyndjeve të tyre në Ballkan (shek VI–VII pas krishtit), dhe çdo përpjekje për të dëshmuar ndonjë traditë historike këtu, madje para shqiptarëve, nuk është gjë tjetër veç se dhunim qesharak i historisë, sikur shprehej dikur historiani Kiril Ivanov.

Kërkime në onomastikën e gjeografisë anësore të shqipes

Në studimet albanologjike të toponimisë së Maqedonisë, vend të rëndësishëm zë edhe libri i Mustafa Ibrahimit, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe*

*Velesit*⁷. Kjo vepër është vazhdim i suksesshëm i kërkimeve gjuhësore edhe për një arsye fundamentale. Kjo është hapësira etno–gjuhësore dhe etno–historike, ku përkimet shqiptaro – sllave kanë marrë karakter edhe politik. Studimet e kësaj natyre njeshtri ynë i pati filluar me studimet historiko–gjuhësore dhe etimologjike e dialektore të cilat i ka përmbledhur brenda një vëllimi me studime albanologjike⁸, brenda të cilit ka trajtuar çështje të toponimisë së trevës së Pellagonisë, etnonimin mesjetar Arbanas dhe një varg patronimesh e toponimesh të Maqedonisë. Brenda këtyre studimeve janë trajtuar edhe veçori të etimologjisë shqipe të disa oronimeve e ojkonimeve, si *Pellagon*, *Prilep*, *Desovë*, *Pitu Guli*, po edhe etnonimin arber/alban etj.

Vëllimit i prinë një hyrje sintetike në të cilën autori sjell disa nga arsyet pse kërkimet në fushë të onomastikës janë të rëndësishme jo vetëm për gjuhësinë dhe brenda saj onomastikën, por edhe për disa nga përbërësit e tjerë historik dhe etnik të popullit që e përdor dhe e ruan këtë pasuri gjithëkombëtare. “Vendbanimet shqiptare të këtij rrethi, shkruan autori, janë shumë të pasur me mikrotoponime, sepse duke u gjendur në një hapësirë të izoluar nga folësit e tjerë shqiptarë në Maqedoni, kanë ruajtur shumë fjalë të rralla dhe mikrotoponime, të cilat shumë rrallë ose aspak nuk hasen në të folmet tjera shqipe”. Prej parathënies së tij nuk është vështirë të shihet përkushtimi afatgjatë i autorit në mbledhjen e materialit në teren, në studimin dhe sisteminimin e tij duke u nisur nga kërkesat shkencore dhe specializuese (fillimisht në interes të kërkimeve

⁷ Mustafa Ibrahim, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, botoi *Interlingua*, ISBN 978–9989–173–31–8, Shkup, 2010, f. 245.

⁸ Shih, *Interpretime dhe studime gjuhësore*, Shkup, 2003, f. 63–93.

dialektologjike e leksikografike), për t'i sistemuar më në fund në një vëllim prej katër kapitujsh, për specialistët e onomastikës dhe pse jo të historisë së gjuhës.

Kapitulli i parë është përfshirë përshkrimi i vendbanimeve me popullsi shqiptare dhe mikrotponimia sipas fshatrave; kapitulli i dytë, që në të vërtetë është boshti i gjithë vëllimit, specifikon ndarjen leksiko–semantike të mikrotponimeve; kapitulli i tretë sintetizon mikrotponimet nga pikëpamja strukturore – gramatikore; si dhe kapitulli i katërt, në të cilin janë paraqitur analizat gjuhësore të mikrotponimeve. Vëllimi mbyllet me të dhëna orientuese, teknike, përmbledhëse dhe sintetike, sikur janë: sqarimet për përdorimin e fjalorit, transkriptimi fonologjik, shkurtesat, burimet bazë, por edhe fjalori mikrotponimik, përfundimi, bibliografia, literatura etj.

Kapitulli i parë pasqyron disa nga përbërësit historik, etnogeografik e demografik të komunës së Prilepit, e cila shtrihet në pjesën veriore të Pellagonisë (brenda të cilës gjenden fshatrat: *Cërnilishtë, Desovë, Gostirazh, Debresht, Llazhan, Peshtalevë dhe Zhitoshë*); të komunës së *Dollnenit*, e cila shtrihet në veri të Pellagonisë dhe përfshinë fshatrat shqiptare: *Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan dhe Debreshtë*; të komunës së *Krushevës*, e cila shtrihet në pjesën juglindore të Pellagonisë (e cila administrativisht mbulon fshatrat: *Presill, Alldançe, Borinë, Sazhdevë, Jakrenovë, Bellushinë dhe Nerovë*), si dhe zona e *Velesit* (me dy fshatrat e banuara me shqitarë: *Jabollçishtë e Sogle*). Kjo ndërkaq në asnjë mënyrë nuk përjashton fshatrat tjera të banuara tash me popullsi të deklaruara etnikisht maqedonase, por që po të hulumtohet më thellë, mbështetur madje pikërisht në fushë të toponimisë, folklorit e etnografisë, nuk është vështirë të shihen gjurmë të rëndësishme të karakterit historik të etnisë shqiptare edhe në

këto anë. Kjo është arsyeja pse jo vetëm brenda fshatrave me popullsi të plotë shqiptare, por edhe në fshatrat ku mbijetojnë arketipe gjuhësore, folklorike dhe madje etnologjike, ende mund të gjenden shenja të ekzistencës së popullsisë shqiptare, tashmë të sllavizuar, falë njësive mikrotoponimike, të cilat përtej njësive gjuhësore paraqesin njësi etnokulturore, materiale dhe shpirtërore dhe etnike të shqiptarëve, banorë shekullor të këtyre vendbanimeve. Shembulli më i mirë i kësaj njësie është identifikuar etnonimi Arbanas, i cili dëshmohet qënë vitin 1336 në rrethin e Prilepit, 1336. Dje jo vetëm kaq. Në dokumente mesjetare turke, sllave e të proveniencës perëndimore nuk është vështirë të gjenden topikët: Arbanas, Arbanash dhe Arnaut (Prilep), *Arbanasi* oronim (Prilep), *Arbanasi* (Dupjaçan), *Arbanasi* (Nebregovë, Prilepit), Latinska Crkva, *Arnaut Xhamia* (Prilep), *Arnautska Maalla* (Konjari), *Arnaut Mahalla* (Prilep), *Arnautska Zemja* (Prilepit) etj.

Për të gjitha fshatrat dhe komunat autori ka dhënë paraqitje të detajuara të pozitës gjeografike, kufijve të tyre, strukturës etnike të popullsisë, fiseve kryesore, ojkonimeve, etimologjisë së emrit dhe etnikut, informatorëve dhe në fund mikrotoponimeve. Janë me shumë interes shpjegimet popullore për fiset. Duke mos qënë fise në kuptimin e banorëve të një krahine në Kosovën dhe Shqipërinë Veriore, por grupe të vogla familjare në nivel të barqeve, ato sjellin informacione shumë interesante për prejardhjen për gjenealogjinë e tyre dhe sidomos hipokoristikët patronimikë të tyre, të cilat vetëm pjesërisht mund të gjenden në hapësirën tjetër të onomastikës shqiptare. Është me shumë interes të shihet në këtë fjalës të patronimisë shqiptare deri ku ka shkuar ndikimi sllav në strukturën leksikore, semantike dhe gramatikore të shqipes, dhe në

ç'përmasë ka arritur të ballafaqohet e t'i qëndrojë këtij ndikimi një pjesë e saj.

Në këtë rrjedhë, autori ynë është përpjekur që të sjellë disa të dhëna dhe disa përfundime të tij apo të të tjerëve për etimologjinë e të gjitha vendbanimeve dhe të etnikëve të popullatës së tyre, ndërsa për prejardhjen gjuhësore të fiseve ka dhënë vetëm disa nga shpjegimet e rastit, sado me interes jo vetëm për lexuesit e rastit, por edhe për specialistët e onomastikës. Tek ojkonimi Černilishta autori përkrahë konceptin e studiueses Olga Ivanova, duke e gjetur etimologjinë tek fjala Černil(o): cen “niger” – i zi dhe prapashtesa –ishte (19); etimologjinë e ojkonimit Desovë e kërkon tek një traditë e vazhdimësisë ilire të emërimit të vendbanimit mbi baza patronimike me bazën Des+suf. –ovo (*Desimir*, *Desislav*, *Despot*), si edhe Perast (<Pirusti), Dukla (<Dukleati) etj; etimologjinë e fshatit Gostirash e konsideron të errët, për shkak të lëvizjeve të mëdha në identifikimin e tij në literaturën dokumentare; ndërsa te ojkonimi Debresh, gjen patronimin e vjetër personal Debres; emrin e fshatit Zhitosh e konsideron të zgjidhur nga Petar Skok, nga shqipja Grun+suf. – ishte; te ojkonimi Jakrenovë gjen emrin patronimik Jak, i pranishëm gjerësisht tek shqiptarët; tek ojkonimi Borinë dhe trajta e tij në dokumentet turke Brina, autori ynë vjen në përfundim se fjala është për emrin vetjak shqiptar Biran; ndërsa etnonimin e ojkonimit Nerovë, i pranishëm gjerësisht në hapësirën gjuhësore shqiptare e gjen te baza leksikore e shqipes “njeri” etj.

Pra, janë të pakta etimologjitë e fshatrave që për një arsye apo një tjetre nuk i diskuton dhe nuk nxjerr përfundime të caktuara, duke përfshirë këtu edhe diskutimet e studiuesve dhe literaturën dokumentare. Pavarësisht prej nivelit të diskutimit, e diskutimet në fushë të etimologjisë gjithmonë

lënë vend për dyshim dhe diskutim, kërkimet në teren dhe në literaturë janë me interes të shumanshëm, prandaj edhe përfundimet e tij me interes të përgjithshëm.

Le të theksojmë vetëm disa nga ato fise më të vjetra dhe sikur shkruan autori me më shumë shtëpi: *Balevsi* (<hip.*Bajram*), *Cankovsi* (<hip.*Asan*), *Gjolekovsi* (të ardhur nga *Dardha*, vend në *Shqipëri*) (<hip.*Gjon + Lekë*), *Guxhovsi* (<nga *nofkë*), *Latevsi* (<hip. *Iljaz*), *Shitevsi* (<hip. *Rushit*), *Usevsi* (<hip.*Usein*), *Xhepevsi* (<hip.*Rexhep*) etj. (*Cërnilishtë*); *Buzliovci*, dhe *Sharetët* (*Gostirash*), fshati, në të cilin, sipas dokumenteve turke të shek. XVI, njeriu i parë që është regjistruar është: *Gjon Arnaut*; *Manenvci* (*Peshtalevë*); *Arapoxhovce* (*Debresh*); *Deshatovci* (*Zhitoshë*); *Pulevci* (*Borinë*), *Kolaj*, *Mixhaj* (*Alldange*); *Pelli*, *Llupi*, *Rroshit*, *Shellgët* (*Jabollqishtë*) etj.

Brenda kapitullit të dytë janë me shumë interes mikrotoponimet e secilit fshatit veç e veç, si dhe të sistemuara sipas gjendjes gjeografike, materiale, kulturore, fizike etj.: *Arat* (*Ara e Toskës*, *Bilkameni*, *Lethja*, *Ligata*); *Malet*: *Gropa e Shitit*, *Çuka*; *Kodrat*: *Kodra e Topit*, *Mullari*, *Tumba e Bashinecit*, *Vllahu*; *Krojet*: *Tinjët*, *Ujti i Xhumas*, *Ujti i Barth*; *Kullosat*; *Mullijt*; *Livadhët*: *Livadhi i Sulit*; *Lumenjtë*: *Ke Ezeroja*, *Vija*; *Përronjtë*: *Pr«j i Fellë*, *Proj i Balit*; *Mullinjtë*: *Mulleini i Bakjut*, *Mullini i Parë*, *Mullini i Dytë*, *Mullini i Tretë*, *Mullini i Katërt*, *Mullini i Amzës*; *Udhët*: *Udha e Gurishtës*, *Udha e Kuqe*, *Udha e Lethis*, *Udha e Qiraxhive*, *Udha e Vra Muratit*; *Gurët*: *Bishti i Gurve*, *Guri i Merizit*, *Guri i Ram*, *Guri i Sulit Dulit*, *Guri me Qallm*, *Guri me Tavan*, *Peshterja e Kaçakve*; *Korijat*: *Koria e Likës*, *Koria e Xha Mejdit*; *Drunjtë*: *Ke Dardha Mace*, *Ke Fayri*, *Ke Lisi i Bogomellës*, *Ke Lisi i Shitit*, *Ke Lisi i Shyptarit*, *Ke Mollët e Koshit*; *Varret*: *Vorret e Kerive*, *Vorret e Katenit*, *Vorret e Xhyppqive*; *Vende*: *Ke*

Arkaçët, Ke Bryna e Milanit, Ke Shkolia, Ke Ujti i Dollës, Ke Ujti i Qelbët, Ke Vllahu, Manastirishçe etj. Pa dashur të hy në këtë rrjedhë shumë të ndërlikuar diskutimi, sepse kjo do t'i jepte përmasë tjetër paraqitjes sonë, dua të theksoj qoftë edhe një fakt: ndikimin sllav në patroniminë islame, praninë bizantine të disa ojkonime dhe madje te disa emra fisesh, si dhe elemente të rëndësishme të proviniençës romane dhe katolike në disa forma dhe trajta patronimike e mikrotoponimike.

Kapitulli i dytë me titulli *Ndarja leksiko-semantike të mikrotoponimeve* paraqet boshtin e veprës *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. Makrostrukturën e tij e përbëjnë temat e përgjithshme, si: toponimia primare, me nëntemat mikrotoponime të krijuara nga emra oronime, hidronime (*Udha Batakut, Çeshmja e Bugarve, Çeshmja e Shkozës, Çeshmja e Teferiçit, Çeshmja e Xhamis, Ke Gura Vogël, Kallxherica, Kllajneci i Krylljut, Kroj ke Rrasat, Ke Ligeni, Proj i Muzgave, Prroj i Qafës, Prroj i Urës Gurt, Prroj i Manastirishtes, Ke Sulishtet, Ke Ujti i Qelbët, Ujti i Barth i Math, Ujti i Tharët, Zalli i Arës se Vjetër, Ke Bunari i Alilit* etj); bota bimore (fitonime) si: *Ahishtat, Përroi i Blinave, Bubishta, Dardhët e Shullonit, Dushku Kaurve, Ke Ithnat, Kinxhlët, Te Kumblla Mbuth, Lisi i Shyptarit, Mollët e Tharët, Qafë Thanës, Vneshtet e Vjetra, Gurt e Shkopive*; bota shtazore (fauna), si: *Voret e Kualve, Dardha Mace, Gjurma Mushkës, Mali ke Brimat e Dhelpnës, Guri i Ukut g Bell, Ara e Bxhetës, Gurst' e Gjarpnive, Bishti i Gurve, Gjurma Maushkës* etj; mineralogjia (tokë, minerale, xehe), blegtori, bujqësi, pylltaria, manifaktura, komunikacioni, objektet kulturore, raportet sociale, si dhe strukturat gramatikore e tyre: mbiemra në përbërje të mikrotoponimeve që përcaktojnë, numërorë, folje, paraqalë, toponime sekondare (*Vorret e*

Alldançes, Guri i Bogomellës, Lisi i Bogomellës, Udha e Bellushinës, Mali i Bellushenës, Udha për n'Berat, Korja e Buçinut, Qafa e Dollgovcit, Kullosa e Grazhdanit, Shullani i Jakrenovës, Ke Ura e Kostinces, Slloqet me te Koshines, Gropat e Kurshovës, Dushku i Zhitoshes, Tumba e Bashinecit, Mali i Gabrovnikut, Prroj i Ftosinës, Ke Signalli i Kirividit etj.), baza apelative të mikrotoponimeve etj. Në qoftë se pjesa e parë, struktura leksikore, tematike dhe paradigmatic e mikrotoponimeve paraqet pasurinë materiale dhe shpirtërore të kësaj ane, kryesisht mikrotoponime të mbështetura në gjendjen fizike të hapësirës gjeografike dhe botën bimore e shtazore të kësaj ane, në pjesën e dytë janë trajtuar strukturat gramatikore të kësaj pasurie gjuhësore, madje jo vetëm të shqipes. Pra, në qoftë se në pjesën e parë janë trajtuar oronimet, hidronimet, fitonimet, zoonimet etj., si: *Bjeshka e Epër, Bjeshka e Poshtër, Brexhet e Kuq, Bryna Ukut, Qafa e Gradishtes, Zadgradishte, Grona e Fkell, Gropa e Kalushit, Ke Gropët, Guri i Aneve, Guri i Askerit, Guri i Keq, Guri i Kuq, Guri i Math, Guri i Mullinit, Guri i Nishanit, Guri i Shpum, Guri i Shpunun, Guri i Verth, Guri i Zi, Guri Jeshil, Guri Kalas, Guri me Gjurm, Guri me Tavan, Guri Plak, Gurst' e Gjarpnive, Karpat e Sharetit, Kodra e Dushkut, Kodra e Topit, Kodra e Vneshtve, Lisi i Moth ke Kodra, Peshterja e Kaçakve, Peshterja e Kuqe, Peshterja e Plakut, Qafa Sherit, Qafa Thanës, Ara ke Rrasat, Ka Shkall, Udha në Skall, Shpella a Des, Shpella e Kalushit, Shullan i Korijave etj.*, në pjesën e dytë është diskutuar gjithë pasuria gjuhësore e tyre gramatikore: numërorë, folje, parafralë etj.

Një fund është sjell edhe një nënkapitull mbi mikrotoponiminë sekondare, i cili përfshinë njësitë mikrotoponimike nga emra vendbanimesh, mikrotoponimet nga emra toponimesh,

si dhe apelativat e mikrotoponimeve. Fjala është për një nga gjurmimet shumë interesante të toponimisë sonë, e cila është diskutuar që nga Norbert Jokli, sidomos në lidhje me ndikimet dhe praninë e elementit sllav në toponiminë dhe përgjithësisht leksikun e shqipes. Në të vërtetë, përtej aspektit ndikues dhe pranisë së elementit sllav në toponiminë e hapësirës shqiptare dhe përgjithësisht leksikun e shqipes, në këtë rast është polemizuar fuqishëm për praninë e elementit etnik sllav në Shqipëri, përkatësisht hapësirën etnike dhe etnografike shqiptare. Pikërisht te prania, respektivisht ruajtja e trajtave të vjetra dhe arkaike të shqipes në disa mikrotoponime të atij vendi apo të asaj krahine etnografike i kanë bërë të mendojnë studiuesit në etninë shqiptare të asaj zone, që për shkaqe të caktuara historike është ndryshuar gjatë shekujve, dhe ka marrë trajtën sllave (serbe, bullgare apo maqedonase), greke apo latine–italane. Studiuesi ynë Mustafa Ibrahim, ka radhitur një numër shembujsh, si: *Vorret e Alldançes, Guri i Bogomellës, Lisi i Bogomellës, Udha e Bellushinës, Mali i Bellushenës, Udha për n’Berat, Korja e Buçinit, Qafa e Dollgovecit, Kullosa e Grazhdanit, Shullani i Jakrenovës, Ke Ura e Kostinces, Sllloq me te Koshines, Gropat e Kurshovës, Dushku i Zhitoshes, Tumba e Bashinecit, Mali i Gabrovnikut, Prroj i Ftosinës, Ke Signalli i Kirividit* etj, të cilat më parë se sa strukturën gjuhësore arkaike të vendbanimeve të kësaj zone, dëshmojnë për ndërlidhjen historike të tyre dhe të banorëve të tyre.

Në jetën materiale të banorëve të kësaj zone bujqësia dhe blegtoria historikisht ka paraqitur një pasuri të rëndësishme, prandaj është e kuptueshme pse trajtat e tyre kuptimore dhe gjuhësore autori ia ka sistemuar në një plan më të gjerë. Në këtë rrjedhë studiuesi Ibrahim mikrotponiminë me bazë jetën

blegtorale e ka parë duke u mbështetur në përbërësin e saj të sipërfaqeve blegtoriale, në objekte blegtoriale, në ushqim për kafshët, në bagëtinë dhe kafshët e tjera shtëpiake, në pajisjen dhe objektet blegtoriale, prodhimet blegtoriale, sëmundjet dhe paraqitjet e tjera lidhur me bagëtinë etj., si: *Livadhet e Thata, Livadhet t'Reja, Livadhet t'Vjetra, Ledinka e Rrasave, Kullosat e Nezes, Kullosat ke Voret e Vjetra, Ke Mullarët, Shterpat e Epërme etj.*, ndërsa mikrotoponiminë e lidhur me jetën bujqësore, e ka sintetizuar brenda temave: sipërfaqet bujqësore, objekte bujqësore etj, emrat që lidhen me objekte bujqësore, prodhime dhe kultura të ndryshme bujqësore, puna në objekte dhe me mjete bujqësore (*Ara ke Rrasat, Arët e Bales, Fusha e Lopve, Fousha e Gjan, Ke Kopshtinjët, Korcat e Trashat etj.*). Nuk e di a është e rëndësishme të thuhet se pikërisht mikrotoponimia e ngulitur e kësaj sfere të hershme dhe të përhershme, si: *Guri i Mullinit, Katër Mullit, Mullini i Amdit Nurës, Mullini i Kamer Taukes, Udha e Borinës, Udha e Ftojave, Udha e Gurishtës, Udha ke Lisi i Madh, Oudha e Progonit, Udha Kalas, Udha Kaurrit, Udha Manastirishtes, Ura e Lugës etj.*, dëshmon për jetën sedentare dhe autoktone të kësaj popullate.

Brenda këtij kapitulli dhe madje brenda këtij vëllimi etnonimet paraqesin një temë dhe një pasuri më vete. E gjithë pasuria etnonimike është parë në dritën e strukturës përmbytësore dhe gjuhësore të patronimeve familjare, nofkave dhe hipokoristikëve, emrave personalë (emra njerëzish), emrave mashkullor mysliman, emrave femëror mysliman, emrave mashkullor të krishterë, emrave femëror të krishterë, emrave familjar etj. Në këtë rrjedhë mund të thuhet se shumë prej etnonimeve dhe patronimeve e antroponimeve të prejardhjes myslimane apo të krishterë kanë karakter edhe historik (të identifikue-

shëm gjerësisht edhe në dokumente të hershme: defterë e krisobula), prandaj prania e tyre në këtë vëllim shpreh edhe njëherë pasurinë tonë materiale e shpirtërore të shprehur edhe përmes emrave familjar. I këtij krahu historik janë edhe mikrotoponimet e klasifikuara në grupin e traditës kulturore. Shembujt e kësaj natyre nuk janë të paktë. Ata dëshmojnë për pamjen gjeografike të terrenit, prejardhjen historike, etnike, kulturore, fetare e gjuhësore të popullatës së saj (*Te Kumblla M'buth, Katunishta, Kodra Katunit, Udha e Mallës Poshtë, Lama e Xha Musajt, Ke Shpja e Barth, Vendi në Mes Katunit, Ke Xhenemi i Grave, Kish e Vjetër, Kisha Madhe, Vllashka Cërkva, Ke Manastirishtja, Udha e Voreve, Voret e Katundit, Voret e Shqiptarve, Kallxherica*) etj.

Prej mikrotoponimisë së pasur dhe të vendosur këtu në mënyrë sintetike nuk është vështirë të shihet aspekti fundamental i saj: homogjeniteti gjithkombëtar i saj. Ata që kanë lexuar toponiminë e Shqipërisë së sotme, Kosovës, Malit të Zi, Çamërisë dhe madje të arbëreshëve të Italisë nuk e kanë vështirë të shohin edhe këtu shtratin historik e etnik të saj, nënshtresën mesjetare dhe antike (ilire) shqiptare, si dhe elementet mbi-shtrese të gjuhëve ballkanike (greke, bullgare e serbe), orientale (turke) e aksidentale (latine) në strukturën gjuhësore e semantike të saj. Është pothuajse e pamundur të lexosh korpusin onomastik të cilës do prej krahinave etnografike historike apo të sotme shqiptare dhe të mos gjejsh struktura gjuhësore (leksikore, morfologjike dhe madje sintaksore e frazeologjike) dhe semantike të onomastikës së vendbanimeve të Pollogut. Struktura të tilla që në vetvete paraqesin njësi etnokulturore dhe gjuhësore gjithëkombëtare paraqesin afërsi kontekstesh historike, gjeografike, fizike etj., në një mënyrë apo një tjetër mund të gjenden edhe në hapësirën tjetër shqiptare, në

trajtën: *Ara e Toskës/Ara e Gegës, Lethia/Lejthishta, Ligata/Ligatina: Gropa e Shitit/Gropa Çikes, Çuka/ Suka, Kodra e Topit/Kodra e Topave, Mullari/ Mullari, Tumba e Bashinecit/Tuma, Vllahu/Te Vllahu; Ujti i Barth/Ujt e Zi; Livadhi i Sulit/Livadhi Gjakut; Vija/Jazi; Prej i Fellë/Prroni Thellë, Mullini i Parë/I Pari Prru, Mullini i Dytë/I Dyti Prru, Mullini i Tretë/ i Treti Prru, Udha e Kuqe/ Udha e Zezë, Udha e Lethis/Udha e Shkozes, Udha e Qiraxhive/Udha e Pazarxhive, Udha e Vra Muratit/ Tek u Vra Ahmeti; Guri i Merizit/Guri Unazes, Peshterja e Kaçakve/Shpella e Kaçakve; Ke Lisi i Shitit/Te Lisi Shytit, Ke Mollët e Koshit/Te Bregu i Koshit; Ke Shkolia/Te Shkolla, Ke Ujti i Qelbët/Te Ujt e Trubullt, Ke Vllahu/Te Maxhupi, Manastirishçe/Munishtiri etj.*

Le të jetë kjo edhe një prej arsyeve pse vepra e Mustafa Ibrahimit, *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, në kohën tonë paraqet interesa të shumfishta: gjuhësore, shkencore edhe kombëtare. E para pse qëllimi i tij parësor është botimi i një vepre me të gjitha referencat e dijes së sotme shkencore, e dyta, botimi i saj dhe ndikimi që mund të ketë në rrjedhat tona shkencore; dhe e treta, shqiptarët ende vazhdojnë të përballen me pasoja të gabimeve të brendshme historike në ndërtimin e identitetit kombëtar në gjithë hapësirën etnike, prandaj botimi i saj me një material të pasur të gjeografisë etnohistorike anësore të hapësirës etnike shqiptare, në këto rrethana merr edhe karakter të rëndësishëm kombëtar.

Struktura onomastike e zonës anësore të Shkupit

Libri i studiuesit të përkushtuar Xhemaludin Idrizi, *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003, përfaqëson një model tipik të kërkimit shkencor dhe didaktik të mikrotopo-

nimisë madje jo vetëm në zonën anësore të Shkupit po edhe të onomastikës shqiptare në përgjithësi. Vëllimi përfaqëson fillimisht një kërkim themeltar në teren, më tej një tipologji tipike gramatikore dhe për më shumë një përpjekje fillestare për të sjellë edhe ndonjë përkim a etimologji të provuar edhe më parë në studimet albanologjike.

Brenda një vëllimi të strukturuar nga aspekti didaktik mjaft kujdesshëm, e duke ju përmbajtur një modeli të antropogjeografisë studiuesi Idrizi ka ndjekur kujdesshëm kërkimet e tij në fushë të onomastikës, por duke pasur kujdes që ato t'i sistemoj sipas një tradite tashmë të njohur të gjuhësisë gjeografike. Në këtë rrjedhë, fillimisht ai ka sjellë një përshkrim etnogjeografik të Karshiakës së Shkupit, për të vazhduar më pastaj paraqitjen e vendbanimeve me radhë. Një kapitull më vete paraqesin tezën e tij orientuese mbi klasifikimin e materialit toponimik, ndërsa brenda tij, edhe sistemi i tij sipas përbërësve të tij jash-tëgjuhësor. Në një kapitull më vete janë ndarë edhe toponimet e klasifikuara sipas strukturës morfogramatikore të tyre. Kapitulli i katërt paraqet një pasqyrë të pasur të analizës gjuhësore, në të vërtetë gramatikore të mikrotoponimeve.

E parë në tërësinë e saj vepra paraqet një kërkim mjaft të sistemuar të mikrotoponimisë së kësaj ane, prej të cilës në të ardhmen mund të sillen edhe arritje të reja të karakterit historik-gjuhësor dhe madje etimologjik.

Të kësaj natyre janë edhe vepra e Vebi Rrustemit, *Hulumtime onomastike në Dervenin e Shkupit*, si dhe ajo e Izmit Durmishit, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, (2008) etj.

Enciklopedia maqedonase dhe homogjeniteti i onomastikës shqiptare

Rasti i viteve të fundit me *Enciklopedinë maqedonase* na ka dëshmuar se sjellja dhe përgjegjësia jonë institucionale ndaj pasurisë materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar nuk ka ndryshuar shumë. Përkundrazi, edhe vetë iniciativa jonë për të botuar një vëllim me kumtesa në përgjigje të akademikëve maqedonas, dëshmon se konflikti ynë me fqinjët është ende i natyrës kryengritës—shtet ose individ—institucione. Pra, në marrëdhëniet me fqinjët vazhdojmë të qëndrojmë, në njërën anë shqiptarët: sakrifikues për lirinë e tyre dhe anë anën tjetër mekanizmat e organizuar të shtetit serb apo maqedonas dhe institucionet e tyre shkencore nëpërkëmbës të kësaj të drejtë.

Konferenca shkencore, kumtesat e së cilës janë botuar në vëllimin polemizues *Enciklopedia e ndarjes*, u dominua kryesisht prej kumtesave me mbështetje të fortë në fushë të onomastikës, prandaj rezultatet e tyre po i sjell edhe në trajtesën tonë.

Kjo tryezë ishte vazhdim i reagimeve të shumta që bëheshin nga individë dhe institucione të hapësirës shqiptare dhe më tej në Europë e Amerikë, për shkak të botimit të *Enciklopedisë së Maqedonisë*, në të cilën në forma nga më të ndryshmet përçmohet historia, tradita, kultura dhe gjuha shqipe e populli shqiptar. Kjo tryezë është njëkohësisht përpjekje për të përmbushur me kompetencë intelektuale dhe shkencore përgjigjen për Akademinë e Maqedonisë, të cilën ato ditë më parë sesa institucionet politike, protestën e tyre e shprehnin grupet partiake, dhe më me forcë se sa institucionet shkencore shtetërore, këtë e bënin institucionet shkencore të vullnetit të mirë. Tryeza shkencore, në të vërtetë ishte një përpjekje që të japë përgjigje për disa nga paradigmën e përgatitjes së

Enciklopedisë maqedonase, për nocionet shkencore, për nocionet popullarizuese dhe konceptet politike që iu kanë prirë dhe që e kanë udhëhequr përgatitjen e saj, si dhe për pasojat që mund të bartë ajo në marrëdhëniet maqedonase-shqiptare, për të mos thënë, rrezikun që i sjell vetë shtetit maqedonas edhe ashtu shumë të brishtë.

Prof. dr. *Shetki Sejdiu*, në studimin e tij *Paradigma, formë sistemore (argumentimi apo edhe përgënjeshtrimi) në trajtime shkencore*, ka trajtuar një nga problemet më me ndikim në gjithë historinë e studimeve albanologjike të studiuesve serbë e maqedonas në dy shekujt e fundit. Fjala është për sintagmën *zbritje nga malet*, përmes së cilës, sikur është thënë shumë herë akademيا maqedonase përpiket ta mohojë autoktoninë e (proto)shqiptarëve në ultësira dhe në lokalitete urbane të Maqedonisë. Pra, shkruan profesor Sejdiu "*autoktonia* e banorëve shqiptarë të kësaj hapësire përmes kësaj *sintagme* është vënë në sprovë, duke harruar se *(jo)autoktonia* e banorëve të hapësirave të ndryshme të mbarë globit tokësor janë dukuri universale, probleme komplekse e edhe koncepte relative, ku nënkuptohet edhe *kronologjia* që përmban edhe konceptin *rend në kohë* dhe të tjerë faktorë e rrethana që janë në raporte kauzaliteti".

Çështjes në fjalë mjeshtri ynë fillimisht i është qasur nga aspekti semantik dhe në mënyrë interdisiplinare, ndërsa më tej, sidomos në pjesën e dytë çështja është kundruar nga aspekti antropologjik e tipologjik. Pjesët vijuese të këtij studimi i janë kushtuar konkordancave, por edhe dallimeve kundërvënëse në fushë të onomastikës me përqendrim të veçantë tek gjinia e gjenerikut të emrave të lumenjve, cilësi kjo dalluese e gjuhës shqipe dhe kundërvënëse në raport me gjuhët sllave. Vëmendje të veçantë u është kushtuar disa çështjeve të

domenit të fonologjisë diakronike, përkatësisht evoluinut të fërkimores (frikativit) /s/ në /sh/ në protoshqipe. Këto fërkimore u kanë shërbyer shumë gjuhëtarëve që nga Skoku, Bariqi e Çabeji t'i trajtojnë etimologjitë e disa toponimeve (ojkonime e oronime) si tek seria *Naissus*, *Scupi*, *Astibos*, *Lychnidus*, *Scardus*, të cilat në saje të ligjeve fonetike të shqipes kanë evoluar në të sotmet (forma): Nish, Shkup, Shtip, Ohër dhe Sharr.

Ky fenomen evolutiv ka bërë që protoshqipja të dallojë nga greqishtja, latinishtja dhe prasllavishtja dhe të ndihmojë në diskutimin rreth autoktonisë së elementit etnik shqiptar në këto hapësira dhe lokalitete urbane. Kalimi i fërkimores alveolare /s/ në /sh/ u ka shërbyer shumë gjuhëtarëve të huaj e të vendit ta shikojnë në sistem zinxhirin ojkonomik *Nish – Shkup – Shtip – Sharr* të rrjedhë nga trajtat *Naissus – Scupi – Astibos – Scardus*, ku fërkimorja alveolare /s/, sipas mendimit të Skokut, Bariqit e Çabejit ka evoluar në fërkimore alveolare qiellzore /sh/ vetëm mbi bazë të ligjeve fonetike të shqipes".

Studimi i Profesor Sejdiut është nga ato pak sinteza shkencore të shkruara në gjysmën e dytë të shekullit XX e këtij, i cili i ka dhënë përgjigjen e duhur jo vetëm akademikëve maqedonas po edhe akademikëve serbë e albanofilë përgjithësisht, prandaj mund të thuhet se përgjigjja e tij është pritur gjatë dhe ja që ishte rasti të jepej.

Në studimet onomastike Profesor Shefki Sejdiu kujtohet për studimin e thelluar që më parë rreth hidronimit Vardar, për të cilin pati shumë diskutime jo vetëm në rrethet shkencore albanologjike po edhe në ato ballkanike⁹.

Prof. asc. dr. *Iljaz Rexha*, në studimin e tij evidencues dhe krahasues *Vendbanimet dhe popullsia albane gjatë mesjetës në*

⁹ Shih studimin *Rreth etimologjisë së hidronimit Vardar*, në veprën "Sproua etimologjike", Era, Prishtinë, 2002, f. 67–82.

hapësirën e Maqedonisë së sotme (sipas burimeve sllave dhe osmane), sjell një mal të dhënash për gjendjen e popullsisë shqiptare jo vetëm në Perëndim të Maqedonisë së sotme po edhe në Qendër e në Lindje të saj.

Mbështetur në rezultatet e gjertanishme të shkollës së studimeve historiko–gjuhësore jo vetëm shqiptare, po edhe asaj europiane: *Alojz Benac, Aleksandër Stipçeviç, Radoslav Katiçiq, Fanula Papazoglu, Alain Dyciller, Konstantin Jireček, Milan Shuflaj, Skënder Anamali, Muzafer Korkut* etj., Profesor Rexha ka vendosur kufijtë gjuhësorë dhe etnografikë të vendbanimeve dhe autoktonisë së shqiptarëve thellë në lindje të Maqedonisë: *Scupin – Shkupin, Bilassora (Velesi) dhe Astibosi (Shtipi), Nishit (Naisus)* etj. për ta hapur çështjen më tej jo vetëm në hapësirën e sotme të Maqedonisë po edhe në zonën kontinentale të Ballkanit përgjithësisht. Në këtë rrjedhë Profesor Rexha i bën një sintezë të plotë gjendjes së sotme të dijes jo vetëm gjuhësore po edhe historike e gjeografike për shtrirjen e paraardhësve të shqiptarëve në Ballkan gjatë antikitetit dhe mesjetës.

Autoktonia e popullsisë albane në Ballkan, shkruan Profesor Rexha, është dëshmuar nga studiues të huaj dhe ata vendës edhe përmes toponimeve, oronimeve dhe hidronimeve parasllave që kanë marr formën nëpërmjet gjuhës shqipe: *Naissus–Nish, Scupi–Shkupi, Astibos –Shtip, Scardus–Sharr, Ulpiana–Lypian, Scodra–Shkodër, Lissus–Lesh–Lezhë, Drivastum–Drisht, Drinus–Drin, Scumbus – Shkumbin, Barbana – Buna* etj. Duke u bazuar në këto dhëna të toponimisë antike linguistët e shquar si austriaku Norbert Jokl, gjermani Gustav Waigand, dhe Henrik Bariç kanë përkrahur tezën se ishte pikërisht Dardania, e përcaktuar si zonë ndër të tjera nga emra si Nish–Shkup–Shtip, që përbënte një vatër të popullsisë së

lashtë albane. Një fakt tjetër që ishte konstatuar, sipas dëshmi-ve toponimike, nga linguisti i njohur holandez N. Van Weijk, se në mesjetën e hershme, popullsia serbe ishte e ndarë nga ajo bullgare, prej një popullsie josllave, që shpjegohet me praninë e popullsisë albane". Mirëpo, vazhdon studiuesi "gjatë sundimit mesjetar serb edhe me më shumë intensitet vazhdon sllavizimi i emërtimeve të vendbanimeve në hapësirën e Ballkanit, ku përfshihej edhe Dardania. Kështu që gjatë mesjetës, në hapësirën e Arbërisë mesjetare, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së sotme, deri përtej Selanikut të Greqisë u bë edhe sllavizimi i toponimisë parasllave, siç shihet nga dokumentet dhe burimet shkrimore mesjetare: nga *Alpes Albanicae* në *Prokletije Planina*, nga *Durrahium* – *Durrës* në trajtën sllave *Draç*, nga *Berat* në *Beligrad*, nga *Shkodra* në *Skadar* nga *Ulkinon* – *Ulkos* në *Ulcinj*, nga *Doclea* në *Zeta*, nga *krahina Palabardhi* në *Belopavliç Zhupa*, nga *Buna* në *Bojana*, nga *Bardusi* në *Belosh*, nga *Bardoniq* – *Beliç*, *Bardosan* – *Lipovac*, nga *Guri Kuq* – *Crveni Kamen*, nga *Guri Zi* në *Kamenica*, nga *Ujmir* në *Dobra Voda*, nga *Scupi* – *Shkupi* në *Skopje*, nga *Bardofci* – *Gjorgje Petrov*, nga *Bardarios* në *Vardar*, nga *Kumanova* në *Nagoriç* nga *Manostiri* në *Bitola*, nga *Bilassora* në *Veles*, nga *Dibra* në *Debar*, nga *Kiçova* në *Kiçevo*, nga *Malesheva* në *Malesh* – *Pllanina*, nga *Thessalonikis* në *Solun* nga *Byzantion* – *Kostantinopolis* në *Carigrad*, nga *Filipolis* në *Plovdiv* etj".

Në pjesën më të madhe të studimit të tij njaft të vëllimshëm paraqitet inventari shumë i pasur i toponimisë, antroponimisë dhe sidomos patronimisë së albanëve në Perëndim dhe në Verilindje të Maqedonisë gjatë Mesjetës, të vjelë nga dokumentet e Arkivave turke të shekujve XV–XVI. Fjala është për toponime të ndryshuara gjatë shekujve të Perandorisë Osmane dhe gjatë mesjetës bizantine, si dhe për patronimin etnike të

shqiptarëve të lidhur qoftë edhe vetëm me patronimin etnonimik arbëror, si: *Petro Arbanas, Dimitri Arbanas, Nikolla Arbanas, Bogdan Arbanas, Bogoslav Arbanas, Milosh Arbanas, Gjuro Arbanas, Mihajl Arbanas, Todor Arnaut, Andreja Arnaut, Lazar Arnaut apo Jusuf Arnaut ose Hamza Arnavut* etj.

Pjesën më të madhe të këtij materiali e zë ojkonimia dhe patronimia e trashëgimisë shqiptare në disa vendbanime të Maqedonisë së sotme në vendbanimin e *Kërçovës: Lagja arbane* me formën turke *Arnaut*, e përftuar nga forma greke *Arvanit*; vendbanimi *Lukotinc* (Kërçovë); në *Shkup: Mëhalla Gjinko*, që rrjedh nga patronimi *Gjinaj*; në vendbanimin *Jelov Dol* (Tetovë); në fshatin *Poroj–Proj* (Tetovë); në fshatin *Ponorisht* etj.

Një grup pseudoshkencëtarësh sllavë të Maqedonisë në krye me Riste Blazhevskin, përfundon Profesor Rexha, kohëve të fundit po pretendojnë dhe po mundohen t'i mohojnë faktet historike dhe argumentet shkencore, e sidomos burimet arkivore dhe defterët zyrtarë kadastralë të administratës osmane të shekullit XV të pranuar nga studiuesit vendas dhe të huaj, për praninë e popullsisë albane në mesjetë, pra, para shekullit XVI në tërë hapësirën e Maqedonisë së sotme. Ky grup, mjerisht po shërbehet me tezën e falsifikuar dhe të shpikur nga kuzhina e arsenalit propagandistik të historiografisë nacional–shoviniste serbe, e cila qysh para katër dekadash është ç’vlerësuar dhe demantuar, me zbulimin e gjetjeve të reja arkeologjike dhe dokumenteve të reja arkivore e sidomos të atyre të proveniencës osmane – turke. (...) Shteti njënational i Maqedonisë së sotme është jetëshkurtër dhe jostabil, ndërsa, shteti qytetar dhe multietnik i Maqedonisë me të drejta të barabarta politike, gjuhësore dhe kulturore për të gjitha nacionalitetet e saj, pa dallim etnie dhe feje, ka perspektivë reale dhe jetë të gjatë.

Le të theksojmë në fund gjithashtu se pjesën më të madhe të studimeve të tij në fushë të onomastikës mjeshtri ynë i ka sintetizuar në monografinë “Onomastika mesjetare arbane në arealin e Dardanisë”¹⁰, në të cilën janë përfshirë shumë dokumente të proveniencës kryesisht sllave e orientale, dhe përmes të cilave janë unifikuar një numër i madh emërvendesh dhe madje etnonimesh në hapësirën e antikitetit dardan dhe mesjetës së hershme.

Standardizimi politik i toponimisë dhe antroponimisë në Maqedonisë

Përpjekjet e para për formimin e komisioneve republikane dhe krahinore për standardizimin e emërvendëve në Jugosllavi lidhen me Maqedoninë. Prej projekteve komisionit maqedonas, prej qëllimeve të tij dhe prej rezultateve të para të tij, parësisht prej udhëzimeve dukshëm më të arsyeshme nga Komisioni Federativ, nuk është vështirë të kuptohet se koncepti i tyre ishte nxjerrë nga laborator i vjetër i Beogradit, me qëllim të mënjanimi të toponimisë tradicionale bilinge në trojet etnike shqiptare brenda Maqedonisë. Gjithashtu kjo sjellje e Komisionit të administratës maqedonase ishte vetëm një sinjal paraprak për rezultatet që duhej të priteshin edhe në pjesën tjetër të toponimisë së arealit shqiptar në ish-Jugosllavi (Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi).

Sipas projektit të Komisionit Republikan të Maqedonisë, vendimet e të cilit shpejt u bënë të ligjshme dhe të referueshme jo vetëm në administratën e përditshme, por edhe në tekstet shkollore, toponimet shumëgjuhëshe në Maqedoni duhet të shkruheshin, duhet të shqiptoheshin dhe duhet të përdorshin

¹⁰ Prishtinë, 2005, f. 450.

vetëm në gjuhën, përkatësisht, në trajtën e gjuhës maqedonase, si: *Shkup*: Skopje, *Tetovë*: Tetovo, *Ohër*: Ohrid, *Kërçovë*: Kiçevo, *Dibër*: Debar, *Manastir*: Bitola etj. Nëse këto vendime merreshin dhe imponoheshin dhunshëm për qytetet më të mëdha të vendit, për qytetet ku historikisht popullsia shumicë ishte popullsia shqiptare, sot mund të merret me mend se çfarë vendimesh janë marrë apo do të merren më vonë për hidroniminë, oroniminë, dhe mikrotoponimet e tjera anësore për opinionin por të thella dhe shumë të rëndësishme për historinë e gjuhës dhe të vendit.

Sikur është thënë disa herë edhe në shtypin zyrtar, shkencor e atë të verdhë maqedonas, mënjanimi i toponimisë së etimologjisë shqiptare në Maqedoni arsyetohej edhe me joautoktoninë e kësaj popullate në trojet etnike të tyre shqiptare. Ky ndryshim prandaj, kishte prapavijë ekskluzivisht politike, të cilën për shumë kohë Beogradi e kishte mbjellë dhe po e impononte edhe në politikën ditore të Maqedonisë. Është e kuptueshme prandaj pse «standardizimi» i toponimisë së Maqedonisë do të përcillet me reagine publike të punonjësve të kulturës e të shkencës shqiptare në Maqedoni dhe do të ketë pasoja politike për banorët e këtyre qyteteve, të cilët për shkak se nuk do të pranojnë të respektojnë emrat e «standardizuar» të qyteteve dhe vendbanimeve të tjera të tyre, shpesh do të dënohen me dënime materiale dhe me dënime burgu. Përtej saj, dënimet e tyre do të jenë të shumta dhe të rënda për shkak se do të plotësohen edhe me akuza politike.

Kundër këtij «standardizimi» në mënyrë të veçantë do të reagojnë personalitetet e kulturës dhe të shkencës në Kosovë. Do të shkruajnë në shtypin ditor dhe në shtypin shkencor kundër standardizimit që nuk respektonte rezolutat ndërkom-bëtare, nuk respektonte traditën a trashëgiminë vendase, nuk

respektonte kulturën gjuhësore të vendit etj. Në të vërtetë, Komisioni republikan, më parë sesa të merrej me standardizimin e emrave të qyteteve a të fshatrave të Maqedonisë, merrej me zhbërjen, çrrënjosjen, vrasjen e tyre, prandaj me të drejtë standardizimi i toponimisë që quajtur atentat mbi kulturën¹¹.

Përveç zhbërjes dhe ndryshimit të toponimisë, në Maqedoni që ndërmarrë një fushatë e egër e ndryshimit dhe ndalimit të krejt asaj që kishte karakter nacional: gjuhës, shenjave kulturore, historike e etnografike, këngëve dhe madje emrave. Pra, në Maqedoni po përpiqeshin të ndryshonin paraprakisht elementet shpirtërore të popullit shqiptar. Një ironi e vërtetë. Një element të cilin nuk kishte mundur ta zhbënte administrata e dy perandorive interkontinentale, po përpiquej ta zhbënte një administratë e padenjë kombëtare maqedonase!

¹¹ Shih, Tryezën shkencore dhe më pas vëllimin: *Gjendja e onomastikës shqiptare në momentin e tanishëm*, të cilin e organizoi Instituti Albanologjik i Prishtinës në mars të vitit 1987. Tekstet dhe diskutimet u botuan në revistën «Gjuha shqipe», nr. 1, IAP, Prishtinë, 1987: prof. dr. Fazli Syla, *Fjala e hapjes*; akad. Idriz Ajeti, *Njësia brenda ndryshimeve ka vlerë absolute*; akad. Rexhep Qosja, *Atentat mbi kulturën*; prof. dr. Latif Mulaku, *Toponimet shumëgjuhëshe të Kosovës*; prof. dr. Besim Bokshi, *Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë*; dr. Shaqir Berani, *Dhunën gjuha s'e duroi*; dr. Rexhep Ismajli, *Onomastika e mbikëqyrur*; Shkëlzen Maliqi, *Errësimet dhe ndriçimet e njëmendësisë*; mr. Mehmet Halimi, *Emri Shkup dhe rrjedhjat e tij*; dr. Bajram Krasniqi, *Albanologjia sot*; dr. Shefki Sejdiu, *Gjuha është sistem që njëh vetëm rendin e vet*; dr. Agim Vinca, *Atë që ia lejon vetes mos ia ndalo tjetrit*; mr. Rexhep Doçi, *Qëndrimet kundërtëhënëse në fushën e onomastikës*; Isa Bajçinca, *Emërtimet e vendeve dhe norma letrare*. Krahas botimit të përbashkët, pothuajse të gjithë artikujt u botuan edhe në shtypin e përditshëm të Prishtinës, të Tiranës dhe të qendrave kulturore e informative të Jugosllavisë, kryesisht në Zagreb dhe Lubjanë. Gjithashtu shumë nga këto tekste janë emituar edhe në Radio Tirana. Të njëjtit artikuj dhe të tjerë janë botuar edhe në disa botime të mëvonshme autoriale.

Kjo është arsyeja pse kundër këtyre veprimeve patën reaguar në mënyrë të veçantë edhe studiuesit e kësaj ane nga radhët e shqiptarëve. Albanologu dhe ballkanologu Qemal Murati, në një nga studimet e tij mbi emrin nacional të shqiptarëve¹² përfundonte: “emri shqiptar nuk mund të barazohet me “ai që kupton” ashtu sikurse edhe emri sllav, slovenin që nuk mund të lidhet me slovo “fjalë”, “ai që flet e kupton”. Ky i fundit Slaven, bashkë me rrjedhojat *Slavan*, *Slavjan*, *Slavin*, *Sloven*, *Slovin*, *Slovak* në thelb ka karakter gjeografik, të vendit *Slave*, *Slavisko* në *Sarmati* e në *Dnjepër*, prej nga u shkulën dhe erdhën në Gadishullin Ilirik (tani Ballkanik). Ky emër, pra, nuk shkon me *slave* (gloria), siç është menduar dikur, apo slova (logos) siç mund të mendojë sot dikush¹³. Karakter të këtillë gjeografik ka edhe emri i sotëm nacional serb, që reflekton në thelb edhe topikun Sarbske në bregun e Detit Balltik dhe pranë liqenit Sarbskesche See, prej nga janë ardhur në truallin ilirik”¹⁴. Ndërsa duke polemizuar me mentalitete individuale dhe institucionale serbe e maqedonase lidhur me identifikimin e shqiptarëve në një nga periudhat më të errëta të fundshekullit XX shprehej me shqetësim: “në kryqëzatën e tërbuar serbe të zhvilluar tash e sa vjet sistematikisht kundër çdo gjëje që është shqiptare: kundër gjuhës, kundër historisë dhe kundër kulturës përgjithësisht, me një fjalë kundër gjithë qenies kombëtare shqiptare, hegjemonistët ortodoksë të tipit të katër S–ve cirilike, në emër të luftës kundër “nacionalizmit shqiptar” e “kontrarevolucionit” në Kosovë (të gjitha të paqena), kanë zbatuar dhe zbatojnë format më të vrazhda

¹² Eqrem Çabej (*Konferencë shkencore*, 1998), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2006, ff. 76–77.

¹³ J. Dragasheviç, *Makedonski sloveni*, 16.

¹⁴ Po aty. 24.

represive dhe poshtëruese mbi popullsinë e pafajshme shqiptare, duke ia veshur kësaj madje edhe atributet më të zeza që s'i mban kandari. Me këtë të ethshme dhe të shfrenuar historike albanofobike, vazhdon autori ynë, të pangopur me represaljet, terrorin dhe poshtërimet, korda mitomane serbe, në vargun e shumë përdhunimeve kundërshtiptare, tash e sa kohë ka filluar ta përdhunojë edhe *emrin nacional të shqiptarëve*, në një anë që të ngjallë aversion e ta provokojë edhe më tej popullatën shqiptare, e në anën tjetër që ta shprehë tërbimin e plotë të saj”¹⁵. Për të përfunduar: “Nga popujt e qytetëruar të botës termat *Arnaut* e *Šiptari* me kuptim përbuzës i përdorin vetëm pjesëtarët e serbëve e maqedonasve, e në këtë valle mitingistët e “Serbisë së Madhe”, dofarë njetesh (dez)informative të Beogradit, “Jedinstvo”—ja cirilike bozhuriane, dosar anëtarësh të Shoqatës së luftëtarëve të Serbisë, njëfarë akademiku i mendermethënshtëm shqiptarofobik Antonie Isakoviç, njëfarë ministri po ashtu i mendermethënshtëm i arsimit të Maqedonisë Savo Klimovski, njëfarë Partie politike MAAK e Maqedonisë etj., pra biçim burash e institucionesh”!¹⁶

Në institucionet arsimore, kulturore apo shtetërore të Maqedonisë nuk mund të dëgjoheshin këngë me përmbajte historike, nuk mund të përdorej gjuha shqipe në institucionet shtetërore, nuk mund të visheshin rroba me ngjyra që zgjonin asociacione të simboleve kombëtare shqiptare etj. Në mënyrë të veçantë, në Maqedoni nuk mund të emërtoheshin fëmijët me emra të traditës historike dhe bashkëkohore shqiptare, si dhe me emra të leksikut autokton shqiptar.

¹⁵ Qemal Murati, *Konservacione dhe inovacione gjuhësore në fushë të shqipes*, “Flaka e vëllazërimit”, 1991, ff. 70–71.

¹⁶ Po aty, ff. 71–72.

Shqiptarët në Maqedoni mund t'i emërtonin fëmijët me emra oriental me shtrirje nga Ballkani deri në Azia madje edhe me emra të atyre personaliteteve politike të botës bashkëkohore aziatike apo afrikane; shqiptarët në Maqedoni mund t'i emërtonin fëmijët me emra heronjsh të Europës dhe Amerikës, madje me emra të njohur historikisht dhe me emra bashkëkohorë; në Maqedoni, shqiptarët mund t'i emërtonin fëmijët e tyre me emra artistësh nga të gjitha kontinentet e botës; por shqiptarët në Maqedoni, nuk mund t'i emërtonin fëmijët e tyre me emra historikë dhe bashkëkohorë të fondit të antroponimisë shqiptare: *Ilir, Agron, Arbër, Kastriot, Arben, Genc, Alban, Flamur, Kushtrim, Liridon, Teutë, Arbnore, Albanë, Shqipe, Ilirianë, Migjen, Asdren, Nol, Frashër* etj.

Kështu, në Maqedoni, përveç «standardizimit» të toponimisë, me masa administrative dhe ndëshkimore, në të vërtetë me udhëzime policore, qe filluar edhe «standardizimi» i antroponimisë, dhe përtej saj edhe «standardizimi» i trashëgimisë etnokulturore shqiptare! Ishte koha kur në Maqedoni bëheshin përndjekje shtrigash jo vetëm mbi individët, por edhe mbi trashëgiminë nacionale të popullsisë shqiptare.

Si në Serbi, shekuj me radhë, ashtu edhe në Maqedoni, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, janë bërë shumë përpjekje që toponiminë ta përdorin për qëllime thjesht politike. Duket e pabesueshme, por populli maqedonas, që deri në gjysmën e parë të shekullit XX kishte pësuar shumë në aspektin gjuhësor, kulturor, historik dhe qytetërues nga fqinjët e parë të saj sllavë dhe grekë, tashti ishte bërë vetë mendja e errët e koncepteve antikulturore dhe përgjithësisht antiqytetëruese të tyre. Akademikët dhe institucionet shkencore të Maqedonisë së re, problemet e së cilës fillonin me vetë emërtimin e saj, të

kontestuar nga Greqia, i lejuan vetes që të propozojnë ndarjen etnike të Maqedonisë mbi bazën e ojkonimisë.

Ku koncept i mbështetur në hartën etnike të toponimisë, ideja themelore e së cilës është ngritur në institucionet shkencore, politike, kulturore dhe madje kishtare serbe, kohëve të fundit është bërë objekt referimi jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për rajone të tjera të Ballkanit Perëndimor, me shtrirje kryesisht mbi arealin etnografik dhe gjuhësor të popullit shqiptar.

Toponiminë e madje edhe antroponiminë, e kanë shfrytëzuar si referencë edhe organizatat politike dhe ushtarake gjatë zhvillimeve të fundit në ish-Jugosllavi dhe në Ballkan. Referimi në këtë element është bërë me qëllim polemike me konceptet historiografike dhe mitike serbe dhe maqedonase mbi të cilat është ndërtuar dhe po ndërtohet politika e pushtimeve serbe në Ballkanin Jugor dhe Perëndimor.

Përfundime

Studimet onomastike, ashtu sikur edhe studimet albanologjike në përgjithësi, nuk kanë ndonjë përvojë të gjatë në Maqedoni, por studimet ballkanologjike megjithatë shumë herë e bënë objekt studimi pasurinë materiale e shpirtërore të shqiptarëve të këtushëm, edhe më parë, si nga Selishçev, Norbert Jokli, Jovan Cvijiq, Petar Skok etj. Shkolla kombëtare e atjeshme, me pasurinë shpirtërore e materiale të kësaj zone, u mor kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit XX. Fillimisht, interesimi i kësaj shkolle kishte të bënte me historinë nacionale dhe pasurinë dialektore të të folmeve shqipe të kësaj ane, por brenda po kësaj kohe filluan edhe hapat e parë të regjistrimit të toponimisë shqiptare, për të vazhduar edhe me studimin e saj në diakroni dhe sinkroni. Në këtë rrjedhë kontributin e tyre e kanë dhënë linguistët shqiptarë: Petro Janura, Fadil Sulejmani, Remzi Nesimi, Zihni Osmani, Hamit Xhaferi, Vebi Bexheti, Naim Basha, Haki Ymeri, dhe në mënyrë të veçantë studiuesit e leksikut e të toponimisë: Qemal Murati, Asllan Hamiti, Xhemaludin Idrizi, Mustafa Ibrahim, Vebi Rrustemi, Izmit Durnishi etj.

Prej veprave monografike të tyre, prej studimeve të tyre, prej dokumenteve arkivore të botuara nga historianët shqiptarë dhe të huaj, prej leksikut toponimik të mbledhur në tërthoret e trojeve shqiptare në Maqedoni, prej korpusit patronimik të shqiptarëve në këto treva dhe prej disa përbërësve të tjerë, mund të sillen edhe disa vlerësime, sado të përgjithshme qofshin. Prej kërkimeve të gjertanishme në terren dhe nga dokumentet e proveniencës sllave, helene, orientale a perëndimore janë saktësuar disa përbërës fonetikë dhe struktura

morfologjike të mikrotoponimisë shqiptare në këtë tërthore, disa struktura fjalëformuese të sotme dhe historike të shqipes anësore; disa zhvillime historike të patronimisë së shqipes së kohës së re, patronimisë mesjetare dhe madje ojkonimisë e oronimisë së antikitetit të Europës Juglindore; disa reflektime kuptimore e ndikime politike të dekadave të fundit, të lidhura ngushtë me zhvillimet politike të shtetit të Maqedonisë etj. Prandaj, sot mund të thuhet se studimet albanologjike, e në këtë rrafsh edhe studimet onomastike e kanë krijuar institucionin e tyre nacional në Maqedoni.

ASLLAN HAMITI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski" – Shkup

TOPONIMIA DHE MIKROTOPONIMIA SHQIPTARE NË MAQEDONI – DËSHMI E AUTOKTONISË

Shpeshherë është thënë e po thuhet jo rrallë se: shqiptarët në Maqedoninë e sotme nuk janë vendës, por kolonë të ardhur pas shekullit XVI me dyndje të herëpashershme në shekujt XVII, XVIII, XIX e deri në shekullin XX. Edhe në Enciklopedinë Maqedonase, në zërin për shqiptarët lihet të kuptohet se shqiptarët nuk kanë qenë të pranishëm në viset e sotme të Maqedonisë as në Antikitët, as në Mesjetë.

Në tribunën shkencore që bashkorganizuan Instituti i Gjuhës Maqedonase “Kërste Misirkov” dhe Katedra e Maqedonishtes së Fakultetit të Filologjisë “Blazhe Koneski” në Shkup në temë “Standardizimi i emrave gjeografikë në Republikën e Maqedonisë”, Shkup, 2004¹ u tha e u përsërit disa herë se: me versionin në shqip të Ligjit për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 55, 16 gusht 2004 po bëhet përkthimi, çmaqedonizimi dhe albanizimi i emrave gjeografikë në Maqedoni (ИНСТИТУТ, 2004: 18–20). Në këtë drejtim, shkohet edhe më larg duke thënë se: toponimia e Maqedonisë me shekuj është krijuar

¹ Институт за македонски јазик “Крсте Мисирков” – Скопје, Јазикот наш денешен – книга 11, *Стандардизацијата на географските имиња во Република Македонија*, Зборник на трудови од трибината одржана на 30 септември 2004 година, Скопје, 2004.

dhe formuar nga maqedonasit. Së këndejmi, na duket se është krejtësisht e natyrshme që në kuadrin e toponimisë maqedonase të veprojë tradita maqedonase (Станковска – Миовски, 2004: 22). Përveç tjerash, thuhet edhe se po mohohet tradita ekzistuese maqedonase dhe po ndërrohet toponima maqedonase, d.m.th. po albanizohet. Përkthimi ka përfshirë, para së gjithash, emrat e vendbanimeve si dhe emrat e tjerë gjeografikë aq shumë sa që jo vetëm që cënon, por krijon destruksion të përgjithshëm të sistemit toponimik maqedonas në planin gjuhësor, etnik dhe komunikues (Станковска – Миовски, 2004: 24–27).² Përkundër shqiptarëve, turqit kanë qenë këtu 500 vjet, por nuk kanë bërë riemërtimin e ojkonimeve, bile as të mikrotoponimeve... (Стаматоски, 2004: 103). Në kumtimin e vet një pjesëmarrës propozoi që gjatë transkriptimit të toponimeve gjithnjë të ruhet forma maqedonase (Јачева – Улчар, 2004: 49–58).

Në një kumtesë tjetër për gjoja depërtimin e dhunshëm të elementit shqiptar në Maqedoni (në aspektin gjuhësor), me paragjykim, që kurrë nuk e ka shënuar historia, thuhet se “ekspansioni më i madh – ekspansioni i furishëm, shkatërrimtar dhe gjakatar (dyndjet në lindje dhe në jug) kanë ndodhur nga fundi i shekullit XVII dhe në shekujt XVIII–XIX... Jeta e popullatës ortodokse maqedonase në kushtet e terrorit të paparë që vazhdimisht e kanë ushtruar shqiptarët gjatë ekspansionit të tyre në lindje, qe vështirësuar tej mase, jo vetëm për shkak të torturës dhe shfarosjes që ushtronin ekspansionistët,

² “...барањата за рамноправност и во рамките на употребата на топонимите, односно на географските имиња, а што во основа се сведува на барање за промена на македонскиот топонимски систем, односно за негова албанизација”.

por edhe për shkak të tagrave të shumta që mbliidhte pushteti turk... (Пеев, 2004: 31–41).”

Një pjesëmarrës në diskutimin e tij jep disa të dhëna të rëndësishme e interesante: “në Republikën e Maqedonisë ka afër 1800 vendbanime. Në shkencë është vërtetuar se 90% e këtyre emërvendeve kanë etimologji maqedonase, përkatësisht sllave, ndërsa vetëm 10% kanë burim gjuhësh të tjera, nga substrati (kryesisht iliro–trakas), turqishtja si dhe disa emra të trashëguar nga administrimi serb në Maqedoni... Më duket shumë interesante që në ojkonimi, edhe krahas bashkëjetesës me shqiptarët në disa vende në Maqedoni, vetëm një – Qafa, në qarkun e Gostivarit është me prejardhje nga shqipja. Kjo është formë shqipe, sipas greqishtes *Gjavato* ‘kalim, shteg’, siç e ka edhe maqedonishtja ‘премин’. Do të thotë, (shqiptarët) nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi, nëse paskan jetuar këtu, ose, siç thonë se me shekuj Maqedonia Perëndimore paskësh qenë e tyre... (Стаматоски, 2004: 102–108)”.

Mbështetjen kryesore për të mohuar vazhdimësinë ilire – shqiptare, rrjedhimisht edhe autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan, përfshirë edhe autoktoninë e shqiptarëve në Maqedoni, përpiqen ta gjejnë në përhapjen e dendur të toponimeve sllave në Gadishullin Ballkanik. Të dhënat historike e studimet toponomastike dëshmojnë se toponimet sllave, të cilat sot janë të përhapura jo vetëm në viset shqiptare të Maqedonisë, por edhe në mbarë Gadishullin Ballkanik, nuk ndeshen në shekujt e hershëm mesjetarë. Ato në burimet dokumentare dalin më vonë, përkatësisht pas shekullit XI e këtej (Frashëri, 2009: 9–10).

Në artikullin analitik me peshë “E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit”, botuar në gazetën Shqip të 09–10 dhjetorit 2009, historiani i

njohur shqiptar, prof. Kristo Frashëri flet bindshëm për gabime metodike dhe faktologjike të rënda të Enciklopedisë.

Gabimi i parë i palejueshëm për historianët, madje edhe për mësuesit e shkollave të mesme, është “shkelja e parimit më elementar të metodologjisë shkencore të historiografisë, e cila kërkon që ngjarjet historike të shihen në kohë dhe në hapësirë përkatëse. Është pikërisht ky gabim që vihet re në zërin “shqiptarët e Maqedonisë” në Enciklopedinë maqedonase. Në bazë të këtij parimi, Maqedonia antike nuk duhet të identifikohet as për nga shtrirja gjeografike, as për nga etnikoni i banorëve me Republikën e Maqedonisë së ditëve tona. Para së gjithash meqë shtrirja gjeografike e Maqedonisë, gjatë shekujve nuk ka qenë kurdoherë e njëjtë. Kohë pas kohe, kufijtë e saj territorialë kanë pësuar luhatje. Madje, ka pasur raste kur emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur krejtësisht jashtë kufijve të sotshëm të saj... Është e vërtetë se herë pas here emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur, por zhvendosja ka ndodhur kryesisht drejt lindjes deri në Selanik e përtej dhe asnjëherë drejt veriut, në kurriz të provincës së Dardanisë... Si përfundim, nuk është e drejtë orvatja e disa historianëve, të cilët kur ngjarje që kanë ndodhur në brezin jugor të Dardanisë antike i përfshijnë si ngjarje që i takojnë Maqedonisë antike dhe mesjetare (Frashëri, 2009: 9–10).

Kur flet për strukturën etnike të Maqedonisë në shekullin VI, në pragun e dyndjeve sllave, prof. Kristo Frashëri thotë: “Para se sllavët të vendoseshin në Gadishullin Ballkanik, pra para Mesjetës së hershme, maqedonët e sotshëm, si pjesëtarë të etnive sllave, banonin në stepat e Rusisë. Nuk dimë të ketë historianë që ta kenë ndriçuar parahistorinë e sllavëve, pra historinë kur ata jetonin në atdheun e tyre të hershëm, e cila është ende thellësisht e errët. Në fakt, etnogjeneza e maqedo-

nëve të sotshëm fillon me dyndjet e tyre nga stepat ruse dhe me ngulitjen e tyre në trevat ballkanike. Pra, fillon kur ata u bënë fqinj me popullatat ilire, të cilat banonin në Gadishullin Ballkanik që nga agimi i historisë e këtej. Megjithatë, procesi i formimit të etnisë maqedone apo i paraardhësve të tyre bullgaro-sllavëve nuk u krye menjëherë pas vendosjes së tyre në Gadishullin Ballkanik. Ai pushton shekujt e Mesjetës së hershme” (Frashëri, 2009: 9–10).

Një varg dijetarësh të shquar: historianë, arkeologë e gjuhëtarë shqiptarë e të huaj kanë sjellë një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore për origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga argumentet e vazhdimësisë ilire – shqiptare dhe e autoktonisë, tani më të njohura botërisht janë këto:

1. Shqiptarët banojnë sot në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar popullsi ilire; nga ana tjetër, në burimet historike nuk njihet ndonjë emigrim i shqiptarëve nga vise të tjera në trojet e sotme. Sipas Eqrem Çabejt, vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni, po një trevë restriksioni, përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë.
2. Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra vendesh, fisesh, emra njerëzish, glosa, etj., që janë njohur si ilire, gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.
3. Format e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krahasuara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë zhvilluar sipas rregullave të fonetikës historike të shqipes, d.m.th. kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.
4. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten tregojnë se shqipja është formuar dhe është zhvi-

lluar në fqinjësi me këto dy gjuhë këtu në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.

5. Të dhënat arkeologjike dhe ato të kulturës materiale e shpirtërore, dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë te shqiptarët e sotëm.

Studimet onomastike shqiptare dëshmojnë se shumë toponime (emra qytetesh, malesh e lumenjsh) të Ballkanit, përfshirë edhe territorin e sotëm të Maqedonisë janë të lidhura me shtresën ilire, si **Shkup** (nga forma e lashtë Skupi), **Mali Sharr** (Skardus Mons), **Vardar** (Bardouarios, Bardaros, Bardarion, Bardarus, Bardarum, Bardal, Vardarus, Vardar, nga bard, bardh, bardhar ‘lumë i bardhë’), Kërçova në antikë njihej si **Uscana**, Hyskana, Uskana, **Dibër** (Deborus), **Shtip** (Astibos), emra njerëzish e vendbanimesh **Bardus**, **Bardhovec**, **Bardovc** (nga bardh) etj.


Onomastika shqiptare ka arritur në përfundim se edhe tek emrat e mbiemrat e njerëzve shihen përputhje të ilirishtes me shqipen. Ka analogji emrash ilirë, si **Bardus**, **Barduli**, **Bardyllis** me të shqipes **Bardhyl** (që të gjithë përmbajnë fjalën ‘bardh’; ilir. **Dasius**, **Dassius**, **Dasimus** – shq. **Dash-i**; ilir. **Bato** – shq. **Bato**; ilir. **Lacius** – shq. **Laç-i**; fisi ilir në Shqipëri të Mesme **Taulantët** – shq. emër personal **Taulant**; emri i **ilirëve** – shq. emër njeriu **Ilir**; emri i mbretëreshës **Teuta** – shq. emër femre **Teuta**; emri i fisit ilir **Dardan** – shq. emër njeriu **Dardan**, –e dhe emër lagjeje **Dardani**.

Emra vendesh, mëhallësh e njerëzish me rrënjën **Alb-**, **Arb-**, **Arn-**, **Arv-**, si **Albincë**, **Allbanaic**; **Arbnesh**, **Arbëresh**, **Arbër**, **Arbën**, **Arben**; **Arbinovë**, **Arbanashko**, **Arbanasi**, **Arbino**, **Arnaut**, **Arnavud**, **Arbasanci**, **Arvati**; **Arnaudov**, **Arnaqi**, **Arbanash**, **Arbanas** dëgjohen dendur në truallin e Ballkanit, përfshirë edhe gjithë Maqedoninë.

Të dhënat historike dëshmojnë se fise ilire që në shekujt V–VI para erës sonë kanë banuar pjesën më të madhe të territorit të Maqedonisë së sotme. Dihet mirëfilli se **Enkelejtë** ishin banorë të trevës së liqenit Lihnid (liqeni i Ohrit), **Linkestët** ilirë përreth Manastirit, **Deriopët** në rrethinën e Prilepit, **Dasaretët**, një nga fiset e mëdha të Ilirisë Jugore, banorë të krahinës Dasaretia, që përfshinte edhe pjesën perëndimore të liqenit Ohrit. **Dardanët** me qendër në Shkup, jetonin në pjesën veriore të Maqedonisë, në gjithë Kosovën, përkatësisht në një territor të gjerë, në trekëndëshin Shkup – Nish – Sofje. **Paionët** ishin një grup fisesh ilire që banonin në luginën e sipërme të Aksiosit (Vardari) dhe degëve të tij, duke u shtrirë në Lindje deri te lugina e Strymonit (Struma) në kufi me fise trake, në Perëndim në kufi me dardanët, penestët dhe dasaretët e Ilirisë.

Ndihmesë të madhe për gjuhësinë shqiptare, veçmas për onomastikën, duke e mbrojtur origjinën ilire të shqiptarëve, kanë dhënë Norbert Jokli, Xylanderi, Miklosichi, Johan G. fon Hahni, Holger Pedersen, G. Vajgandi, Petar Skoku, Herman Hirti, Konstatin Jereçeku, Albert Thumbi, Meyeri, Vacllav Cimohovski, Paul Kreçmeri, Konstatin Jireçeku, Petar Skoku, Radoslav Katiçiqi, Karlo Tagliavini etj. Nga studiuesit shqiptarë për çështje të onomastikës shquhen prof. Eqrem Çabej, Mahir Domi, Kolë Luka, Palok Daka, Aleksandër Xhuvani, Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaj, Seit Mansaku, Xhelal Ylli, Xhevat Lloshi (Shqipëri); Aleksandër Stipçevisq (arbnesh i Zarës), Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Shefki Sejdiu, Rexhep Doçi, Skender Gashi, Baftjar Kryeziu, Begzad Baliu (Kosovë), Desnickaja (albanologe ruse); Qemal Murati, Xhemaludin Idrizi, Mustafa Ibrahim, Izmit Durmishi, Asllan Hamiti (Maqedoni), Ruzhdi Ushaku (Mal të Zi), Zef Valentini

kanë po të njëjtat tipare gjuhësore me të folmet e Shqipërisë, përkatësisht ato të Fushë-Krujës, të Krujës, të Malësisë së Madhe, të Matit, të Mirditës, të Lumës, të Peshkopisë. Siç



dihet, të folmet që sapo u përmendën përbëjnë një izoglosë, një tërësi dialektore, pra janë shumë homogjene: i takojnë dialektit të gegërishtes, nëndialektit të gegërishtes jugore dhe grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore.

Siç dihet, në këto të

folme, në dallim nga të folmet e tjera shqipe e joshqipe në Ballkan, janë zhvilluar disa risi (inovacione) fonetike: diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara, zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/, qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] dhe evoluimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] në shkallë të ndryshme qiellzorëzimi. Çmujmë si të dobishme në këtë rast për lexuesit të japim pak shpjegime për këto inovacione fonetike karakteristike për të folmet e gegërishtes qendrore:

a) Diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara. Në pozitë të theksuar, /i/-ja e theksuar /i:/ shpërbëhet në variante diftongjesh [âi], [êi], [ëi], [ôî]: *shpi* > *shpâi*, *shpêi*, *shpëi*, *shpôî*; /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/ dhe më vonë ka pësuar të njëjtën rrugë zhvillimi, është diftonguar si edhe /i/-ja parësore: *sy* > *si* > *sâi*, *sêi*, *sëi*, *sôî*; ndërsa /u/-ja shpërbëhet në diftongjet [âu], [ôu], [êu], sipas tipit nuse > *nâuse*, *nôuse*, *nêuse* e në shumë fjalë të tjera.

Nga monografitë dhe skicat dialektore mund të nxirret si përfundim se në gegërishten qendrore në pozita të caktuara fonetike në formë të diftonguar përdoren jo pak fjalë shqipe, huazime latine, greke si dhe huazime të hershme sllave e turke. Përgjithësisht, huazimet e vonshme sllave shqiptohen të padiftonguara, si *raki*, *bolli:c* < bolnica ‘spital’, *stani:c* < stanica ‘stacion’, *grani:c* < granica ‘kufi’, *stoli:c* < stolica ‘karrige’ etj. Edhe të huazimet turke kemi forma të dyfishta, të padiftonguara, si *jeshil*, *katil*, *pestil*, *gjigjin*, *sifir*, *bitis*, *kurtalis*, *terezi* etj. dhe të diftonguara, si *xhamâi*, *munafâik*, *pazarllâik*, *begenâis*, *iqindâi*, *askerllâik*, *temcâi*, *çivâi*, *axhamâi*, *saballâik* etj. Edhe toponimet anase shqiptohen në formë të diftonguar, si p.sh. në Karadakun e Shkupit: *Haraçâin* ‘Haraçinë’, *Grushâin* ‘Grushinë’, *Traçêic* ‘Straçincë’ etj. Mbizotëron mendimi se diftongimi është dukuri e hershme, që ka vepruar në fillim të shekullit XV. Shpërbërja (diftongimi) e zanoreve përputhet plotësisht me shtrirjen hapësinore të principatës së Kastriotëve (1370–1468), d.m.th. gegërishtja qendrore shtrihet brenda kufijve të principatës së Kastriotëve.

b) Zhbuzorëzimi i /y/–së në /i/. Fonema /y/ në të folmet e gegërishtes qendrore përgjithësisht zhbuzorëzohet në /i/: *dy* > *di*, *yll* > *ill*, *dry* > *dri* etj. dhe kur ka kushte të njëjta me /i/–në, diftongohet sipas tipit *sy* > *si* > *sâi* etj.

c) Edhe qiellzorëzimi i [g]–së në [gj] është dukuri fonetike mjaft e përhapur në gjithë arealin e gegërishtes qendrore. Në shumë të folme të gegërishtes qendrore në shumicën e fjalëve ku të folmet e tjera kanë fonemën prapagjuhore /g/, ato kanë fonemën qiellzore mbylltore /gj/, si në fjalët: *gjisht* ‘gisht’, *gjur* ‘gurë’, *gjo:j* ‘gojë’, *gjardh* ‘gardh’, *pagjuj* ‘paguaj’, *zagjar* ‘zagar’, *megjëll* ‘mjegull’, *magjar* ‘gomar’, *argjat* ‘argat’, *burgj*

‘burg’, *lu:gj* ‘lugë’, *pragj* ‘prag’, *degj* ‘degë’, *largj* ‘larg’, *frâigj* ‘frikë’ etj.

ç) Evoluimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] në izoglosën e gegërishtes qendrore dallon nga të folmet e tjera shqipe, meqë përgjithësisht në të folmet e tjera shqipe këto grupe ruhen si të tilla, ndërsa në gegërishten qendrore qiellzorëzohen (palatalizohen) në shkallë të ndryshme, deri në qiellzore të mirëfillta. Grupi [pl] është zhvilluar në [pj, pq, q]; sipas tipit *plak* > *pyak*, *pqak* > *qak*; *bl* > *ble:t*, *bgje:t*, *gje:t*; *flutur* > *fqutër* > *qutër* etj.



Pikat skajore e të folmeve veriore të gegërishtes qendrore në Maqedoni janë fshatrat e Kumanovës, ndërsa pikat jugore gjenden në Strugë. Disa fshatra në veri të Kumanovës i takojnë gegërishtes verilindore (kosovarishtes). Qyteti i Strugës i takon të folmeve kalimtare, ndërsa pjesa perëndimore e rrethit Strugës, Prespa, Manastiri i përkasin të folmeve të toskërishtes veriore, që ka tipare të njëjta e vijimësi tokësore me të folmet e tjera toske të Shqipërisë (Skrapar, Opar, Gorë, Pogradec, Korçë, Devoll, Myzeqe, Mallakastër, Vlorë, Mifol, Selenicë, Berat, Fier, Përmet, Kavajë, Tepelenë). Pra, degëzimi dialektor i shqipes nuk përputhet me kufijtë e sotëm shtetërorë, por dëshmon se historikisht kemi pasur e kemi vazhdimësi gjuhësore, etnike e territoriale.

Rrjedhimisht, faktet gjuhësore të shtrirjes dialektore të shqipes në Ballkan dëshmojnë se nuk ka pasur shpërngulje të mëdha shqiptarësh nga një zonë në tjetrën, as nga Shqipëria në Maqedoni, meqë nuk kemi përzierje gjuhësore, por izoglosa me unitet, me vijimësi, me vazhdimësi dialektore e kalueshmëri të shkallëshkallshme. Për hirë të së vërtetës, duhet pranuar se njerëzit e familjet kanë lëvizur gjithnjë e do të lëvizin përherë nga një vend në tjetrin brenda krahinës, por edhe jashtë saj, qoftë edhe brenda Ballkanit, Evropës e botës nga luftrat, dhuna apo për të kërkuar kushte më të mira jetese ose për arsye të tjera. Në këtë pikëpamje, janë të njohura botërisht lëvizjet fshat – qytet, zona më pak të zhvilluara drejt më të zhvilluarave etj. Në këtë kuptim, edhe te shqiptarët ka pasur lëvizje të pjesshme brenda territorit të ish–Jugosllavisë, brenda Ballkanit, Evropës e botës, por asnjëherë nuk ka pasur uzurpime terrioresh me dhunë (luftë) e as dyndje me prapavijë politike.

Fakti që të folmet shqipe të Maqedonisë kanë marrë pjesë drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të natyrshme në zhvillimin historik të strukturës dialektore të shqipes, është një provë tjetër e rëndësishme e vjetërsisë së popullsisë shqiptare të Maqedonisë në këto terriore. Kjo dëshmohet në monografitë dialektore për të folmet shqipe si dhe në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe (Atlasi I, II; Napoli, 2007, 2008).

Leksiku onomastik varet nga veçoritë e gjuhës konkrete dhe nga veçoritë e jetës vendore të popullatës, që lidhen me kulturën, me natyrën, me klimën, me kontaktet etj. Gadishulli ilirik (emër i lashtë i Ballkanit), kufizohet nga të tria anët me detra: me Adriatikun në perëndim, Mesdheun në jug dhe Detin e Zi në lindje. Në veri për kufi ka Danubin, por përfshin edhe tokat rumune. Këtu, në një truall relativisht të

vogël kanë jetuar dhe jetojnë popuj të ndryshëm. Të dhënat arkeologjike, historike, etnologjike, antropologjike dhe gjuhësore dëshmojnë se Ballkani ka qenë i banuar edhe para ardhjes së fiseve indoevropiane (si pellazgët në jug, që u shkri- në, por gjithsesi kanë lënë gjurmë). Popullimi i hershëm i këtij gadishulli është mundësuar edhe nga pozicioni i tij gjeografik si një urë ndërlidhëse midis Evropës dhe Azisë së Vogël. Kjo u ka dhënë shkas gjithashtu dyndjeve të herëpashershme të popujve dhe fiseve të ndryshme, që, edhe kur janë asimiluar nga banorët më të hershëm, apo edhe kur kanë qëndruar për një kohë në Ballkan, prapë kanë lënë gjurmë në kulturën materiale e shpirtërore në këtë gadishull, veçmas në onomastikë.

Aty nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë para erës së re, nga djepi i përbashkët indoevropian u dyndën valë-valë për në jug një popullsi e madhe. Kështu, në jug të Ballkanit kanë jetuar helenët (grekët), në qendër maqedonët e lashtë, në perëndim ilirët, në lindje trakasit (paraardhësit e rumunëve). Gjurmë kanë lënë edhe keltët me dyndjet e tyre në Ballkan (aty nga shek. III para erës sonë), gotët (vizigotët në shek. IV të erës sonë). U krijuan perandori të fuqishme që shtrinë ndikimin e tyre jo vetëm në Ballkan (fjalë turke me kuptimin ‘mal’), por edhe më gjerë nëpër Evropë e botë. Të tilla qenë perandoria Romake, Bizantine, Osmane etj.

Të dhënat historike tregojnë se që nga shekulli II para erës sonë, pas shumë luftërave të përgjakshme, Iliria u nënshtroi nga perandoria Romake (megjithëqë pati kryengritjeve të shpeshta). Në vitin 395 ajo u nda në dy pjesë: në perandorinë Romake të Perëndimit, me Romën kryeqytet dhe në perandorinë Lindore, e quajtur perandori Bizantine me qendër Konstandinopojën (Stambollin e sotëm). Pjesa më e madhe e provincave të atëhershme Ilire (Prevali, Dardania, Epiri i Ri

dhe Epiri i Vjetër) gati 10 shekuj (që nga shekulli IV deri në shek. XIV) ishin nën sundimin bizantin. Krishterimi hodhi rrënjë në viset e Ilirisë qysh në shekujt e parë të erës sonë, ndërsa ortodoksizmi u përhap në kohën e sundimit bizantin.

Nga shekulli VI–VII të erës sonë me ardhjen e sllavëve u ndryshua shumë pamja etnike e gjuhësore e Ballkanit, u asimiluan protobullgarët (fise trakase) në bullgarë si dhe një numër i madh banorësh të tjerë. Në shekujt IX–X (në kohën e car Simeonit e car Samuelit) mbretëria bullgare u shtri edhe në tokat shqiptare, ndonëse ato llogariteshin si provincë bizantine. Pas disfatës së fundit që pësuan forcat bullgare afër Beratit (më 1018), u rivendos pushteti bizantin në trevat shqiptare. Nga shek. XIV Ballkani merret nga osmanët dhe me këtë përhapet feja islame. Sundimi i tyre zgjati deri në gjysmën e parë të shek. XX.

Pas shpërbërjes së Perandorisë Turke, në Ballkan formohen shumë shtete, por një pjesë e madhe e popullatave të ndryshme mbeten jashtë kufijve shtetërorë kombëtarë. *Gjendja kaotike e konfliktit të të gjithëve kundër të gjithëve*, që mbretëroi një kohë të gjatë, do të vazhdojë edhe në luftërat Ballkanike, në ato Botërore e pastaj edhe në ato Jugosllave.

Këto gjërshetime civilizimesh të ndryshme: me fqinjësi shumë-sheskullore, me dyndje, me zhvendosje të brendshme popullsie, me luftra të përgjakshme, urrejtje e mostolerancë, me egoizëm e prirje për të shlyer gjurmët e ekzistimit të tjetrit, me asimilime popujsh; me mbizotërim herë të njërit e herë të tjetrit (shpeshherë edhe të atij që nuk banonte në Ballkan); me paganizëm, politeizëm e monoteizëm (me përhapje më të madhe të tri besimeve: krishterizmit, ortodoksizmit e islamizmit) dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë *pasqyrohen edhe sot në kulturën materiale e shpirtërore të popujve të Ballkanit; në*

gjuhët e tyre, sidomos në fushën e leksikut, duke përfshirë edhe emrat gjeografikë, emrat e njerëzve, të bimëve, të kafshëve, të sendeve, të objekteve etj. (Hamiti – Sopaj, 2004: 126–127).

Kjo histori e trazuar e Ballkanit, që karakterizohet me ndërrim të shpeshtë të pamjes etnike e fetare, me administrim në gjuhë të huaja etj., *pasqyrohet edhe në onomastikën e tij*. Rrjedhimisht, onomastika e Ballkanit është shumë e larmishme: aty gjejmë emra të përveçëm me etimologji ilire–shqiptare, trake, latine, greke, sllave, turke, vllehe e nga ndonjë gjuhë tjetër. Krahas këtyre, ka edhe emra me forma të ndryshuara gjatë shekujve, të përkthyer a të kalkuara, shpeshherë edhe të riemërtuara; emra me forma të përziera (hibride) nga dy e më tepër gjuhë etj.

Për shkak të tretjes apo të mosnjohjes së gjuhëve të vjetra (në mungesë të dokumenteve të shkruara, por me gjurmë onomastike), për shkak të dallimit të ligjësisë të përgjithshme gjuhësore me ato onomastike..., etimologjia e një sasi toponimesh e antroponimesh ballkanike deri më sot kanë mbetur e ndoshta edhe në të ardhmen do të mbeten të pazbërthyeshme e të pashpjegueshme.

Përzierjet etnike kudo në Ballkan janë rezultat i proceseve historike shumëshekullore. Shtetet e sotme Ballkanike janë të reja dhe etnikisht nuk janë homogjene. Historia e asnjërit prej popujve ballkanikë nuk mund të mbyllet në suaza të shteteve përkatëse. Me një histori ballkanike përplot ngjarje e kthesa, ku tani thuajse asnjë gurë më nuk mund ta gjesësh në vendin e vet, arsyetohet edhe laramania etimologjike e emrave të vendeve dhe të njerëzve në tërë truallin e Gadishullit Ballkanik. Nuk ka vend dhe popull në Ballkan që në fushën e onomastikës të mos ketë shtresëzime të llojllojshme civilizimesh të

ndryshme. Pikërisht në këto shtresa të krijuara nëpër mote shpeshherë thyhen shtizat edhe në qarqet shkencore, sepse qasjet e tyre janë të llojllojshme: disa pikëmbështetje për të arsyetuar tezat e veta kanë shtresën e re, disa atë të mesjetës e disa shtresën antike. Mirëpo, dihet se jo vetëm në trojet e ish Jugosllavisë ku ka shqiptarë, por edhe në truallin brenda kufijve të Shqipërisë, përveç toponimeve me etimologji shqipe, të cilat mbizotërojnë, gjejmë edhe emra me etimologji gjuhësh të ndryshme: latine, greke, sllave, turke, vllehe, ndonëse ndonjë edhe me prejardhje të pashpjegueshme deri më sot.

Toponimia në shumë vise të Gadishullit Ballkanik ruan deri më sot karakterin e vjetër ilir. Shqiptarët janë të vetmit që kanë ruajtur emrat ilirë, emrat e vendbanimeve, madje edhe emrat e njerëzve. Shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve. Përveç argumenteve historike, gjeografike, antropologjike etj., këtë e dëshmojnë edhe zbulimet arkeologjike dhe faktet gjuhësore, sepse emrat ilirë shpjegohen vetëm me anë të shqipes. Krahasimi i formave të lashta ilire të emrave të vendeve dhe të njerëzve me format përgjegjëse të shqipes së sotme, vërtetojnë se ato janë zhvilluar me rregullat e fonologjisë dhe të gramatikës historike të shqipes.

Analiza e fakteve të shumta të gjuhës shqipe, dëshmon se stërgjyshërit e shqiptarëve në lashtësi kanë qenë fqinjët veriorë dhe veri-perëndimorë të grekëve të vjetër dhe të nënshtruarit e hershëm të Perandorisë Romake. Si rrjedhim, mendimi i mbrojtur nga një varg dijetarësh që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve jugorë, gjen një mbështetje të fuqishme në dëshmitë e shumta të gjuhës shqipe, e cila është zhvilluar nëpërmjet evolucionit të një a disa diekteve, që fliteshin në lashtësi pikërisht në trevat e Ilirisë Jugore (Hamiti – Sopaj, 2004: 130).

Nëse vështrohet Gadishulli Ilirik (më vonë i riemërtuar në Gadishull Ballkanik) në dritën e toponimisë, do të vërehet se shumë emra vendesh u takojnë disa periudhave kohore: antikës, mesjetës dhe kohës së re; përkastësisht disa shtresimeve etno-kulturore dhe gjuhësore (paraindoevropiane, indoevropiane, ilire, protoshqiptare e shqiptare, latine, romane e vlllehe, greke, sllave, turke etj.

Pushtuesit kanë lënë pra gjurmët e tyre edhe në emrat e vendeve, që, sado u përpoqën t'i eliminonjë gjurmët e tyre edhe emrat e vendeve iliro-shqiptarë, ato nuk u zhdukën krejtësisht. Sot, ndjehet nevoja e mbledhjes, regjistrimit, studimit dhe e standardizimit të toponimisë shqiptare, përfshirë edhe toponiminë e Maqedonisë. Për këtë punë të ngutshme interdisiplinare duhet një bashkërendim i onomasiologëve, dialektologëve, standardologëve, gjeografëve, historianëve dhe i arkeologëve (Sejdiu, 2002: 112–113).

Nga monografitë përshkruese për të folmet shqipe në Maqedoni si dhe nga studimet për toponiminë e mikrotoponiminë e Maqedonisë mund të nxirret një konstatim i përgjithshëm se: Maqedonia mbushullon me emërvende shqipe, krahas me ato të burimit të huaj: pellazgjik, latin, grek, turk, sllav etj.

Sipas analizës së bërë në *Mikrotoponiminë e Karshiakës së Shkupit* në vendbanimet me popullsi shqiptare numri më i madh i mikrotoponimeve është i gurrës shqipe, ndërsa në ato të banuara me popullsi maqedonase i asaj sllave (Idrizi, 2003: 14).

Numri më i madh i emërvendeve në Pollogun e Epërm të Gostivarit, sipas kolegut Izmit Durmishi, është me origjinë shqipe, por nuk mungojnë edhe ato me etimologji sllave, turke dhe gjuhësh të tjera (Durmishi, 2008: 53).

Autoktonia e shqiptarëve në trojet e Maqedonisë dëshmohet edhe më bindshëm me mikrotoponimi. Fjala vjen, nga 100

mikrotoponime të fshatit Goshincë të Kumanovës, mbi 90 sosh kanë etimologji shqipe... Edhe në vendbanimet shqiptare të Karadakut të Shkupit mbizotërojnë mikrotoponimet me burim nga gjuha shqipe. Tipike janë emërtimet: *Gjuri Zi, Kepi Shipës, Kepi Selvajës, Kepi Bollës, Kepi Madh, Kepi Dullës, Kepi n'Dushk, Kepi Borës, Kepi Kuç, Shpella Arashës, Kodra Holl, Kodra Furrës, Livadhi Madh, Livadhi n'Lak, Livadhi Isenit, Ara Madhe, Ara n'Prrae, Ara n'Kodër, Mali Ashit, Mali Shpesh, Kroi Bardh, Kroi Ftoft, Kroi Mullajnit, Lisi n'Kodër, Kama Dragoit* etj. (Hamiti, 2011).

Edhe mikrotoponimia e vendbanimeve shqiptare në zonën e Prilepit, të Krushevës dhe të Velesit, sipas kolegut Mustafa Ibrahimit na del kryesisht me etimologji shqipe: nga 2057 njësi toponomastike (oronime, hidronime si dhe emra të tjerë vendesh të vogla) 1308 janë shqipe (63.6%), 382 (18.5%) sllave, 297 (4.4%) turke, 25 (1.2%) greke, 8 (0.4%) arumune, 12 fjalë latine (0.6%) dhe 23 (2.8%) topoleksema me etimologji gjuhësh të tjera (Ibrahimit, 2010: 230).

Në Fjalorin toponomastik të tërthoreve shqiptare të Maqedonisë, dr. Qemal Murati me të drejtë konstaton se: toponomastika – emrat gjeografikë të vendeve, është quajtur me të drejtë “gjuha e tokës”, arkeologji pa lopatë dhe arkiv i vërtetë historie (Murati, 2008: 5). Toponomastika shqiptare përbën mbase dokumentin më kryesor që vërteton autoktonitetin e popullit shqiptar në vendbanimin e tij të sotëm, d.m.th. faktin që shqiptarët janë vendës në këto anë që nga kohët më të lashta të historisë, pa ndërprerje (Çabej: 1975, V). Lënda e pasur e tërthoreve shqiptare të Maqedonisë me 4.200 topoleksema na dëshmon se shqiptarët në Maqedoni nuk janë të djeshëm – sikundër janë përpjekur t'i paraqesin kështu onomasticientët maqedonas, sepse vetë emërtesa toponomastike

ata i gjen në këtë anë shumë kohë para ardhjes së sllavëve (Murati, 2008: 6).

Secila gjuhë në botë ka tiparet e saja dhe gjatë zhvillimit historik krijojnë sistem të mëvetësishëm dhe të dallueshëm nga gjuhët e tjera. Edhe në fushën e onomastikës, gjuha shqipe si çdo gjuhë tjetër në botë ka rregullat e saja gjuhësore, të cilat nuk mund të ndryshohen e të bastardohen. Emrat e vendeve paraqesin një sistem më vete, si mikrosistem që përfshihen në një sistem më të madh – makrosistem. Çdo çrregullim i mikrosistemit gjuhësor ndikon edhe në çrregullimin e makrosistemit.

Në gjuhë të ndryshme toponimet mund të kenë emërtime të ndryshme. Kjo dukuri, ekziston në çdo gjuhë dhe nuk duhet të kemi paragjykime, por duhet pranuar si çështje gjuhësore pa i dhënë konotacion politik. Toponimet nuk pranojnë formë të dhunshme e të imponuara administrative.

Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane dhe formon një grup më vete pasi që për nga veçoritë gjuhësore ka karakteristikat e saja dhe nuk përkon me gjuhët e tjera, sidomos në sistemin emëror.

Të gjithë emrat në gjuhën shqipe, pa përjashtim, kanë dy trajta: trajtën e shquar dhe trajtën e pashquar. Kjo domethënë se edhe emrat e vendbanimeve, varësisht nga situata, përdoren në trajtë të shquar ose në atë të pashquar, gjë që e dallon nga gjuhët e tjera, përfshirë këtu edhe maqedonishten.

Emrat në trajtën e shquar marrin mbaresa, si bie fjala –**i** ose –**u** për gjininë mashkullore, dhe –**a** ose –**ja** për gjininë femërore. Gjithashtu emrat në gjuhën shqipe kanë sistem rasor, pra lakohen nëpër pesë rasat dhe duke u lakuar, ata marrin edhe mbaresat rasore. E gjithë kjo ka të bëjë edhe me toponimet të cilat me shekuj janë përdorur dhe iu kanë përshtatur sistemit

gramatikor të shqipes. Të marrim një shembull: *Tetova* në gjuhën maqedonase quhet *Tetovo*, shikuar nga sistemi gramatikor i shqipes kjo do të ishte rasa emërore (nominativ). Sipas sistemit rasor të shqipes, ky emër është i gjinisë femërore në trajtën e pashquar që mbarojnë me –o. Këta emra në trajtën e shquar, në rasën emërore marrin mbaresën –ja. Pra do të kishim forma të panatyrshme *Tetovo* – *Tetovoja*. Në rasën gjinore do të ishte *i, e Tetovosë*, në dhanore *Tetovosë*, kallëzore – *Tetovonë* dhe në rrjedhore *prej Tetovosë*; në vend se në formën e shqipes që është *Tetovë* – *Tetova; i, e, Tetovës; Tetovës; Tetovën*, dhe *prej Tetovës*. Ose të marrim një shembull tjetër: *Shkupi* në maqedonisht quhet *Skopje*, dhe sipas grupimit të emrave ky emër në shqip është në gjininë mashkullore, ndërsa në maqedonisht në gjininë femërore që në trajtën e shquar marrin mbaresën –ja dhe njëkohësisht bie zanorja –e fundore: *Skopja; i, e Skopjes; Skopjes; Skopjen; prej Skopjes* (në vend të *Shkup, Shkupi; i, e Shkupit, Shkupit, Shkupin, prej Shkupit*).

Pasi që emri kur ka funksionin e kryefjalës është edhe bartës i fjalisë, çdo fjalë tjetër i përshtatet në gjini, numër dhe rasë, çdo kalim prej një gjinie në tjetrën shkakton edhe çrregullime brenda në fjali dhe e dëmton sistemin e brendshëm dhe strukturën e fjalisë. Kjo njëkohësisht ndikon edhe në ndërimin e vendit të theksit në fjalë, e vështirëson shqiptimin e fjalës dhe e humb bukurinë e të shprehurit.

Gjuha shqipe është gjuhë e standardizuar tani më me një traditë 550 vjeçare shkrimi, me një alfabet të njësuar para më shumë se 100 vjetësh, dhe si e tillë përdoret jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe në Maqedoni, në Serbi, Mal të Zi dhe në të gjitha vendet e botës. Çdo cenim i sistemit të saj, shkakton jo vetëm çrregullim strukturor, por vështirëson e

pamundëson kuptueshmërinë ndërmjet pjesëtarëve të një populli. Dihet se para së gjithash gjuha është mjet komunikimi dhe me të duhet të merren vesh njerëzit. Dua të them se nëse bëjmë shkelje të rregullave gjuhësore, domosdo do të vijmë në situatë që shqiptarët të mos mund të kuptohen mes vete. Pra gjuha standarde shqipe është një, si për shqiptarët e Maqedonisë, ashtu edhe për ata të Shqipërisë, të Kosovës etj. dhe për gjithë shqipfolësit.

Nga ana tjetër, kjo nuk ka të bëjë vetëm me gjuhën shqipe. Dukuria e përdorimit të emrave të ndryshëm për vendbanimet e njëjta ekziston në të gjitha gjuhët, po edhe në maqedonisht, p.sh.: *Белград* në vend të formës në serbisht *Beograd*, *Солун* në vend të formës greke *Thesaloniki*, *Скадар* në vend të formës shqipe *Shkodër*, *Драч* (Durrës), *Австрија* (Austria), *Валона* (Vlorë), *Грција* (Hellada), *Данска* (Denmark), *Ерусалим* (Jerusalem), *Ирска* (Irland), *Лерин* (Florina), *Норвешка* (Norvege), *Полска* (Poloni), *Рим* (Roma), *Финска* (Finland), *Шведска* (Suedi), *Швајцарија* (Suisse, Svicerland, shq. Zvicër), *Шкотска* (Skotland), *Шпанија* (Espanja) etj. Ose, bie fjala, pse nuk pengon kur turqit thonë *Yskyp* në vend të *Skopje*, *Манастир* në vend të *Bitolla*, *Хинглиз* për *Англи*, *Јунанистан* për *Греци*; serbët: *Скопље* në vend të *Skopje*, *Нјемацка* për *Gjermani*, *Низоземска* për *Holandë*. Pse nuk zemërohen gjermanët kur francezët shtetin e tyre e quajnë *Allemagne*, anglezët – *Germany*, e ata vetë e quajnë *Deutchland*. Holanda quhet *Nederland*, *Pays-Bas*, *Nizozemska* etj.

Një kohë të gjatë në qarqet maqedonase flitej rreth "unifikimit" të emrave gjeografikë në Maqedoni ku me shekuj jetojnë shqiptarët. Por, dihet se unifikimi a standardizimi bëhet vetëm në kaudrin e një gjuhe dhe kurrësi nuk mund të dalë jashtë caqeve të asaj dhe të cënojë gjuhët e tjera, përkatësisht

t'ua imponojë normat e veta. Pra, çështja e unifikimit apo e zëvendësimit të toponimeve shqipe e të tjera me ato maqedone është joshkencore, jopraktike, e papranueshme e me prapavijë politike. Shqipja, si çdo gjuhë tjetër e botës, ka sistemin e saj fonetik, gramatikor dhe leksikor. Prandaj, çdo prekje dhe çdo intervenim i jashtëm dhe i dhunshëm në cilindo rrafsh, lëndon gjuhën, e cila siç do të thoshte Sosyri "është sistem që njeh vetëm rendin e vet" (Sejdiu, 2002: 112–113).

Çdo ndërmarrje për eliminimin e trajtave të njëres a të tjetres gjuhë, thotë prof. Shefki Sejdiu, në veprën *Sprova etimologjike*, Prishtinë, 2002, f. 115, s'mund të quhej ndryshe pos padrejtësi dhe diskriminim ndaj asaj gjuhe që këto toponime i solli deri në format e tashme, duke i ruajtur nga stuhitë që i sillnin kohërat mbi qiellin e këtyre viseve shekuj me radhë. .. Andaj, në përputhje me ligjet e secilës gjuhë dhe normave humane të çdo shoqërie të civilizuar, përdorimi paralel i toponimeve shqipe (nga albanofonët), maqedone (nga maqedonofonët) dhe atyre turke (nga turkofonët) nuk paraqesin as pengesë as vështirësi në komunikim, përkundrazi është begati dhe dëshmi e jetës së përbashkët shekullore të këtyre popujve në këto troje. Ky paralelizëm duhet të vazhdojë dhe nuk duhet prekur në asnjërin rrafsh të asnjërës gjuhë, duke e lënë këtë paralelizëm të gjallërojë natyrshëm, ashtu sikundër që vepron bota e civilizuar dhe gjuhësisht e njerëzisht e ngritur (Sejdiu, 2002: 115).

Njeriu duhet të jetë i kthyer nga e ardhmja e me shpinë nga e kaluara. Pra, e kaluara në funksion të së tashmes. Historinë duhet lënë historianëve, onomastikën gjuhëtarëve. Detyrë e shkencës është të zbulojë, të argumentojë e të thotë të vërtetën për shoqërinë e botën që na rrethon, qoftë ajo e vërtetë e hidhur apo e këndshme. Ajo duhet thënë vetëm të vërtetën,

nuk duhet të jetë nën ndikimin e politikës ditore. Rrjedhimisht, jo pak shqiptarë bashkë me maqedonasit dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera bashkëjetojnë me shokuj dhe janë banorë e shtetas të Maqedonisë. E drejtë e çdo kombi është t'i emërtojë gjërat, përfshirë edhe emrat gjeografikë, sipas natyrës së gjuhës së tij. Gjithë veprimtarinë tonë duhet mbështetur në frymën e respektimit të ndërsjellë të veçorive e të dallimeve kulturore, gjuhësore, fetare të tjetrit, të tolerancës, të mirëkuptimit, e përgjithësisht të orientimit tonë për një të ardhme të lumtur. Të mos jemi pre e urrejtjes, mohimit, egoizmit, miteve, stereotipeve, paragjyqimeve etj., por të punojmë për Evropë të bashkuar dhe të përgatitur për të mbijetuar në një botë të globalizuar.

Bibliografia:

Atlasi *dialektologjik i gjuhës shqipe I, II* (2007, 2008), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Vëllimi I, II; Napoli.

Baliu, Begzad (2008), *Onomastika e Kosovës* (ndërmjet miteve dhe identiteteve), Prishtinë.

Beci, Bahri (2013), *Shqiptarët e Maqedonisë, më të hershëm se sllavët*, www.Pashtriku.org, 20.04.2013.

Çabej, dr. Eqrem (1976), *Studime gjuhësore III*, Prishtinë.

Çabej, dr. Eqrem (1975), *Studime gjuhësore V*, Prishtinë.

Durmishi, Izmit (2008), *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar.

Doçi, dr. Rexhep (1990), *Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I*, Prishtinë.

Frashëri, Kristo (2009), *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit*, gazeta "Shqip", 9–10. 12. 2009.

Hamiti, Asllan (2011), *Mikrotoponimet dhe antroponimet e fshatit Goshincë*, Instituti Alb–Shkenca, Takimi VI Vjetor Ndërkombëtar, Prishtinë, 1 – 4 shtator 2011.

Hamiti, Asllan (2007), *Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe planifikimi gjuhësor*, Konferenca e parë Albanologjike, Ohër, 23–27 shtator 2007, f. 339 – 346..

Hamiti – Sopaj (2004), *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV* të gjimnazit të reformuar, Prosvetno Dello, Shkup.

Институт за македонски јазик “Крсте Мисирков” – Скопје (2004), Јазикот наш денешен – книга 11, *Стандардизацијата на географските имиња во Република Македонија*, Зборник на трудови од трибината одржана на 30 септември 2004 година, Скопје.

Ibrahimi, Mustafa (2010), *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit*, Krushevës dhe Velesit, Intelingua, Shkup.

Idrizi, Xhemaludin (2003), *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup.

Ismaili, Mustafa (1998), *Goshinca e Kumanovës*, Shkup.

Murati, Qemal (1996), *Kërçova në traditat e saj të vjetra*, Shkup, 1996.

Murati, dr. Qemal (2008), *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Tetovë.

Selmani, Asllan (2000), *Gjeografia e Maqedonisë antike*, Kumanovë, 2000.

Sejdiu, Shefki (2002), *Sprova etimologjike*, Prishtinë.

Sulejmani, Fadil (1979), *Toponimia e Malësisë së Tetovës*, në *Onomastika e Kosovës*, Prishtinë.

Shkurtaj, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë.

Ymeri, Haki (1997), *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup.

IZMIT DURMISHI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

Universiteti Shtetëror i Tetovës

VËSHTRIME FONETIKE MBI TOPONIMINË E POLLOGUT TË EPËRM

Hyrje

Pollogu sikurse edhe viset e tjera të Maqedonisë të banuara me shqiptarë, vërtetohen historikisht falë zbulimeve e gjetjeve arkeologjike. Kërkinet gjuhësore për onomastikën e kësaj ane janë mjaft të rëndësishme, mbasi me anë të toponimeve vërtetohet jo vetëm lashtësia e shqipes, por edhe etniteti dhe vazhdimësia e popullit tonë. Dëshmitë flasin qartë se këto troje, kanë qenë qysh herët të banuara me shqiptarë, më vonë të sunduara nga sundues të ndryshëm : sundimi bizantin, mbretëria bullgare, sërbe, e perandoria osmane. Përgjithësisht, onomastika e Pollogut dëshmon bindshëm për autoktoninë e shqiptarëve në këto troje dhe për një vazhdimësi iliro-shqiptare, krahas popujve të përkatësive të tjera.

Në këtë punim po trajtojmë disa elemente fonetike që mund të llogariten si elemente të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës në përgjithësi, e të onomastikonit të kësaj ane në veçanti.

A. Sistemi zanor

Në toponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit pasqyrohen veçoritë e sistemit gjuhësor të këtij rajoni, pasi toponimet, në radhë të parë, janë formime dialektore që në vete ruajnë trajtat më të vjetra të gjuhës së folur.

Në toponimininë e kësaj ane kemi kryesisht këto fonema zanore: **a, o, u, e, i**, kurse shumë rrallë hasen të përdorura edhe zanoret **y** dhe **ë**.

Zanoret e theksuara në onomastikën e kësaj ane paraqiten si në shumicën e të folmeve të gegërishtes, d.m.th.: të shkurtra, të mesme dhe të gjata.

Zanore të shkurta ndeshim kryesisht te toponimet njërrrokëshe që mbarojnë me bashkëtingëllore, si : Ke Ujt (Gj.P.), Te Gurt e Zi (Si), Guri i Xholl (Gr) Ftohsene Shkaut, Livadhi Tem (Ka)etj.

Në shembujt e sipërpërmendur vërejm një dukuri mjaft karakteristike: zanoret e theksuara të gjymtyrës së fundit janë të shkurta, ndonëse kur kemi grup zanorësh, zanorja e parë del me gjatësi të mesme: Ftohsene Shka.ut.

Zanore të mesme ndeshim te një numër toponimesh e patronimesh të këtij rrethi, ashtu si në mbarë shqipen, (shih edhe M.Çeliku)¹ që mbarojnë me rrokje të hapur jofundore: Ça.fa- (T.M.),

Çu.kat(Lla, St, Re, De), Ça.rrri Beqir Gurës (Së), Ço.ka(St)Ke Za.lli (De) Ke Li.si (De), Gropa e Ma.dhe (Ko), Ferrat e Tha.ta (Çe), Ke Ke.pi (Ra), Ra.pe (Lla) etj.

Zanore të gjata hasim në toponimet e këtushme kur kemi rënie të një tingulli fundor, si: Ara e Alis (Pa, Or), Faqja e Xha:n (Së), Ferri Tra.sh (Si), Ke Grope Lajthis (Ra); Ke Guri Kallanxhis (Re), Lisi Rrall, Livadhi Ilmis (Or), Ligjate Kadrin (Or), Lugi Musli:s (Or), Ligjate Avdi:s (Or), Livadhet e Mdho:ja (Fo), Maja e Kori:s (Ko), Rasa e Lar (Së), Stani Salis (Ko), Shullani Madh (Çe), Shpelle Fasli:s (J.P), Zabeli Pre:m (St), Udhe Holl (Ne, Gr).

¹ Mehmet Çeliku, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes*, St..fil., nr.4, Tiranë, 1971, f.65

1. Zanozja a

Në toponiminë dhe antroponiminë e kësaj ane **a-ja** është ruajtur mirë, sidomos në pozicionin nistor, p.sh.te toponimet: Ara Hazirit, Ara Kadris, Ara Kaloshit, Ara Shabanit (Or), Ahishtat(Si), Arat e Azizit (Ba), Ara e Ali Tushës (Së), Ara e Madhe (Ko, Or), Arat e Brenjovës (Së), Arat e Balle (Së), Ara e Metës (Të, Çe), Agaçet (Ba, Pa, Gju), Ahu Madh (Fo, Si), etj., ose te patronimet:Ahmete (Çe), Avdie, Aligega(Lla); Ali-Marke (Së), Ali-Vishe (Të), Atabejlerë (B.E.), Agallarë (B.P), Alhidre (Si), Abaz -allarë (Or), Alisinëne (Do).

Zanozja **a**, shpeshherë ruhet edhe në pozita të ndryshme fonetike: Arat e Gjata (Çe, Ça, Tu, Ra, Be, BP, Sa), Arat e Hajdaragës (Ça), Arat e Haxhiut, Balte KuÇe (Çe), Bunari Qelbët (Ko), Bataki (Or), Braneca (Ra), Livadhet e Ramës (Ça), Kodra e Kazanit, Kodra e Çafkarnekut (Ko), Te Furkat (Si), Udha e Pamporit (Gj.P.), Te Bunari (Gr), ose te patronimet: Bake, Dane, Hane, Sallake, Zhupane (Çe), Matjane (FoT.V), Bardhe (Ko), Metallarë (Ba), Dibran (T.V.), Ukallarë, Tafollarë, Halilallarë (Së, Pa), Bajramet (Të, B.E.), Halime, Salvishe (St), Kasamallarë, Kamberallarë, Shabanallarë (B.E.) etj. Në disa toponime të rajonit në fjalë zanozja **a** e theksuar kalon në **ë**-të theksuar si p.sh.Arat e Çegrënit (Do), Çafe Çegrënit (Çe), Udhe Çegrënit (To), te disa emërtime të tjera zanozja **a** në toponimet e kësaj ane ka kaluar në **i** ose **e**, si p.sh. Lithija e Jovanit, Lithija e Selës (Or), Letheja (Çe, Fo), ndërkaq disa herë **a>o** Moni (De). Ekzistojnë raste kur zanoren **a** e takojmë të këmbyer në **i**, përmes **ë-së**, si te: Ligjata (Të), Ligjate Sulës, Ligjate Avdis, Ligjate Hazirit (Or) etj.(nga **lëgatë<lagatë**).

2. Zanoŕja e

Në toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm, si dhe në të folmen e saj, zanoŕja e nuk pëson ndërrime të rëndësishme dhe mund ta takosh në të gjitha pozicionet, si te toponimet: Çeshme Selmanit (Vr), Çafë Çegrënit (Çe), Derven (Ko, Si), Ke Jemeni, (Çe), Mereshnica (Pa), Segrade (Zd, Ra), Dalishte (Re), Ferre Madhe (De), Ke Are Shehipit (Or), Llaçet e Ahmete (Ça, Së, Lla), Trebeneçe (Çe), Elbor (St), ose te patronimet: Reçet (Ra, Ko), Ahmete, Kete(Ça), Gude, Ceke, Metallarë (Ba), Matjane (Fo, T.V.), Ballejse (Çe, St), Cehane (Si), Spahie, Çelike (Vr), Elmazallarë, Emollarë (Go), Hase (Gr), Reçet (Ka), Bulke (Lla), Çançe (To), Izerallarë, Muçlerë (Re) etj.

Megjithatë ka raste kur kjo zanore te toponimi me prejardhje sllave, kur është e theksuar kalon në **a**, p.sh.Ballavod (Or), Palavaja (Ka), si dhe në pozicion nistor kalon në **i** te mbiemri, p.sh.Dushku Iminit (Çe).

3. Zanoŕja ë

Në onomastikonin e Pollogut të Epërm të Gostivarit, sikurse edhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, zanoŕja ë pothuajse ka rënë në të gjitha pozicionet . Procesi i rënies së **ë-së** pa marrë parasysh se në ç'pjesë të ligjëratës ose në ç'formë gramatikore është pasqyruar edhe në toponomastikonin e kësaj ane, si tek emërtimet: Ara n'Gryk e Qahilit (Or), Çarri n'Zall (Si), Dardha n'Zall, Faqja e Prroit Keç, Gurra n'Zabel (Së), Livadh t'Nezirit (Gju), Krroi n'Rina, n'Ograde (Gj.P.), N'Kep t'Gurit Shkrepit (Si), N'Kodër t'Ahut Madh (Si) etj.

Po kështu te fjalët me rrokje të hapur si: Gurt e Shkul, Guri Krroit Ftoht (Çe, Të), Kshtijat e Merollarve (Do), Livadhet e

Mdhoja (Fo), Kshteje Katundit (Re), Ke Ujt (Gj.P.), N'Gara Kolib (Ko), N'Shkamb t'Vogël (Si), Rruga e Lope (Ra, Sa), Udh t'Hanit (Sa) etj.

4. *Zanorja i*

Në onomastikonin e Pollogut të Epërm, si dhe në shumë toponime e patronime të tjera të shqipes, kjo zanore ruhet e pastër në fillim, mes dhe fund të fjalës. Kjo më së miri vërehet në shembujt: Liniçi (Çe), Livadhi Ibrahimit (Ko), Peklishta (Të), Pili (Re), Amanishte (Ka), Bunari Axhës Mazllam (Çe), Çafkarniku Derdhun (Ko), Falisht (Çe), Fidanishte (Gr), Fjerrishta (Së, Lla, Re), Kodre Lisit (Ka), Zalli (Pa, Së), Izvori (Çe, T.V.). Ilbore, Mullini Korbit (Të), Mullini Patalishtit (Pa), Linguci Madh, Linguci Vogël (Vru), Mullajni Belulit (Do), pastaj te patronimet: Like, Dani, Pire, SelishtëHoti (Çe), Kacipula (Ko), Hasipallar, Zeqire (B.P.), Mehmedi (B.P.), Dibran, Rekali (T.V.), Kite (Së), Aligega (Lla), Ali-marke, Halilallar (Pa), Izerallar, Musliallar, Nezirallar (Gj.P.), Çitakë, Fida (De, Çe), Budinllar (Vr), Alisinëne, Bakiallar(Do), Kalisa, Iljaz Agat(Gr), Musliallar (Zd), Izerallar (Re), Brahimallar, Aliallar (J.P.).

5. *Zanorja o*

Zanoren o e gjejmë të shqiptohet mirë në emërtimet e vendeve dhe fiseve të fshatrave të kësaj rrethine. Pozicioni i saj është i ndryshëm, si psh. Ballsori (Çe), Bunari Ftohtë (Ko), Copat e Shehipit (Or), Ftosena (Fo, Lla, Së, Pa), Guri Cocës (T.M.), Groshare, Golina (Si), Haxhi Koliba (Zd), Kodra Nunit (Or), Ke Omori (De, Vr, Ko), Kollçak (T.V.), Kodra e Toke, Kupshore, Koloba (Së), Polca (Ko), Potoçan (Sa), Sa-

makov (Së, Gj.P.), Skoki (Do), Sokolec (Ka), Shpo (Së), Ujti Prroit (Do), Udhe Hollë (Ne, Gr)..., si dhe te patronimet: Loke (Çe, Fo), Hoti, Çorokane, Hoxha (Çe), Kolovere (Çe, St.) Hoxhollar (Çe, Ba), Kodra, Osmanallar (Si), Toskallarë (De), Gegollarë (Vr), Demollarë, Hasollarë (Ne), Ofat, Loçet, Kokallarët (Gr), Cakollarë (Sa) etj.

Është për t'u përmendur edhe rasti që ndonjëherë **o-ja** e theksuar ka kaluar edhe në **a**. Këtë e ndeshim te toponimet: **Arnica** e Rexhës (Ko), si edhe te fjalët: dallap, kallamoç etj., në të folmet e kësaj ane, siç përmend ngjashëm edhe Bahri Beci² për toponimet në krahinën e Mirditës.

6. Zanozja u

Sa i takon zanores **u** mund të thuhet se ajo shqiptohet e plotë dhe ruhet në pozicione të ndryshme në onomastikonin e rajonit në fjalë. Kjo më së miri vërehet te shembujt: Bunari Begut (Fo), Bunari Xhemës (Ko), Buneci (T.V.), Buazi (Së), Dunajshite (Çe, Fo), Dushku Iminut, Dushku Shabanit (Çe), Duhani Kobriçës (Fo), Fusha (Ko), Lugu i Veliut (Së), Udha Dufit (Or), Udhe Madje (To), Udhe Bojanave (Ne), Mullini Karajve, Mullenit Alushit, Mullenit Lehoneve (Si), Druni Vetëm (Ba), Dullenga (T.V.Të), Kuçibaba, Kuçla (Ka), ose te patronimet: Muje(Çe), Feruke(Fo), Ukshotina (Çe), Murate (B.E.), Tushet(Të, T.M.), Ukallarë(Së), Shule (Lla), Kurte (De, Gju), Nushat (Gr), Rusë (To) etj.

Te toponimet e tipit: Livadhet e Mdhosja (Fo), Hordha Eminut, Guri Hotës(Si), Guri Aroshës (T.M.), Foshe Poshtme (Çe, Vru), zanozja **u** e theksuar kalon në **o**.

² B. Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia shqiptare" IV, Tiranë, 1982, f.49

Zanorja **u**–e theksuar në kushte të volitshme diftongimi në lokalitete ku ajo diftongohet del kryesisht në **au**, ose edhe **–i** në toponiminë e kësaj ane, si psh. Taumat (Gr), Ara Isaufit, Grade Hautës (Ne, Gr), Are Alis, Bunari Havzis (Ko), Guri Ukit (Gju), Arat e Begit (Sa), Arat e Sllogit (Do) etj.

7. Zanorja *y*

Zanorja **y** në toponiminë e antroponiminë e kësaj ane pothuajse nuk ekziston në sistemin e fonemave të këtij areali gjuhësor, sepse ajo shqiptohet më tepër si **i**. Për një dukuri të tillë fliste edhe Idriz Ajeti³. Kështu, me **y(i)** të delabializuar paraqiten toponimet: Gjibret e Qeve (Fo), Vathe Imerit (Ba), Mullenit Zilit (Re), M'Budh Kriç (Gr), Ara N'Grik e Qahilit (Or). **Y–ja** mund të haset e përdorur rrallë, sa për ilustrim po përmendim: Gjybra Shabanit, Gjybra e Lopve (Ko).

Prof. Bahri Beci⁴ shpjegonte se **y–në** të shqiptuar si **i** e ndeshim edhe në Milot, në juglindje të Lezhës, në perëndim e veri të Mirditës, në Lumë, në Dibër, në krahinat perëndimore të Maqedonisë dhe në Mat.

Hundorësia e zanoreve

Në toponiminë dhe antroponiminë e kësaj ane hundorësia e zanoreve është dukuri e theksuar.

Zanorja **a** hundorësinë e ruan te toponimet e patronime e tipit: Ana e Shullanit (Së), Ara Selamit (Or), Are Ganës (Or), Arat e Shullanit (Lla), Bunarët e Cile (Çe), Faqja e Xhana (Së), Lame Demire(Së), Lumnaje (Re), Lama e Zaimallarëve

³ Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, f.188

⁴ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, “Dialektologjia shqiptare” V, Tiranë, 1987, f.22

(Re), Livadhet e Mullajnkave (Do), Livadhi Madh (Pa), Livadhet Pjaka (Ne), Maja e Lamzave (Të), Potoçan (Sa), Rranishta (Si), Rrai Met Kitës (Së), Rrana (Lla), Rramnishte (Vr, J.P.) etj., si dhe te patronimet: Matjane (Fo, T.V.) Manjane (Fo), Dibran (T.V), Zhupan (Çe), Hane (Çe), Bojdane (De), Topojan (Llo), etj.

Zanorja **i** dhe **u**, edhe në onomastikën si në të folmen e kësaj ane dalin në disa raste ja si hundore:

Kroi Linit (Së), Kroi N'Rina (Së), Brinja (Ra, Të, St), Druni Vetëm (Ba), Gurt e Shkul (Çe), Mullini Kornti (Të) etj., si dhe te patronimet: Kalishte (Ça), Mune (De), Budin (Llo), Nushat, Bajrushkat (Gr) etj.

Diftongje e grupe zanoresh

Diftongjet e grupet e zanoreve i ndeshim në pak raste, kryesisht në toponimi. Grupet e zanoreve në toponiminë e Pollogut të Epërm, janë monoftongizuar, ose janë kthyer në grupe zanoresh, siç do të shihet më poshtë.

Togu zanor **-ie**, siç do të shprehet edhe Haki Ymeri⁵ monoftongohet në **ej** dhe **je** si psh. në toponimet: Fejri Poshtëm (Së), Fejri Trashë (Si), Fejre Keçe (Ka), Fejri (Gr), Fjerrishta (Lla, Së, Re). Diftongu **-ie** monoftongohet në **-e** në toponimin Vorret e Shkeve (Çe), pastaj edhe **ye > e**, te toponimi Vneshtat e Krenjallarëve (Ra), **kre (kry < krye)**

Në toponiminë e kësaj ane, sidomos në të folmen e fshatrave: Dobërdoll, Sanakos, Gradec, Negotinë etj., vërehet shumë diftongizimi i zanoreve **i > aj** si psh. Mullajni Ademit, Mullajni Belulit (Do), pastaj diftongizimi i **u > au** si te toponimi Taumat (Gr).

⁵ Haki Ymeri, *E folnja shqipe e Karshiakës*, tezë doktorati, Tiranë, 1994, f.80

Grupi i zanoreve **ue** ruhet në toponimet e tipit: Gropa Si Mban **Uej** (Ko).

B. Sistemi bashkëtingëllor

Sistemi bashkëtingëllor i të folmes së Pollogut të Epërm, marrë në tërësi, nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga sistemi bashkëtingëllor i të folmeve të gegërishtes qendrore dhe ai i gjuhës letrare.

Në emërtimet e këtij rajoni disa fonema bashkëtingëllore pësojnë ndryshime të dukshme. Kemi rënie, reduktim ose shtim të bashkëtingëlloreve në disa raste e kushte të caktuara.

Bashkëtingëllorja okluzive e zëshme **g** në disa toponime alternohet me mesgjuhoren mbylltore **gj**, si psh. Ligjatë, Ligjata Sulës (Të), Gjuri Kuç (Or), Ligjata Kadrisë, Ligjate Hazirit, Ligjate Avdis, Ligjate Tanashit (Or).

Bashkëtingëllorja faringale **h** në pozita të ndryshme të disa toponimeve e antroponimeve bie tërësisht, si psh. Are Amzës (B.P.), Ke Raj Azirit, Te Kosharje Saliut, Te Hisje Fariut (Si), Copat e Tairit, Udhë ka Shpati Ajdinit (Or).

Faringalja **h>f** te toponimet: Kodra e Afinate (St), Kroj Afinedit (Pa)etj.

Bashkëtingëllorja **h**—në toponomastikonin e kësaj treve ruhet dhe shqiptohet qartë, si në fillim, në mes, ashtu edhe në fund të fjalëve, qofshin ato me etimologji shqipe a të huaj; si psh.

a) në pozicion nistor— te toponimet: Arat e Haxhiut(Ça), Guri Hotës, Gradë e Hutit, Ara e Hajrullit (Si), Ara Hazirit(Or), Ara Has(Ka), Bunari Havzis (Ko), Bunari Hafëz Arifit, Bjeshkët e Haxhi Asllanit (Do), Kroj Hasipit, Kodre Hajdare(Së), Hamllat e Epërme (Të), Hajmalia (B.P.), Hordha Eminit (Si), Haxhi Koliba, Hanet (Zd), Hurdhat (Ka, Re), ose te patroni-

met: Hoxhollarët, Hoti, Hane (Çe), Hajdare (To, B.P.), Hasmitre (Lla), Halilallar (Pa), Hasollar (Ne) etj.

b) në pozicion mesor—te toponimet: Ara N'Gryk e Qahilit, Ara Muharemit, Are Qahilit, Are Shahipit(Or), Guri Behares (Çe), N'Kodër T'Ahut Madh (Si) etj., ose te patronimet: Mehmedi (B.P.), Ahmede(St), Alhidre, Cehone, Ruhet (Si), Spahie (Vr), Memduhat(Do), Shehlerë(Ne), Brahimallarë (J.P.) etj., dhe

c) në pozicion fundor—te toponimet: Ara e Emrullah—ut, Gropa e Sallah—ut(Ko), Ligate Rah—ës (Ka) etj., si dhe te patronimet: Brah—e(Gju), Ruh—et(Si).

Alternimi i qiellzores **-q**⁶ në prapagjuhoren **-ç** vërehet në disa emërtime si p.sh. Birat e Uçve (Vru, Çe), Çafë Çegranit (Çe), Balte Kuçe, Çarsheja (Çe), Çafa (T.M.) Çershejat e Fetës (Së), Guri Keç (Çe), Kuçuline Bardhë (Çe), Ke Molle Kuçe (Re, Lla), Parçe, M'Budh Kriç (Ne) etj. Ndërsa, shqiptimin e drejtë të **ç-së** e gjejmë te toponimet: Çukat (Lla, Re, St, De), Çubukllëk(Çe), Çanaku Rexhepit (Ko), Çeshma (T.V.), Çeshme Epër (T.M.Ka) Çeshme Hasanit(B.P.), Çesme Selmanit (Vr), Çairllëk (Vr) etj.

Në toponomastikonin e kësaj ane vërehet edhe shqiptimi i bashkëtingëllores **xh** në vend të bashkëtingëllores **gj** pa marrë parasysh se në çfarë pozicioni gjendet ajo p.sh. **X**horxhoveshti (Gju) në vend të fshatit Gjurgjevishti, Lugu i **X**hand (Vru), Luxhe (Së, Gju), Slloxhe (Fo, Lla), Xhanarupa (To), Guri Xhall (Gr), Kepi Xharpnive (Çe) etj. Kurse shqiptimin e drejtë të bashkëtingëllores **xh** e ndeshim te toponimet: Arat e Haxhiut (Ça), Xhamija ke Jasajka (Do) etj.

⁶ Haki Ymeri, *E folmja... vep.cit.*, f.109–110

Në toponimet e kësaj ane në disa raste vërehet edhe reduktimi i togut bashkëtingëllor **shq** në **sh** si p.sh. Guri Shipes(Vru)etj.

Shkurtimet e emrave të vendeve :

Çe – Çegrani	Pa – Patalishti	De – Debreshi	Go – Gorjani
Fo – Forina	BE – Banjica e Epërme	Vr – Vrapçishti	JP–Jellovca e P.
Ko – Korita	GJP – Gjonovicë e P.	To – Toplica	GJE – Gjonovica e E.
Ça – Çajla	Si – Simnica	Do – Dobridolli	JE – Jellovca e E.
Ba – Balindolli	Zd – Zdunja	Llo – Llomnica	BE – Banjica e P.
St – Strajani	Ra – Raveni	Ne – Negotina	TV – Turçani i V.
Lla – Llakavica	Vru– Vrutoku	Ka – Kalishti	TM – Turçani i M.
Së – Sërmnova	Re– Reçani	Sa – Sanakosi	
Të – Tërnova	Or – Orqushi	Gr – Gradeci	

Literatura:

1. Mehmet Çeliku, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmen e shqipes*, Studime filologjike nr.4, Tiranë, 1971.
2. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978.
3. Bahri Beci, *E folmja e Mirditës*, Dialektologjia shqiptare IV, Tiranë, 1982.
4. Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
5. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978.
6. Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, tezë doktorati, Tiranë, 1994.
7. Xhemaludin Idrizi, *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, tezë doktorati, Tiranë, 1998.

ISMET OSMANI,

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup

TOPONIMIA E DERVENIT TË SHKUPIT

Toponimia përbën një fushë të rëndësishme onomastike dhe ofron brumë gjuhësor me peshë të madhe për studimin e historisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe. Derveni është një zonë e banuar kryesisht me shqiptarë dhe ndahet në dy pjesë: në Dervenin e Poshtëm, që i takon Shkupit dhe në Dervenin e Epërm, që i takon qytetit të Tetovës. Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë emrat e vendeve të vogla dhe emrat e njerëzve të kësaj zone, të përcaktojmë etimologjinë e tyre si dhe të shpjegojmë ata nga pikëpamja fonetike–fonologjike, morfologjike e fjalëformuese, mbështetur në praktikën e deritashme. Në toponiminë e kësaj zone mënyra kryesore e emërtimit të vendeve të vogla ka karakter universal.

Fjalët çelës: mikrotoponim, antroponim, etimologji, vazhdimësi, autoktoni

Hyrje

Studimet onomastike janë të rëndësishme sidomos për studimin e tipareve kulturore e gjuhësore të popujve. Ato janë një “arkiv gojor” i historisë dhe i lashtësisë së kulturës shqiptare në këto hapësira. Analiza e formës dhe rëndësisë së toponimeve të rajonit të Dervenit të Shkupit ka treguar se shenjat onomastike për emërtimin e vendbanimeve janë krijuar në bazë të ligjeve të qarta gjuhësore të karaktereve antropologiko–geo-

grafike dhe socio-etnografike. Këtyre elementeve, të cilat, brenda një sistemi të gjerë ekzistojnë si model dhe pasojë duhet t'u jepet emër, të cilin në një vendbanim apo rajon e zgjedhin njerëzit për t'u identifikuar. Emri i vendbanimit gjithmonë ka qenë pasojë, gjithmonë ndonjë detaj është materializuar përmes mjeteve gjuhësore.

Derveni shtrihet në pjesën jugperëndimore të Shkupit, përkatësisht në trekëndëshin midis dy lumenjve Treska dhe Vardari, të cilët takohen në dalje të fshatit Saraj. Kjo krahinë numëron gjithsej 18 fshatra me 99% shqiptare dhe 1% maqedonase. Këto janë: Arnaqia, Bojana, Bukoviqi, Çajlana, Gllumova, Kondova, Kopanica, Llaskarca, Matka, Paniçari, Radusha, Raoviqi, Raçja, Semenishi. Ndërkaq, jashtë këtij trekëndëshi gjenden edhe tri fshatra Shishova, Sullarja e Epërme, Sullarja e Poshtme, që janë shumë afër këtij rajoni dhe në aspektin gjuhësor dhe etnografik i takojnë Dervenit, por territorialisht ju takojnë zonave të tjera.

Forma e toponimeve

Studimet antropologjiko-gjeografike dhe sociologjike dëshmojnë se ekziston një lidhje midis karakteristikave gjeografike të ndonjë rajoni, formës së jetës familjare, tipave të fshatrave dhe njerëzve në këto hapësira.

Kështu, 19 fshatrat e kësaj zone zbulojnë se jashtëzakonisht mirë u janë përshtatur nevojave të komunikimit onomastik. Disa fshatra janë emërtuar si sintagma toponomastike dygjymtyrëshe. Të tilla janë tipat i Epërm/i Poshtëm + emri (Arnaqia e Epërme, Sullarja e Epërme, Sullarja e Poshtme etj.).

Në toponiminë shqiptare, përfshirë edhe atë të rajonit të Dervenit, mënyra kryesore e emërtimit të viseve ka karakter universal. Aty dallohen:

1) Emërtime vendesh që shprehin ngjyrën, përbërjen e tokës dhe sipas ndonjë specifike tjetër: *Guri Shpum*, *Kepi i Keç*, *Kajnakli Madh*, *Lugi i Mudollit*, *Gropat*, *Livadhe*, *Rrafshet*.

2) Toponime që përmbajnë emra të bimëve, drunjve, shkurreve dhe kulturave bimore që rriten ose janë rritur në të kaluarën: *Thana*, *Maslinka (Lajthitë)*, *Lajthitë e Zhelit*, *Shamake* (për kallam, haset edhe në FGJSSH), *Lenishte* (frut dushku, gogla), *Ferrat*, *Livadhet* etj.

3) Toponime që përmbajnë emra shpezësh a kafshësh, si: *Guri Shipes*, *Bafçe Drangu* (nga drangu).

4) Sipas antroponimeve e patronimeve: *Tërllat e Dibranve*, *Ara e Rufatit*, *Arat e Matjanve*, *Lomt e Spahive* etj.

5) Sipas emrit të objekteve të ndërtuara në ato vende, shumica të shkatërruara tërësisht duke mos lënë asnjë gjurmë, pos emrit që ruan ai vend edhe sot e kësaj dite: *Kepat e vojxhi* (fjala *kep* –gurë (shkëmb) dhe mbiemri *vojxhi* (te shkëmbinjtë e vegjël), *Muret e Markit* (mure të trasha të stilit romak / *Mure Çemere* – pa baltë e pa çimento). Mure të tilla ka pasur në Bojanë dhe në rrethin e Tetovës; *Gullaritë* (shpella), *Kepi i Shishovës*. Nga Çabej kemi *kep* – thep – maje e mprehtë shkëmbi ose “maje guri”. Kjo majë është e lartë 770 metra, i njohur edhe shkëmb olimpik.

Etimologjia e toponimeve

Shikuar nga aspekti sinkronik, të gjitha toponimet dhe mikro-toponimet e kësaj zone mund të quhen edhe si “identifikime të lokaliteteve”. Përmbajtja semantike e tyre dallon lokalitetet e vjetra nga ato të reja. Arsyeja për një dallim të tillë duhet kërkuar në faktin se çfarë është ndryshuar. Një krahasim toponimesh të ndryshme për nga koha e emërimit dhe themelimit është i rëndësishëm si dëshmi e ekzistimit të dallime-

ve gjuhësore midis toponimeve të reja dhe të vjetra. Por, sipas përmbajtjes semantike të toponimeve dhe mikrotoponimeve mund të gjejmë formën si ka qenë më parë, çfarë ka humbur dhe si është sot. Në grupin e parë bien ato shenja toponomastike që në aspektin sinkronik nuk mund t'ua gjejmë kuptimin, të tjerat në esencë nuk kanë ndonjë shenjë kuptimi për të asocuar në ndonjë gjë, qoftë topografik ose antroponimik.

Kështu, emërtimi i vendeve të këtij rajoni vetëm në gjuhën maqedonase (në kohën e ish sistemit) ka pasur për qëllim mbjelljen e një vetëdije se trojet ku banojmë nuk qenkan tamam “maqedonase”, prandaj u dashkan maqedonizuar. Ndërrimi i toponimeve në këtë anë, por edhe në tërë Maqedoninë është bërë si rezultat i një vullneti ideologjik. Emrat e vendeve ose toponimet, sikurse emrat e përveçëm në përgjithësi, mbushen me kuptim në histori. Një emër si *Vrella* (vrello) nuk do të thotë vetëm “burim, gurrë”, por gjithçka që ka të bëjë me domethënien dhe me historinë e këtij burimi, që e furnizon tërë qytetin e Shkupit me fshatrat përreth me ujë të pijshëm, që mbahet mend prej banorëve të fshatit Raçe se 40 vjet e kanë pasur të ndaluar ta shfrytëzojnë ujin e këtij burimi, peizazhi, historia, kujtimet e të shpërngulurve nga ky fshat etj. Të gjitha vendbanimet e Dervenit zyrtarisht janë identifikuar me fjalë burimisht sllave, megjithatë 99% e popullsisë së kësaj ane shqiptare ka arritur që t'i në mënyrën e vetë, p.sh. Matka, Kopanica, Llaskarce, Dollno, Gorno Svillare etj. nga shqiptarët janë quajtur Matkë, Kopanicë, Llaskarcë, Sullare e Poshtme, e Epërme. Edhe pse burimisht janë fjalë sllave dhe, kuptimisht, të pamotivueshme brenda shqipes, megjithatë nuk janë përkthyer, por janë ruajtur si të tilla.

Megjithatë, konstatimi i përgjithshëm është se mbizotërojnë emërvendet me prejardhje nga shqipja, të tipit *Gjuri Bardh*,

Dhevi Bardh, Zabeli i Çarave, Udh e Meçajcës, Kajnaki Madh etj., ndërsa më pak mikrotoponime me etimologji joshqipe. Emërvendet e shumta me origjinë ilire-shqiptare janë edhe një dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë në rrjedhë të kohës.

Mënyra e fjalëformimit të toponimeve

Sipas mënyrës së fjalëformimit, këtu dallojmë emra të parmë dhe emra të prejardhur.

Toponime të parmë (rrënjorë): *Mera-ja, Rreth-i, Maj-a, Pemë-t, ferr-at, Gurr-a, Lam-naja, Livadh-et, Rrez-ja, Vrell-a, Rrafsh-a, Lug-i, Bunar-ët* etj.;

Toponime të prejardhura, me prapashtesim: -ina: *Gjuravina* (Gjuravajna); *Rrafshina* (Rrafshajna), me -icë: *Stranica* etj.

Struktura gramatikore e toponimeve

Emërtimet me togfjalësja në mikrotoponiminë e Dervenit, si edhe në treva të tjera, janë të rëndomtë. Më të shpeshta janë mikrotoponimet emër + përcaktor, që mund të jenë:

a) emër + emër personal në rasën gjinore: që të dy elementet e togfjalëshit janë në njëjtesin e shquar, me çrast emri i dytë në rasën gjinore shënon pronarin: *Tërlla e Bogozit, N'ara t'Reçit, Koder e Stafës, Gjuri i Varrt, Prroi i Dedes, Çeshme Kurtes, Çeshma e Markit* etj.

Përveç këtyre emërtimeve në numrin njëjës, gjejmë edhe emërvende në shumës, si *Te Honet, Gjurst e Bardh, Te Argaçët, Gropat e Haxhive, n'Fund t'Leskave* etj.

b) emër + mbiemër që tregon ngjyrën, madhësinë, formën madhësi, pozitë, largësi ose ndonjë veçori tjetër, si: *Kroi Mexhe, Maje Shulloni, Gjuri Gjat, Gjuri Shpum, Kajnaki Madh,*

Kodër t'Madhe, Ara t'Mdhoja, Kepi Keç, Prroi Madh, Kodre Lemume etj.

c) I pranishëm është edhe konstrukti me parafjalën *te* + emër: *Te Brija, Te Lomet, Te Kepat Vojxhi, Te Kalaja, Te Kodre Hajdarit, Te Dingi* etj.

Tiparet fonetike të toponimeve

Nga pikëpamja fonetike, në toponiminë e fshatrave të Dervenit na dalin këto veçori:

Zanorja /i/ si në të folme, ashtu edhe në toponiminë e fshatrave të Dervenit është diftonguar në *âi*: *Lugi Fâirit* (< *Lugi i Fierit*), ndërsa në toponimin më të vonshëm me burim sllav *Stanica* i— ja ruhet e padiftonguar.

Zhbuzorëzimi i /y/— së në /i/ është dukuri mjaft e përhapur në të folmet e gegërishtes qendrore. Kjo hetohet në të folmen dhe në toponiminë e fshatrave të Dervenit.

Për shkak të ekonomizimit dhe lehtësimit të shqiptimit, në mbarë leksikun toponomastik të rajonit të Dervenit shfaqet elizioni, përkatësisht mosshqiptimi i nyjave të përparme *i* dhe *e* të enrave në rasën gjinore e të mbiemrave, sipas tipit *Lugi Mudollit* (< *Lugi i Mudollit*), *Gjuri Shipes* (< *Guri i Shqipes*, *Shqiponjës*), *Prroj Orlakut* (< *Përroi i Oralkut*), *Kodre Lemume* (*Kodër e Lëmuar*) etj.

Dukuri e përgjithshme fonetike e gegërishtes veriore është afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]. Kjo shprehi nyjetimore shfaqet edhe në toponimet e fshatrave të Dervenit, si *Kepi Keç* (< *Kepi i Keq*), *Kepat e Vojxhi* (*Shkëmbinj të vegjël*) (*Shishovë*).

Grupi *je* përngjashmohet në *e*, si *Udha Nermetne* (< *Udha e Ndërmjetme*, *Ndërmjeme*),

Grupi i bashkëtingëlloreve **mb**, **nd** përngjashmohen në **m**, **n**: *Ara Mretit* (< Ara e Mbretit), *Bunari Katunit* (< Pusi i Katundit), *Ara Kamerit* (< Ara e Kamberit) etj.

Si shumica e të folmeve të gegërishtes qendrore që /g/– në e qiellzorëzojnë në /gj/, në toponiminë e këtij rajoni /g/– qiellzorëzohet dhe kalon në /gj/, si *Gjuri Shipes*, *Gjuri i Shpum*, *Gjuri Keç*, *Gjuri Gjat*, *Gjuri Bardh*, *Gjurishte* (Semenisht).

Rezyme

Toponimia e Dervenit të Shkupit ka treguar se, sikur edhe shenjat onomastike për emërtimin e lokaliteteve janë krijuar në bazë të ligjeve të qarta gjuhësore të karaktereve antropologiko–gjeografike dhe socio–etnografike. Të gjitha këto elemente krijojnë mundësinë për t’u emërtuar, emër ky, të cilin në një lokalitet apo rajon e zgjedhin njerëzit për t’u identifikuar. Emri i lokaliteti gjithmonë ka qenë pasojë, gjithmonë ndonjë detaj është materializuar përmes mjeteve gjuhësore.

Literatura:

1. Baliu, Begzad: *Onomastika e Kosovës* (ndërmjet miteve dhe identiteteve), Prishtinë, 2008.
2. Doçi, dr. Rexhep: *Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I*, Prishtinë, 1990.
3. Cvijić, Jovan: *Balkansko poluostrvo i južnoslovensko zemlje*, Beograd, 1966.
4. Hamiti, Asllan – Sopaj, Nehas: *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004.
5. Ibrahim, Mustafa: *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2010.
6. Idri, Xhemaludin: *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.
7. Ismaili, Mustafa: *Goshinca e Kumanovës* (monografi), Shkup, 1998.
8. Kostić, Cvetko: *Sociologija sela*, Beograd, 1975.

9. Murati, Qemal: *Dëshimi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, Tiranë, 1993.
10. Nesimi, Remzi, *E folnja e Dervenit*, Shkup, 2008.
11. Osmeni, Ismet, *Mikrotoponimet dhe antroponimet e Dervenit të Shkupit*, Seminari IV ndërkombëtar i albanologjisë, Tetovë, 20–22 shtator, 2012.
12. Rustemi, Vebi, *Hulumtime onomastike në Dervenin e Shkupit*, Shkup, 2001.
13. Shkurtaj, Gjovalin: *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001.

MUSTAFA IBRAHIMI,

Universiteti i Europës Juglindore

OJKONIMET ZYRTARE DHE ATO BURIMORE TË SHQIPTARËVE NË RAJONIN E PELAGONISË (PRILEP, DOLLNEN, RESNJË DHE KRUSHOVË)

Me ndarjen e re territoriale dhe plotësimin e kushteve për përdorimin e dygjuhësisë, vetvetiu u ngrit një çështje mjaft komplekse, siç është përdorimi i ojkonimeve në dy gjuhë, atë maqedonase dhe shqipe. Gjatë këtij procesi, për disa ojkonime është lënë krejtësisht anash ligjërimi popullor, dhe në vend të atij varianti janë përdorur format analogjike të marra nga maqedonishtja ose nga emra analogjik të shqipes. Duke dashur të japim një kontribut për këtë çështje si objekt studimi, do të jenë pikërisht emërtimet popullore të disa ojkonimeve që përdoren në rrethin e Prilepit, Dollnenit dhe Krushovës, vendbanime ku jetojnë shqiptarë.

HYRJE

Në emërtimin e vendbanimeve të caktuara në Maqedoni, posaçërisht në rajonin e Pelagonisë, ku jetojnë shqiptarë, standardizimi i ojkonimeve nuk është mbështetur në format burimore të folësve të atij rajoni, por në shabllone të caktuara që krijohen në mënyrë analogjike me ojkonime tjera. Për të bërë një standardizim të vërtetë dhe për të ndërtuar një gjendje të qëndrueshme, pra duhet të mbështetemi në strukturën gjuhësore dhe historike të përdorimit të tyre nga folësit e një rajoni të caktuar.

Për të dhënë forma standarde për një vend të caktuar (ne kemi zgjedhur vendbanimet në katër komuna të rajonit të Pelagonisë, si ato të Prilepit, Dollnenit. Krushovës dhe Resnjës). Gjatë regjistrimit të tyre, krahas versionit zyrtar, ne bazohemi në variantet e ndry-

shme të emërtimit të këtyre fshatrave, sidomos në variantet lokale, por edhe në ato shoqërore, sidomos në variantet multigjuhësore dhe multikulturore. (Baliu 2006: 21). Mbështetja ndaj këtyre varianteve, na ndihmon të njihemi me emërtimet burimore dhe përdorimit më të zakonshëm të tyre, si mjet i komunikimit gojor dhe të shkruar. E dimë se gjuha standarde anon drejt shuarjes së shmangieve duke imponuar një formë të vetme ndër të gjitha format dialektore (Ismajli 1998:17). Megjithatë ne gjatë hartimit të formave burimore të ojkonimeve, kishim parasysh dy elemente të rëndësishme: kontinuitetin historik të përdorimit të ojkonimeve në këto vendbanime nga shqipfolësit e atij rrethi dhe realizimin gojor dhe atë të shkruar, që në aspektin pragmatik do të ndihmonin në standardizimin e emërvendeve në këto komuna, por edhe në përgjithësi në për të gjitha ojkonimet në Maqedoni.

Në këtë rrjedhë duhet të jemi të vetëdijshëm se toponimia e standardizuar e vendbanimeve në Maqedoni, nuk duhet të përputhet domosdo me gjuhën letrare, as me gjuhën letrare kombëtare (Ismajli 1998:18), por parasëgjithash të jetë në pajtueshmëri me vetë folësit e atij rajoni dhe të dalin nga goja e popullit. Gjithashtu, këto ojkonime përveç që do të përfshihen brenda strukturës shumëhomogjene të onomastikës shqiptare, ato duhet të përfshihen edhe në strukturat multigjuhësore të onomastikës së gjuhëve të huaja.

Onomastika shumështrësore dhe shumëgjuhësore në rrafshin e Pelagonisë

Në shqyrtimin tonë, nuk bëjmë përpjekje për ndërrimin e emrave të vendbanimeve, por kthimin e emrave të vendbanimeve në trajtat e sotshme, ashtu siç gjallojnë në gojën e popullit. Bëhet fjalë për disa fshatra të caktuara nga të katër komunat ku banorët shqiptarë ndryshe i artikulojnë emrat e fshatrave nga banorët maqedonas dhe në një mënyrë kanë bërë standardizimin e tyre.

Pra në emërtimin e vendbanimeve duhet të kemi kujdes, me qëllim që ky emërtim të jetë sa më funksional për përdoruesin, në këtë rast për fshatarin a vendbanimin e caktuar. Meqë bëhet fjalë

për lokalitete me popullsi të përzier etnike duhet bërë përshtatje, sidomos në rrafshin afiksial.

1. Kështu për shembull disa fshatra si *Алданци*, *Секирци*, *Костинци*, dhe *Дреновци* në gjuhën letrare përkthehen si, *Alldancë*, *Sekircë*, *Kostincë* dhe *Drenovcë*, mirëpo në gojën e popullit shqiptarë të këtij rrethi emërtimi i këtyre fshatrave bëhet në format: *Alldançe*, *Sekirce*, *Kostince*, *Drenovce*. E njëjta gjë përsëritet edhe me emrin e fshatit *Житовше* që në gjuhën letrare ka dhënë *Zhitoshë*, por populli e përdor formën *Zhitoshe*, –ja, ashtu si përdor edhe vendbanimet tjera si: *Вранче* > *Vrançe*, *Слепче* > *Slepçe*, *Сливје* > *Slivje*, *Бонче* > *Boņçe*, *Дуње* > *Duņje*, *Кокре* > *Kokre*, *Ракле* > *Rakle*, *Стење* > *Stenje*.
2. Të pranohet zëvendësimi i disa mikrostrukturave afiksale sipas modeleve fjalëformuese autoktone dhe të akceptueshme për vendësit, si p.sh, kalimi i sufiksave:
 - **evo>ovë**, si te vendbanimet: *Крушево* > *Krushovë*, *Кутлешево* > *Kutleshovë*, *Пешталево* > *Peshtalovë*, *Рилево* > *Rilovë*, *Милошево* > *Milloshovë*, *Саждево* > *Sazhdovë*, *Арилево* > *Rilovë*, *Отешево* > *Oteshovë*, e jo: *Krushevë*, *Kutleshevë*, *Peshtalevë*, *Rilevë*, *Milloshevë*, *Sazhdevë*, *Oteshevë*, siç janë regjistruar zyrtarisht.
 - **ovo > ovë**: *Курбиново* > *Kurbinovë*, *Браилово* > *Braillovë*, *Десово* > *Desovë*, *Небрегово* > *Nebregovë*, *Ропотово* > *Ropotovë*, *Јакреново* > *Jakrenovë*, *Волково* > *Vollkovë*, *Живово* > *Zhivovë*, *Гугаково* > *Gugjakovë*, *Чепигово* > *Çepigovë*, *Чумово* > *Çumovë*.
3. Një numër të madh të emërvendeve të këtij rajoni paraqiten disa ndryshime fonetike, ashtu siç përdoret nga popullata lokale shqiptare. Tek një numër të konsiderueshëm vendbanimesh, emërtimi i tyre bëhet me këmbimin e zanoreve në pozicione të ndryshme të fjalës , si:

- a> e: Езерани > Ezeren
- a>ë: Беловодица > Bellovodicë, Дабница > Dabnicë, Крушевица > Krushevicë, Леништа > Lenishtë, Лопатица > Llopaticë, Штавица > Shtavicë, Избишта > Izbishtë, Рајца > Rajcë, Стипона > Stiponë, Топлица > Toplicë
- o> e: Норово > Nerovë
- o> a: Këtu kemi dukurinë fonetike të disimilimit, kur dy tinguj të njëjtë ndryshojnë ose largohen për nga veçoritë e tyre të përbashkëta. Në të shumtën e rasteve, këtij procesi fonetik i nënshtrohet një numër i kufizuar fjalësh të gurrës së huaj dhe është karakteristik kryesisht për gjuhën e folur popullore. Në gjuhën shqipe disimilimi shfaqet më tepër në bashkëtingëllore, sidomos në sonante **l, r, n, m**, por e pranishme është edhe në zanore **P.sh. Подмочани** > Podmaçan .
- o>ë: Белушино > Bellushinë , Бурино > Birinë, Борино > Borinë , Кошино Koshinë, Петрино > Petrinë, Љубојно > Lubojnë
- e>ë: Мажучиште > Mazhuçishtë, Полчиште > Pollçishtë, Бешиште > Beshishtë, Витолиште > Vitolishtë, Чаниште > Çinishtë, Црнилиште > Cërnilishtë, Селце > Sellcë
- sh>s: Штрбово > Stërbovë

4. Rënia e tingujve

Një veçori tjetër e emërtimit të vendbanimeve, sidomos e të folmeve popullore, është edhe rënia e tingujve në fjalë. Ai haset dendur, si rezultat i mosshqiptimit të disa zanoreve nëpër rrokje të ndryshme të fjalës. Rënia bëhet në pozicione të ndryshme: **në ballë të fjalës (Afereza), në trup të fjalës (sinkopë), në fund të fjalës (apokopë).**

4.1. Afereza.— Fenomeni i aferezës, është proces më i shpeshtë se sa ai i sinkopës dhe apokopës. Shembuj afereze hasim vetëm te një vendbanim: Арулево > Rilovë.

4.2. Sinkopa.— Fenomeni i sinkopës është pak më i rrallë se ai i aferezës, megjithatë edhe kjo dukuri vërehet në emërtimin e disa vendbanimeve të kësaj ane. P.sh. Стровија > *Straaj*, Грнчари > *Gërçar*, Шурленци > *Shurenс*, Сливница > *Slinica*, Сопотско > *Sopocka*. Sinkopa njaft e shpeshtë është edhe në mikrotoponimet e këtij rrethi, si p.sh.: *Strája* (<Strovija), *Ftosájna* (<Ftohtësina), *Poréni* (< Porendi), *Vorret e Katáunit* (<Katundit) (Ibrahimi 2010:27).

4.3. Apokopa.— Dukuria e rënies së tingujve në fund të fjalës është e përhapur në fjalë e shprehje të ndryshme të kësaj së folmeje. Në fund të fjalës mund të bie një zanore, një bashkëtingëllore apo edhe një grup tingujsh.

— Si më karakteristike është rënia e **i-së** fundore, sidomos tek emrat e gjinisë mashkullore, kjo gjë është përgjithësuar, e cila si kompensim sjell me vete edhe gjatësinë e zanores së rrokjes së theksuar: Долнени > *Dollnen*, Дупјачани > *Dubjaçan*, Жабјани > *Zhabjan*, Забрчани > *Zabërçan*, Заполжани > *Zapollzhan*, Дабјани > *Dabjan*, Лажани > *Llazhan*, Локвени > *Llokven*, Новоселани > *Novosellan*, Алинци > *Alinc*, Тополчани > *Topollçan*, Беровци > *Berovc*, Вепрчани > *Verërçan*, Веселчани > *Vesellçan*, Галичани > *Galiçan*, Загорани > *Zagoran*, Пештани > *Peshtan*, Смолани > *Smollan*, Ерековци > *Erekovc*, Острилци > *Astillcë*, Арвати > *Arvat*, Асамати > *Asamat*, Волкодери > *Vollkoder*, Дрмени > *Dërmen*, Златари > *Zllatar*, Кривени > *Kriven*, Тројкрсти > *Trojkërst*.

— Kjo dukuri, në mënyrë të veçantë haset edhe te këto emra vendbanimesh, p.sh: Сарандиново > *Sarandin*, Гостиражни > *Gostirazh*, Дебреште > *Debresh*, Канатларци > *Kanatllar*.

5. Shtimi i tingujve

Në të folmet në fjalë haset edhe **fenomeni i shtimit të tingujve**. Sipas vendit të shtimit të tingujve kemi: *protezën*, *epentezën* dhe *epitezën*.

Epenteza – Në emërtimin e vendbanimeve të kësaj ane, karakteristike është dukuria e shtimit të tingujve në mes të fjalës (epenteza), që është dukuri shumë e rrallë, e kemi shënuar vetëm në dy raste, edhe atë në fshatin: Долгаец > *Dollgovec* dhe Брајчино > *Bratuçinë*,

Epiteza.– Fenomeni i shtimit të tingujve në fund të fjalëve, është më i kufizuar: Прељубје > *Preljuben*

6. Metateza

Kjo dukuri gjuhësore e ndërrimit të tingujve brenda fjalës është mjaft e shpeshtë në të folmet popullore. Prirje për këmbim të vendeve kanë tingujt **r, l, ll** etj. Shembuj të tillë kemi hasur në emërtimin e dy fshatrave : Евла > Elva dhe Покрвеник > Porkërvenik

7. Dallime në funksionin e fonemave të bashkëtingëlloreve – Mjaft me interes në emërtimin e disa vendbanimeve në këto katër komuna janë edhe dallimet që dalin nga këmbimi i bashkëtingëlloreve. Zakonisht, atje ku janë bërë ndryshime është zëvendësuar një bashkëtingëllore me një tjetër ose është reduktuar një bashkëtingëllore. P.sh. Në komunën e Dollnenit është karakteristik këmbimi i **r> ll: Маргари > Mallgari ; **z>x**: Зрзе > Xërxe; **n>m**: Болно > Bolmo; **n>nj**: Крани > Kranj; **c>s** dhe **v>f**: Лавци > Llafi; **ts>c**: СОПОТСКО > Sopocka**

8. Në punën për standardizimin e emrave të vendbanimeve, ashtu si në Kosovë (Baliu 2006:45), edhe në disa vendbanime në katër komunat e lartpërmendura del problemi rreth drejtshkrimit të emrave dygjemtyrësh, të cilët shkruhen në forma të ndryshme. Në gjuhësi ky fenomen është i njohur si **Aglutinim**. Dukuritë e aglutinimit kanë gjetur një shtrirje relativisht të gjerë edhe në fjalë e shprehje të ndryshme në të folmen shqipe të Prilepit dhe Krushevës. Aglutinimi paraqet

dukurinë kur dy a tri fjalë të pavarura, pranë njëra tjetrës, në frazë me kohë janë përngjitur, duke dhënë një fjalë të vetme, e cila me elementet e saja përbërëse semantikisht ndryshon. Kështu është rasti edhe me këto emërvende: Свето Митрани > *Svetimitran*, Бело Поле, > *Bellopolë*, Горно Село > *Gornosellë*, Горна Бела Црква > *Bellocërkë e Sipërme*, Долна Бела Црква > *Bellocërkë e Poshtme*, Лева Река – *Leverekë*, Царев Двор > *Caretvoll*, Пуста Река > *Pustarekë*, Кадино Село > *Kadinosellë*.

9. Përveç dukurisë së aglutinimit në shkrimin e emrave dygjymtyrësh, ata shkruhen edhe në formë ndaras, si në shembujt: Горно Крушије (Ресенско) – *Krushje e Poshtme*, Горно Дупени > *Dupeni i Sipërm*, Долно Дупени > *Dupeni i Poshtëm*, Долно Перово > *Perova e Poshtme*, Мало Мраморани > *Mramoran i Vogël*, Горно Дивјаци > *Divjaci i Sipërm*, Долно Дивјаци > *Divjaci i Poshtëm*, Голем Радобил > *Radobil i Madh*, Големо Коњари > *Koňjare e Madhe*, Мал Радобил > *Radobil i Vogël*, Мало Коњари > *Koňjare e Vogël*, Мало Рувци > *Ruvce e Vogël*, Ново Лагово > *Llagovë e Re*, Старо Лагово > *Llagovë e Vjetër*.

10. Një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve në komunat e Prilepit, Krushevës, Dollnenit dhe Resnjës shkruhen në mënyrë të njëjtët në të dy gjuhët, atë maqedonase dhe shqipe. P.sh.: Илино > *Ilino*, Јанковец > *Jankovec*, Козјак (Ресенско) > *Kozjak*, Коњско (Ресенско) > *Koňjsko*, Лескоец (Ресенско) > *Leskoec*, Наколец > *Nakolec*, Претор > *Pretor*, Сенокос > *Senokos*, Средорек > *Sredorek*, Бучин > *Buçin*, Врбоец > *Vërboec*, Пресил > *Presill*, Врпско > *Vërpsko*, Дрен > *Dren*, Кален > *Kalen*, Клепач > *Klepaç*, Крстец > *Kërstec*, Манастир > *Manastir*, Марул > *Marul*, Никодин > *Nikodin*, Ореовец > *Oreovec*, Плетвар > *Pletvar*, Подмол > *Podmoll*, Прилепец > *Prilepec*, Присад > *Prisad*, Тројаци > *Trojaci*, Царевик > *Careviq*, Шелеверци > *Sheleverci*.

PËRFUNDIM

Materialin që e analizojmë, bazohet në 158 vendbanimet që shtrihen në katër komuna, atë të Prilepit me 58 vendbanime, Krushevës me 19, Dollnenit 37 dhe Resnjës me 44 vendbanime. Edhe pse në dy komuna, shqipja është zyrtare (Dollnen dhe Krushevë), kurse në dy komuna, për shkak të numrit të vogël të shqiptarëve atje nuk janë zyrtare (Prilep dhe Resnjë), megjithatë shqiptarët në emërtimin e tyre gojor përdorin forma të ndryshme nga folësit maqedonas.

Kështu nga 158 vendbanimeve, paralelisht në të dy gjuhët, atë shqipe dhe maqedonase përdoren vetëm 28 vendbanime njëgjymtyrëshe, dhe 14 vendbanime dygjymtyrëshe, ku njëri element është në gjuhën shqipe, përkatësisht maqedonase. Pra 42 ose 26,58 % janë vendbanime nuk kanë pësuar ndryshime, kurse 116 ose 73,41 % të vendbanimeve në strukturat e tyre pësojnë ndryshime fonetike, sipas ligjërimit popullor të folësve të atij rajoni.

Rezultatet nga ky angazhim shkencor, do të ndihmojnë në standardizimin e ojkonimeve, duke u bazuar drejtpërdrejtë ligjërimin popullor të vetë vendasve, si dhe në traditën historike. Një numër të konsiderueshëm të ojkonimeve kanë pësuar ndryshime fonetike dhe kanë nevojë “të përmirësohen”, një pjesë të konsiderueshme të vendbanimeve do të ngelin të shkruhen njëjtë në mënyrë paralele në të dy gjuhët zyrtare . Gjithsesi se ky material gjuhësor lidhur me emërvendet e këtij rajoni, së bashku me materialet tjera të këtij lloji nga të gjitha vendbanimet në Maqedoni, duhet të shqyrtohet edhe njëherë para një Komisioni shtetëror për standardizimin e emërvendeve të Maqedonisë dhe para Komisioneve lokale, duhet të shtrohen edhe detyra tjera, me një përkushtim profesional. Standardizimi i toponimisë shqiptare në Maqedoni është pjesë e historisë, kulturës dhe etnokulturës sonë, që është trashëguar brez pas brezi nga goja e popullit.

Literatura:

- Doçi, Rexhep (1994). “*Dëshmime onomastike ilire–shqiptare në Maqedoninë e sotme*”, në Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup.
- Baliu, Begzad. (2006). *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës*. Prishtinë.
- Ismajli, Rexhep. (1998). “*Në gjuhë” dhe “për gjuhë”*. Pejë.
- Ibrahimi, Mustafa (2003). Interpretime dhe studime gjuhësore. Shkup.
- Ibrahimi, Mustafa (2010). ***Mikrotoponimet e vendbanimeve shqiptare në rrethin e Prilepit, Krushevës dhe Velesit***. Interlingua, Shkup.
- Murati, Qemal. (1993) *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*. Tiranë.

Shtojcë:

	Prilep	Dollnen	Krushovë	Resnjë	Krejt
	58	37	19	44	158
Shqiptarë	0,03%	26,37	21,3	9,13%	
	Алинци > Alinc Беловодица > Bellovodicë Беровци > Berovc Бешиште > Beshishtë Бонче > Bonçe Вепрчани > Verpërçan Веселчани > Vesellçan Витолиште > Vitolishtë Волково > Vollkovë Врпско > Vërpsko Галичани > Galiçan Голем Радобил > Radobil i Madh Големо Коњари > Konjare e Madhe Гуѓаково > Gugjakovë Дабница > Dabnicë Дрен > Dren Дуње > Dunje Ерековци > Erekovc Живово > Zhivovë Загорани > Zagoran Кадино Село > Kadinosellë Кален > Kalen Канатларци >	<u>Бело Поле</u>, > Bellopolë <u>Браилово</u> > Braillovë <u>Вранче</u> > Vrançe <u>Горно Село</u> > Gornosellë Гостиражни > Gostirazh <u>Дабјани</u> > Dabjan <u>Дебреште</u> > Debresh <u>Десово</u> > Desovë <u>Долгаец</u> > Dollgovec <u>Долнени</u> > Dollnen <u>Дреновци</u> > Drenovce <u>Дупјачани</u> > Dubjaçan <u>Жабјани</u> > Zhabjan <u>Житоше</u> > Zhitoshe <u>Забрчани</u> > Zabërçan <u>Заполжани</u> > Zapollzhan <u>Зрзе</u> > Xërxe <u>Костинци</u> >	Алданци > Alldançe <u>Арилево</u> > Rilovë <u>Белушино</u> > Bellushinë <u>Бирино</u> > Birinë <u>Борино</u> > Borinë <u>Бучин</u> > Buçin <u>Врбоец</u> > Vërboec <u>Горно</u> <u>Дивјаци</u> > Divjaci i Sipërm <u>Јакреново</u> > Jakrenovë <u>Долно</u> <u>Дивјаци</u> > Divjaci i Poshtëm <u>Кошино</u> > Koshinë Крушево > Krushovë <u>Милошево</u> > Milloshovë Норово > Nerovë <u>Пресил</u> > Presill <u>Пуста Река</u> > Pustarekë <u>Свето</u> <u>Митрани</u>	<u>Арвати</u> > Arvat <u>Асамати</u> > Asamat <u>Болно</u> > Bolmo <u>Брајчино</u> > Bratuçinë <u>Волкодери</u> > Vollkoder <u>Горна Бела</u> <u>Црква</u> > Bellocërkë e Sipërme <u>Горно Дупени</u> > Dupeni i Sipërm <u>Горно Крушије</u> (Ресенско) – Krushje e Poshtme <u>Грнчари</u> > Gërçar <u>Долна Бела</u> <u>Црква</u> > Bellocërkë e Poshtme <u>Долно Дупени</u> > Dupeni i Poshtëm <u>Долно Перово</u> > Perova e Poshtme <u>Дрмени</u> > Dërmen <u>Езерани</u> > Ezeren <u>Евла</u> > Elva <u>Златари</u> > Zllatar	•

Kanatllar Клепач > Klepaç Кокре > Kokre Крстец > Kërstec Крушевица > Krushevicë Леништа > Lenishtë Лопатица > Llopaticë Мажучиште > Mazhuçishtë Мал Радобил > Radobil i Vogël Мало Коњари > Konjare e Vogël Мало Рувци > Ruvce e Vogël Манастир > Manastir Марул > Marul (Pr) Никодин > Nikodin Ново Лагово > Llagovë e Re Ореовец > Oreovec Пештани > Peshtan Плетвар > Pletvar Подмол > Podmoll Полчиште > Pollçishtë Прилепец > Prilepec Присад > Prisd Ракле > Rakle Смолани > Smollan Старо Лагово > Llagovë e Vjetër Селце > Sellcë Топлица > Toplicë Тополчани > Topollçan Тројаци > Trojaci	Kostince, -ja <u>Кошино</u> > Koshinë <u>Кутлешево</u> > Kutleshovë <u>Лажани</u> > Lazhan <u>Локвени</u> > Llokven Мало Мраморан и > Mramoran i Vogël <u>Маргари</u> > Mallgari <u>Небрегово</u> > Nebregovë <u>Новоселани</u> > Novosellan <u>Пешталев</u> > Peshtalovë <u>Рилево</u> > Rilovë <u>Ропотово</u> > Ropotovë Сарандиново > Sarandin <u>Секирци</u> > Sekirce <u>Сенокос</u> > Senokos <u>Слепче</u> > Slepçe <u>Сливје</u> > Slivje <u>Средорек</u> > Sredorek <u>Стровија</u> > Straaj <u>Црнилиште</u> > Cërnilishtë	> Svetimitran Селце > Sellcë <u>Саждево</u> > Sazhdovë	<u>Избишта</u> > Izbishtë <u>Илино</u> > Ilino <u>Јанковец</u> > Jankovec <u>Козјак</u> (Ресенско) > Kozjak <u>Коњско</u> (Ресенско) > Konjsko <u>Крани</u> > Kranj <u>Кривени</u> > Kriven <u>Курбиново</u> > Kurbinovë Лавци > Llafsi <u>Лева Река</u> – Leverekë <u>Лескоец</u> (Ресенско) > Leskoec <u>Љубојно</u> > Lubojnë <u>Наколец</u> > Nakolec <u>Острилци</u> > Astillcë <u>Отешево</u> > Oteshovë <u>Петрино</u> > Petrinë <u>Подмочани</u> > Podmaçan <u>Покрвеник</u> > Porkërvenik <u>Прељубје</u> > Preljuben <u>Претор</u> > Pretor <u>Рајца</u> > Rajcë Сливница > Slimica <u>Сопотско</u> > Sopotska <u>Стење</u> > Stenje <u>Стипона</u> > Stiponë
---	--	---	--

	Тројкрсти > Trojkërst Царевик > Careviq Чаниште > Çinishtë Чепигово > Çepigovë Чумово > Çumovë Шелеверци > Sheleverci Штавица > Shtavicë			<u>Царев Двор</u> > Caretvoll <u>Штрбово</u> > Stërbovë <u>Шурленци</u> > Shurenc	
--	--	--	--	--	--

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtëror e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

TOPONIMET NË RAJONIN E KUMANOVËS – DËSHMI PËR AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE

Rajoni i Kumanovës shtrihet në veri të Republikës së Maqedonisë në kufij me Republikën e Kosovës dhe Luginën e Preshevës, Serbinë. Ai përfshinë qytetin e Kumanovës, fushën përreth dhe masivin malor të Kozjakut dhe Karadakut. Ky rajon, sipas të dhënave zyrtare, ka 1.212 km. k. me rreth 157.000 banorë, prej të cilëve rreth 60.000 janë shqiptarë. Shqiptarët jetojnë në pjesën perëndimore të rajonit, në anën e Karadakut, e cila ndryshe quhet *treva shqiptare e Kumanovës*. Quhet kështu, sepse po thuaj tërësisht është e banuar me shqiptarë.

Shqiptarët sot janë shumicë në Kumanovë në 5 lagje: Orta Bunar, Bregallnicë, Bedinjë, te Baçet dhe në Lagjën e Trimanve, në 5 fshatrat përreth: Rramanli, Çerkez, Llopat, Kosturnik dhe në Sopot–Vojnoviq, në 11 fshatrat e fushës: Opajë, Llojan, Vaksincë, Sllupçan, Orizare, Likovë, Hotël, Mateç, Vishticë, Ropalcë e Nikushtak, si dhe në 10 katundet e malësisë (në Karadakun e Kumanovës): Allashec, Runicë, Izvor, Orkoc, Strimë, Gllazhdë, Goshicë, Zllakuçan, Bellanoc dhe Shtrazë.

Ndonëse ata, shqiptarët e kësaj treve, sot janë të ndarë administrativisht në dy komuna, në atë të Kumanovës (më pak) dhe të Likovës (më shumë), veten e konsiderojnë një, të pandarë, autoktonë dhe pasardhës të ilirëve dardanë. Këtë vlerësim e mbështesin në histori dhe krijimtari të tyre shpirtërore

dhe materiale. Kjo pasuri, për fat të mirë, është ruajtur deri më sot nga populli i kësaj ane dhe ju ka mundësuar për ta hulumtuar e studiuar, madje jo vetëm studiuesve shqiptarë.

Studiuesit tanë me të drejtë kanë konstatuar se kjo trevë, në skaj të tokave shqiptare, është e pasur me vlera kombëtare, të cilat dëshmojnë lashtësinë dhe autoktoninë e shqiptarëve. Kështu një dëshmi e tillë është edhe toponimia.

Nga burimet e shkruara dhe të dhënat e tjera, kryesisht të mara në terren, është konstatuar se rajoni i Kumanovës ka një toponimi shqipe mjaft të pasur, e cila deri tani për shkaqe të njohura nuk është hulumtuar ose fare pak është hulumtuar dhe studiuar. Nga këto pak hulumtime të studiuesve tanë, është konstatuar se toponimia (mikrotoponimia dhe patronomia) e rajonit të Kumanovës është me burim leksikor të shqipes, por për shkakë të lidhjeve të hershme e të vonshme, që kanë pasur shqiptarët e këtij rajoni me popujt tjerë (latin, grekë, sllav, turq etj.), fjalët e gjuhëve të tyre kanë depërtuar në të folmen shqipe të këtij rajoni, në përgjithësi, dhe në leksikun toponimik, në veçanti. Në këtë rast për të parë këtë ndikim të vogël, po japim disa shembuj, si: Shullan-i, nga lat. *sollanum* – *diell*, *vend në rreze të diellit*, *që e rrezon shumë dielli*; Drum, nga greq. *Drohmos* – *rrugë*, *udhë*; Trll-a, nga sllav. maqedonishtja *vathë delesh*, *kope bagëtish*; Kala nga turq. *fortesë*, *kështjellë* etj. Këto toponime me prejardhje të huaj janë shumë pakë, në krahasim me elementin shqiptar mbizotërues, i cili sa dëshmon se është e lashtë popullsia iliro-shqiptare këtu, po aq është e lashtë edhe toponimia.

Me anë të toponimeve, emërtimit të vendeve që i kanë bërë të parët tanë në rajonin e Kumanovës, madje jo vetëm në pjesën perëndimore, ku siç thamë popullsia shqiptare, por edhe lindore të tij (ku dominon elementi sllav etj.), janë

zbuluar kala (në Sllupçan, në Strimë, në Nikushtak), gërma-dha të vendbanimeve, mure të vjetra e kulla (në Llojan, Sllupçan, Llopat, Likovë, Hotël, Nikushtak), kisha e manastire të konfesionit katolik para pranimi të islamit (në Llojan, Shtrazë, Sllupçan, Gllazhdë, Mateçë, Nikushtak), hane e hamame (në Kumanovë, në Llopat, në Opajë, në Shtrazë, në Bellanoc, në Tabanoc), teqe e varre të shehlerëve (në Kumanovë, në Tabanoc, në Sopot, në Mateçë, në Runicë, në Strimë), si dhe xhami në çdo fshat, që i takojnë të kaluarës dhe kërkojnë hulumtime të reja dhe qasje të arkeologëve e studiuesve tjerë për t'i ndriçuar ato.

Edhe në rajonin e Kumanovës, siç shihet, në emërtimin e vendeve kanë ndikuar rregulla e faktorë të njëjtë, si në vise tjera të banuara me shqiptarë. Studiuesit tanë me fakte kanë provuar se edhe këtu nga aspekti i fjalëformimit dhe strukturës gramatikore janë paraqitur këto tipa toponimesh:

- toponime rrënjore ose të parme si: tuma, gurra, rrahi, etj.,
- toponime të prejardhura me anë të gjuhës të prapashtesave, si: -ak (gollak, kupinjak, shkozak, etj.), -an (shullan, patli-shan, etj.), -aja (Opaja, kalaja, lugaja, etj.), -ca (Vaksinca, Ropalca, etj.), -çan (Sllupçan, Zllakuçan, etj.), -ishte (rrahishte, ferrishte, vidhishte, etj.), -ec (Allashec, etj.), -oc (Bellanoc, Orkoc, etj.), -ovë (Likovë etj.), -za (Shtraza, etj.), etj.
- toponime me konstrukte të larmishme – konstukti para-fjalë+emër, si p.sh.: Permi Livadhe, Mas Tupani, Ner Katun, etj.; para-fjalë+emër në rasën emërore+emër në rasën gjinore, p.sh. Te Guri Shqipes, Te Lisi That', etj.; para-fjalë+emër i shquar në rasën emërore dhe gjinore, p.sh. Te Dahlen Udht, etj.; emër+to-gfjalësh, p.sh. Te udht e Bardha, Te Kroni Hanit, Te Kodra Tupanit etj.; emër+përcaktor, p.sh. Ara Latifit, Mullini Hasanit, Guri i Zi, etj.

Në krijimin e toponimeve të rajonit të Kumanovës kanë ndikuar edhe disa faktorë të tjerë si ai: gjeografikë, historikë, etnikë, etj.

Veçori paraqet edhe reliefi i tokës, forma, pozicioni ose konfiguracioni i vendit, me të cilin është bërë edhe emërtimi i vendit, si p.sh.: Rrafshi i bujëve, Lugu i mollave, Kodra Arifit, etj.; ngjyra e tokës si: Lugi Verdh, Maja Zez, Ujt e Kuç etj.; sipas bimëve, drurëve e pemëve që janë bëhen aty, si: Orizara, Plepishta, Lugi Thanave, etj.; sipas shpezëve e kafshëve që kanë jetuar ose qëndruar aty, si p.sh.: Guri i Shqipes, Shkoza Ujkut, etj.; sipas antroponimeve e patronimeve, si p.sh.: Livadhi Ukes, Kodra Velies, Ara Sahitit, etj.; sipas rrjedhave ujore, lumenjve, përrenjve, etj., si p.sh.: Kroni Ftoft, Reka Likovës, Prroni Madh); sipas objekteve të ndërtuara, si p.sh.: Te Kulla në Reçicë, Te Hamami i Llopatit, Te Manastiri Mateçit, etj.

Ka toponime që shprehin edhe përkatësi kombëtare, fetare, mjeshtëri, ofiqe të ndryshme, moshë ose ndonjë tipar tjetër dallues të njeriut të kësaj ane, si p.sh.: Arbana-shka, Arbana-shko sello, në lindje të Kumanovës, Te Kisha, në Shtrazë, Te Ara Përkës në Runicë, etj.

Një rëndësi të veçantë në toponiminë e këtij rajoni paraqesin edhe emërtimet e rrugëve, që e lidhin rajonin me viset përreth, të cilat në të folmen e kësaj ane quhen *udhë* dhe *xhade*, si p.sh.: Xhadja Shkupit, Xhadja Vrajës, Udhë Gjilanit, Udhë e Frengit (hekurudha, e ndërtuar rreth viteve 1876/78), Udhë e Bardha, etj.

Me emra njerëzish emërtohen shumë toponime, si p.sh.: Lama Shukrisë, Kojria Demës, Livadhi Salihit, etj.

Janë interesant dhe emrat e vjetër iliro-shqiptarë, që ende ruhen te ndonjë anëtar ose kryefamiljar, si: Lika, Kaloshi, Uka,

Gisha, Matra, Caka, Keci, etj., si dhe emrat e vëllazërive dhe fiseve shqiptare, si: Gashi, Berisha, Krasniqi, Thaçi, Sopi, etj. Emrat personalë dhe familjarë u përkasin sferave të ndryshme të leksikut të shqipes. Shumë patronime ruhen edhe si llagape përbuzëse (ofiçe). që shprehin veti të ndonjë anëtarit të familjes, si: qeleshët, shutët, buzellët, kusët ose të ndonjë mjeshtërie e profesioni, me të cilin janë marrë njerëzit e këtij rajoni, si: tabakët, llullukt, qymyrrhit (që e kanë prodhuar qymyrrin – në Izvor) etj.

Studiuesit tanë me të drejtë konstatojnë se emrat e vendeve dhe emrat e familjeve në këtë trevë janë arkiv i vërtet i historisë së pashkruar të popullit tonë, andaj meritojnë të studiohet. Gjuhëtarët tanë po ashtu mendojnë se në toponiminë e rajonit të Kumanovës, nga veçoritë gjuhësore, reflektohet dendurazi aspekti fonetik që. Si në toponimi, ashtu edhe në të folmen e kësaj ane, sidomos në fshatrat Rramanli, Mateç, Hotël, zanorja [i] është e diftonguar në [aj], si p.sh.: Mullajni, Kroni Thajvit, Rrezajna, etj. Madje, zanorja [a] alternohet në [o], p.sh.: Vorri Toskes, Lisat e Vorreve, Vornajca, etj.; zanorja [y] kalon në [i] dhe kjo vërehet sidomos në shqiptimin e numrit dy, si te toponimet: Te Di Lisat, Nermet Di Projeve, Te Di Gjurt e Mdhøj, etj.; edhe diftongun [je] e gjejmë të monoftonguar në [e], si te toponimet: Te Xhadja Shkupit, Nermet Projve etj. Vërehen alternimet fonetike edhe në fushë e bashkëtingëlloreve, pastaj ruajtja e bashkëtingëllores [g], si te toponimet: Te Ara Gat, Te Guri Krist, etj. dhe, anasjelltas, alternimi i grykores [g] në [gj], si p.sh.: Gjurt e Shipes, Gjurište, etj. Grupet konsonantike edhe palatalizohen, si [dj] në [gj], si: Mali Gjekt, etj.; [gi] në [xh], p.sh.: Te Xholit etj. [shq] në [sh], p.sh.: Kepi i Shqipes, etj.; [tj] në [q], si: Te Pusi

i Alibeqirit, etj.,; [q] në [ç], si: Uji i Kuç, Te Prroni Keç, etj.,; [q] në [k], si p.sh.: Te Roga Kive, Te udha e Kerreve, etj.

Veçori tjera fonetike janë edhe a) asimilimi i grupeve konsonantike *mb, nd, ng*, si: Te Kumllat, Ner Katun, Te Mollt e Amla, etj, b) shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës si: Guri Madh, Vllaj Grob etj., c) afereza si: Lugi Molles, Te Guri Limut, etj. ç) sinkopa, si te: Te Rrafshi Alis, Te Kroni Ftoft, etj., d) apokopa, si: N'katun, Te Gurt e K'çi, etj.

Veçori të tjera gjuhësore hasim edhe në fushën e morfologjisë, ku emërtimet e vendeve janë formuar dhe me emra të gjinisë mashkullore e femërore edhe në numrin njëjës edhe shumës, varësisht nga natyra e emërtimit. Mbaresat që formojnë shumësin e emrave mashkullor janë –a dhe –e, si: Te Murrizat, Te Rakitat, etj. Ndeshim edhe emra mashkullorë që e formojnë shumësin me mbaresën –ë, si: Te pemët, etj. Zanorja –ë në shumës para nyjës –t shpeshherë është asimiluar, si: Mollt e Amla, Te Udhte Bardha, etj. Disa emra e ndërrojnë gjininë, si p.sh.: Ara Sahitit, Gropa Arushës (Ariut), etj. Sa u përket nyjave të përparme –i dhe –e të emrave në rasën gjinore e mbiemrave, në mbarë leksikun toponimistik të rajonit ato nuk shqiptohen fare, si: Guri Mavit, Prroni That etj., Toponimeve u paraprijnë shpesh edhe parafrjalët e rasës emërore –te: Te Gurra, Te Kroni Keç, Te Xholllt, etj. Përdoret po ashtu edhe parafrjala –ku, duke treguar vendin e ngjarjes, p.sh.: Ku Ka Kosit Sahiti, Ku e Ka Zanë Orli Leprin, etj., duke mos munguar edhe parafrjalët *n, mbi, ndër, me*, etj., si p.sh.: N'koder, Mbi Katun, Ndër Qytet, Te Kroni Me Gur, etj., Në toponiminë e këtij rajoni gjendet edhe një formë emërtimesh e vendeve, të përdorua me ndajfolje në funksion parafrfoljor, si: Nermet Prrojëve, Mas Guri, Arat N'skaj, etj.

Toponimet, këto vlera kombëtare, gjithsesi duhet theksuar se janë krijuar dhe janë ruajtur nga populli shqiptarë i kësaj ane. Pas largimit të osmanëve, përkundër qëndresës së madhe të popullit shqiptarë, ardhacakët sllav, serbë, ia mësynë këtij vendi dhe, krahas shtrirjes së pushtetit, filluan edhe procesin e asimilimit e të sllavizimit të toponimeve dhe të çdo gjëje tjetër që ishte shqiptare. Administrata serbe i përdori të gjitha metodat që t'i ndryshojë, përkthejë, emërtojë e riemërtojë toponimet në gjuhën serbe, me qëllim që t'i zhdukë dallëngadalë gjurmët e toponimisë dhe të popullsisë shqiptare. Ky pushtues, që i angazhoi njerëzit e vet në pushtet, për këtë punë madje i dërgoi në teren edhe “studiuesit” e vet, për t'i ndërruar emërtimet e vendeve, madje edhe emrat e mbiemrat e shqiptarëve, duke u vendosur prapashtesa sllave si -iq e -viq. Megjithatë, nuk pati shumë sukses, sepse toponimet i kanë qëndruar (rezistuar) kohës, nga se vendasit shqiptarë emërtimet e vendeve të tyre, si dhe emrat e tyre personale dhe mbiemrat, në jetën e përditshme i përdornin, i shqiptonin e i shqiptojnë edhe sot sipas gjuhës së tyre të trashëguar nga të parët.

Mjerisht, tendenca të tilla disa herë janë bërë edhe nga pushteti maqedonas, i cili toponimet në gjuhën shqipe tentonte (kërkonte) t'i shkruajë dhe shqiptojë ashtu si shkruhen dhe shqiptohen në gjuhën maqedonishte, si p.sh.: Kumanovë – Kumanovo, Likovë – Lipkovo, etj. Por, edhe ky qëllim u tregua i pasuksesshëm, sepse s'ishte i drejtë. Ndërkaq e drejtë e natyrshme e secilit komb është që t'i shkruajë dhe t'i shqiptojë toponimet e veta sipas gjuhës së vetë amtare, një e drejtë e cila vlen edhe për shqiptarët.

BERTON SULEJMANI

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare

Universiteti Shtetëror i Tetovës

PËRDORIMI I TOPONIMEVE SHQIPTARE NË TEKSTET SHKOLLORE SHQIPE (1981 – 1989) TË BOTUARA NË MAQEDONI

Në këtë punim kemi trajtuar mënyrën e shkrimit (përdorimit) të toponimeve shqiptare në tekstet shkollore shqipe, tekste të lëndëve të ndryshme mësimore, të tetëvjeçares dhe të shkollave të mesme që janë përdorur nga shkollat shqipe në Maqedoni gjatë viteve të tetëdhjeta të shek. XX. Në shqyrtim do të merren tekstet me autorë joshqiptarë, por që të njëjtat ishin përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njëjtat kanë shërbyer si tekste për paralelet shqiptare. Hulumtimi tregon se në këto tekste gjejmë përdhosje të toponimeve shqiptare, si: Skopje për Shkup, Tetovo për Tetovë etj.

Në vitet e tetëdhjeta në Maqedoni gjithnjë e më dendur gjejmë shkrimin (përdorimin) e formave sllave të toponimeve. Këtë dukuri e gjejmë në të gjitha tekstet mësimore, qofshin të arsimit fillor, qofshin të arsimit të mesëm. Për këtë përdhosje të toponimeve shqiptare është shkruar edhe më herët. Veç tjerash, në këtë punim do të paraqesim edhe diskutimet që janë bërë në mbledhjet e Komitetit Qendror të ish RSM-së më 12 dhejtor 1983. Në këtë mbledhje (e tetëdhjetë e katërta me radhë) e Kryesisë së Komitetit Qendror të CKM¹ (kupto: LKM – Lidhja Komunsiste e Maqedonisë), kryetari K. M. veç tjerash

¹ ДАРМ, Скопје, (kupto: Arkivi Shtetëror i RM-së, Shkup) 427, 412, 14, fq. 31–35.

tregon takimin e tij me S. D.. Gjatë takimit, nga ky i dyti s'qenka përmendur Kosova dhe siguria e Kosovës. K.M. anëtarëve tjerë, pjesëmarrësve në mbledhje, u lexon atë që u ka treguar edhe shokëve të Sllovenisë². Pika e tretë e takimit ka qenë në lidhje me emërtimet e vendeve (toponimet) në Maqedoni. Në vazhdim përmendet edhe ajo se deri në atë kohë janë botuar tre shkrime kundër politikës në këtë fushë, pra të inponimit që shqiptarët të përdorin toponimet sllave e jo ato të vetat që me shekuj i kishte ruajtur. Këto shkrime ishin botuar ku tjetër veçse në gazetën “Rilindja” të Prishtinës. Më tej, K.M. thotë se ne kemi ligj për bashkësitë tjera etnike, i cili rregullon të gjitha pyetjet e kësaj fushe. Ne prap hapur e themi se nuk kemi arritur maksimumin e të drejtave në mes kombit maqedonas dhe kombsisë shqiptare e turke në Maqedoni. Por që sipas tij, në mes toponimeve shqipe dhe maqedonase, praktikisht nuk ka dallime³. Megjithatë, arsyetimi i tyre i pa bazë arrin deri te krahasimi me toponimet turke të periudhës osmane. Çka do të bëhet me toponimet në gjuhën turke. Turqia këtu ka sunduar 540 vjet, ka pasur krejtësisht emërime tjera të vendeve. Vallë, do t'i lejojmë tani edhe emërtimet turke. Ne kemi lejuar që të përdoret Tetovë (por në tekste që i kemi studiuar askund se gjen Tetovë, por Tetovo) sepse ne e përdorim Tetovo, ndërsa turqit i thonë Kallkandele⁴. Çështje e toponimeve shqiptare dhe evidencës pedagogjike e gjejmë edhe në paraqitjen e L. S. e cila para Kryesisë së Komitetit Qendror të LKM-së në mbledhjen e mbajtur më

² Po aty, fq. 32.

³ Si duket Skopje për Shkupin, Tetovo për Tetovën etj. nuk janë dallime. (B.S.)

⁴ ДАРМ, Скопје, (kupto: Arkivi Shtetëror i RM-së, Shkup) 427, 412, 14, fq. 35.

23 shtator 1987 në Shkup⁵, veç tjerash thotë: *Anëtarët e KQ (LK-së) të CCPHM dhe në organet e tjera shtetërore duhet të ngrejnë iniciativë që plotësisht të shikohet gjendja e përdorimit të drejtë të gjuhës dhe alfabetit maqedonas, si dhe gjuhët dhe alfabetet e kombësive; drejtpërdorimi i emërtimeve të vendeve dhe sanksionimet e menjëhershme nëse vërehen shkelje të ligjit mbi përdorimin e toponimeve.*

Gjatë viteve 1983 – 1989, periudhë që e kemi hulumtuar, janë zhvilluar procese përdhunuese ndaj shqipes. Pra kemi të bëjmë me periudhën e pushtetit komunist, por një praktikë e tillë ka vazhduar deri në ditët e sotme⁶. Pushteti dhe qarqet e caktuara vazhdimisht janë marrë me çështjen dhe procesin e sllavizimit të dhunshëm të toponimisë shqiptare, duke sjellë ligje dhe dekrete nga organet e pushtetit maqedonas dhe duke i sanksionuar ata që nuk i janë nënshtruar këtij urdhri. E meta e këtyre ligjeve ka qenë se asnjëherë nuk janë mbështetur në natyrën e një gjuhe, traditën historike, dinjitetin kombëtar të një populli lidhur me toponimet që i përdor në gjuhën e vet⁷. Për të pasur më të qartë këtë që e thamë më lart do ta ilustrojmë e shembuj të nxjerrë nga disa libra shkollorë. P.sh.:

⁵ ДАРМ, Скопје, 427.584.70, fq. 75.

⁶ Mustafa Ibrahim, *Tema siciolinguistike dhe etnolinguistike*, Shkup, 2012, fq. 241.

⁷ По аty.

...ndërpret luginën e Vardarit te Gjevgjelia dhe Pellagoninë
në jug të Bitollas⁸...

në jug të Bitollas... për: në jug të Manastirit;

Kufiri ndaj Shqipërisë fillon nga liqeni i Prespës, ndërpret
Galiçicën dhe liqenin e Ohridit⁹...

liqenin e Ohridit... për: liqenin e Ohrit;

Pozita qendrore e Maqedonisë së Ulët ka kushtëzuar
formimin e vendbanimeve të mëdha të qyteteve të vjetra,

Skopje, si qendër politike¹⁰, ...

Skopje për: Shkup;

... lidhet me Fushgropën Vallandovo¹¹ ...

Vallandovo për: Vallandovës;

Kjo krahinë malore në perëndim shtrihet deri te Fushgropa e

Pollogut, Kiçevës¹², dhe e Prespës ...

Kiçevës për: Kërçovës;

Ajo shtrihet në veri të Skopska Cërna Gorës¹³ nga dy anët ...

Skopska Cërna Gorës për: Karadakut të Shkupit;

Fushëgropat më të rëndësishme në Krahinën e Sharrit janë:

Pollogu, e Kiçevës (për: Kërçovës), Debarit (për Dibrës),

Ohrid (për: Ohrit) – Strugës dhe e Prespës¹⁴.

... burimet te manastiri i Sveti Naumit¹⁵ dhe ...

Sveti Naumit për: Shën Naumit;

⁸ Velimir Kostovski – Sotir Stojanovski, *Gjeografia për klasën VIII*, botimi V, Prosvetno dello, Skopje (në vend që të shkruajnë Shkup), 1986, fq.7.

⁹ Po aty, fq. 8.

¹⁰ Po aty, fq. 17.

¹¹ Po aty, fq. 17.

¹² Po aty, fq. 17.

¹³ Po aty, fq. 19.

¹⁴ Po aty, fq. 29.

¹⁵ Po aty, fq. 88.

Këtë mosrespektim të traditës historike të një populli lidhur me toponimet shqiptare deri diku vërehet edhe sot, kryesisht në emrat e disa lagjeve shqiptare, si ajo e Hasanbegut¹⁶ e që në vend të saj sot përdoret emëri Metodija Andonov Çento¹⁷.

Kjo dukuri antishqiptare, ky imponim i dhunshëm, pati shtrirje edhe në radiotelevizionin shtetëror të kohës. Në Arkivin e RTVM-së kemi gjetur edhe përdorimin e toponimeve sllave në vend të atyre shqipe në Radio Shkupin, si: *jemi me lejimet e radio Skopjes* etj. Kësaj përdhosje të toponimeve shqiptare i rezistoi gazeta “Flaka e vëllazërimit”. Gjatë një studimi mbi gjuhën e gazetës në fjalë, të paraqitur në punimet e Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë në Prishtinë¹⁸ (2012) kemi vërejtur përdorimin e drejtë të toponimeve shqiptare. Si duket edhe kjo ka pasur një shpjegim. Kjo gazetë ka qenë e shpërdarë në shtetet e ndryshme të botës, andaj për ta fshehur këtë diskriminim ndaj shqiptarëve i kanë lejuar që të përdoren si duhet.

Për të nxjerrë në pah përdhosjen e toponimeve shqiptare, shembujt i kemi vjelur nga këto libra shkollorë¹⁹:

1. Mr. Lube Milenkovski, *Gjeografia për klasën I*, Prosvetno dello, Shkup, 1983; (në këtë libër përdoren drejt toponimet shqiptare, sepse në fund të vitit 1983 fillon inponimi (përdorimi) i formve sllave);

¹⁶ Të cilën shqiptarët ashtu e quajnë.

¹⁷ Popullata e përdor edhe emrin Singeliq, kështu është emërtuar gjatë sundimit serb.

¹⁸ Berton Sulejmani, *GAZETA “FLAKA E VËLLAZËRIMIT” DHE GJUHA SHQIPE*, botuar në punimet e Seminarit XXXI të Albanologjisë, Prishtinë, 2012.

¹⁹ Në të gjitha tekstet e mëposhtme gjejmë përdorimin e toponimeve sllave në vend të atyre shqipe.

2. A. Apostollov, L. Milenkovsji, *Gjeografia për klasën V*, Prosvetno dello, Skopje, 1984;
3. J. Dimevski, V. Kushevski, *Histori për klasën VIII*, Prosvetno dello, Skopje, 1985;
4. J. Dimevski, B. Çukarski, V. Dunimagllovski, *Historia për klasën VI*, Prosvetno dello, Skopje, 1985;
5. V. Kostovski, S. Stojanovski, *Gjeografia për klasën VIII* (botimi V), Prosvetno dello, Skopje, 1986.

SKENDER ASANI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

MBI DISA EMËRTIME TË LAGJEVE TË SHKUPIT NË SHEK.XIX – XX

Të hulumtosh toponominë e Shkupit, këtij qyteti të lashtë e të themeluar nga paraardhësit e shqiptarëve, i cili në vazhdimësi ishte kryeqytet i mbretërisë dardane, i kishës së ilirikut – i kryesuar nga perandori bizantin me prejardhje ilire nga Shkupi, Justiniani I, dhe i Vilajetit të Kosovës,¹ është një punë që kërkon një angazhim permanent të institucioneve shkencore, sepse në mungesë të shtjellimit të kësaj problematike nga hulumtuesit shqiptarë, këtë boshllëk e kanë shfrytëzuar shumë mirë qarqet akademike serbe dhe, së fundi, ato maqedonase. Ndonëse ky qytet ra nën pushtimin romak e të pushtuesve të shumtë nëpër periudha të ndryshme historike, banorët e tij, si edhe të krahinave të sotme me shumicë shqiptare, ia dolën t'i mbijetonin shekujt e ta ruanin vazhdimësinë iliro–arbërore, rrjedhimisht shqiptarësinë, i cili sot e asaj dite frymon edhe shqip. Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore studiuesit Petar Skok, Stepan Antoljak, St. Stanojeviç dhe Qiro Truhellka ngulmojnë se fjala shqiptar dhe emri i shtetit “Shqipëri” vijnë pikërisht nga “Skupi” (Shkupi). Ata trumbetojnë se ky qytet është themeluar me emrin Shkupi, por pas okupimit romak, për shkak se alfabeti latin nuk e përmbante shkronjën “sh”, ky qytet u emërtua “Skupi”. Me të drejtë edhe në shumë burime të tjera konstatohet se ai është ruajtur edhe në ditët e sotme te

¹ Gjini Gasper, Ipeshkvia Shkup – Prizren, Zagreb, 1992, 44 – 48.

pasardhësit e ilirëve, pra te shqiptarët e këtij qyteti.² Tezat e fundit të pseudoshkencëtarëve maqedonas, se emërtimi i Shkupit vjen nga një legendë e paargumentuar shkencore “фрлил копје и станало Скопје”, janë ndërtuar në imagjinatën e tyre të rreme, që ka për synim t’i shërbejë politikës ditore, për të ndërtuar një histori krejtësisht tjetër, që ka kaluar ky qytet gjatë historisë. Ky koncept ndërtohet për ta shlyer kujtesën historike se shqiptarët ishin themelues të këtij qyteti dhe se gjatë shekujve ata në vazhdimësi ishin shumicë absolute kundrejt sllavëve. Ndërsa studiuesi Qemal Murati mbron tezën se forma fonetike Shkup tingull për tingull mbulohet me formën latino–dardane Scupi, me ndërrimin e s–së nistore në sh, pra sipas tij kjo është një kontinuitet i formës latino–dardane Scupi, me ndërrimin e s–së nistore në sh, që do të thotë se është një kontinuitet i drejtpërdrejtë i formës antike të latinitetit ilirik dhe nuk mbështetet në formën sllave.³

Nga burimet e shumta historike kuptojmë se vendbanimi i vetëm gjatë periudhës së antikitetit në Shkup ka qenë Kalaja e sotme, e cila ka pasur një shtirje më të gjerë nga gjendja e saj aktuale. Në periudhën e okupimit romak ndërtohet edhe garnizoni ushtarak, të cilin në fund të shekullit XIX, gjatë ekspeditës arkeologjike, e zbuloi Evansi dhe ky lokalitet quhet

² Тиро Трухелка, Археолошке белешке из Јужне Србије, Гласник Скопског Научног Друштва, књига.V, Скопље, 1929, 59 – 85; Петар Скок, Из топономастике Јужне Србије II Скопска Котлина, Гласник Скопског Научног Друштва, књига XV – XVI, Скопље, 1936, 97 – 125; Стјепан Антољак, Како је дошло до имена „Скопља,,. Годишен Зборник Филозофски Факултет на Универзитетот Скопје, књига.12, Скопје, 1960, 75 – 87.

³ Qemal Murati, Sprovë për një fjalor etimologjik onomastik shqiptar, Studime Albanologjike 6, Instituti I Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2012, 28 – 29.

“Skupi” (lokaliteti që sot gjendet në lagjen Zllokuqani të Shkupit).⁴ Ndërkaq gjatë periudhës së sundimit bizantin, sidomos pas tërmetit të vitit 518, qyteti merr një panje më urbane, duke u ndërtuar mbi themelet e kalasë antike dhe duke u shtrirë edhe në territorin e Çarshisë së sotme, aty ku sot është ndërtuar ambasada e SHBA-ve dhe një pjesë e lagjes Duqanxhik. Edhe gjatë periudhës së mesjetës, kur këtë qytet e pushtuan bullgarët e serbët, qyteti gjendej në brendi të Kalasë së Shkupit. Ky qytet do ta ndryshojë tërësisht panjen e një qyteti mesjetar të vendosjes së qyteteve nëpër kala ose kësh-tjella në periudhën e fundit të shekullit XIV, kur Shkupi kaloi në duart e Perandorisë Osmane, kur shpërtheu jashtë Kalasë dhe ajo u shndërrua në një garnizon ushtarak. Kjo ndodhi për shkak të ndërtimit të xhamive dhe objekteve të tjera islame. Nga kjo periudhë Shkupi filloi të zgjerohej dhe nga kjo kohë kemi edhe lagjet ose mëhallët, të cilat u ngritën përreth xhamive, Kalasë dhe Çarshisë.⁵

Ndër lagjet më të vjetra të Shkupit është Çairi, i cili dikur përfshinte një territor të gjerë të këtij qyteti dhe në përbërje të tij hynin edhe objektet tregtare, si: hanet, bezistani dhe mëhallët përreth xhamive më të mëdha të qytetit. Edhe lidhur më etimologjinë e emrit Çair ekzistojnë pohime të ndryshme. Prej tyre duhet veçuar atë se emri “Çair” rrjedh prej turqishes dhe do të thotë “livadh i pyllëzuar”, ndërsa teza tjetër është se emri Çairi është krijuar sipas një banori të këtij lokaliteti me emrin Kadin‘air, i cili përmendet në një dokument të

⁴ Artur Jon Evans, *Antiquarian Reserches in Iliricum*.Part.IV, Scupi, Scopia and Birthplase of Justinian, “Arceologia”, vol.49.1, London, 1885.

⁵ Skender Asani, Çairi arterja kryesore e Shkupit, “Fakti”, 23.X.2006, Shkup.

viteve 1549–1550, si trashëgimtar i vakëfnamesë së hoxhës Mulihudin al-Madin.⁶

Ndër lagjet më të vjetra të Shkupit është edhe ajo e Tophanës, e cila që në fillim të vendosjes së Perandorisë Osmane ishte shndërruar në garnizon ushtarak në Ballkan, ku ishte vendosur edhe artileria e rëndë dhe ku riparoheshin topat e ushtrisë. Më largimin e garnizonit ushtarak, aty u ngrit lagja që u emërtua Fusha e Topve (sot quhet tohpane).⁷

Në mesin e shekullit XVI, me urdhër të vetë sulltanit, ishte ndërtuar Sahatkulla. Nuk ka udhëpërshkrues i cili ka kaluar nëpër këtë qytet e të mos ketë shkruar për këtë kullë. Mekanizmi i orës është sjell prej Singidit dhe, me kohë, ky monument i kulturës u bë identitet i Shkupit. Ndërsa shumë shpejt pas inaugurimit të Sahatkullës për rreth saj u ngrit edhe lagja e cila u emërua me të njëjtin emër dhe ajo edhe në ditët e sotme ekziston si lagje e tillë në Shkup.⁸

Sipas të dhënave që i jep udhëpërshkruesi Evlija Çelebija, me rastin e vizitës së tij në Shkup në vitin 1637, në atë kohë Shkupi kishte 70 lagje dhe në to fliteshin dy gjuhë: gjuha shqipe dhe ajo rumishte (greke). Ndërsa qyteti ishte i ndare në dy pjesë: pjesa e majtë ishte e ndërtuar dhe funksionale, ndërsa pjesa e djathtë ishte e paurbanizuar dhe jofunksionale.⁹

Pas luftërave ruso–turke, serbet në muajt mars–prill 1878 i shfrytëzuan këto momente për të realizuar projektin e tyre të Serbisë së Madhe, duke i shpërngulur me dhunë qindra fshatra të banuara me shqiptarë të Sanxhakut të Nishit. Këta refugjatë

⁶ Skender Asani, Shqiptarët e Shkupit ndër shekuj, Shkup, 2009, 24 – 25.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Стојан Новаковић, Хаџи 'Калфа или Ћатиб – Челебија, Споменик Краљевске Академија, бр. XVIII, Београд, 1892, 46 – 48.

qulëshin muhaxhirë. Një pjesë e tyre u vendosën në trevat e tjera të vilajeteve shqiptare, ndërsa një pjesë tjetër morën rrugën e Anadollit. Në Shkup administrata e vilajetit u përkujdes për strehimin e tyre, duke u ndërtuar shtëpi banimi. Kjo lagje prej vitit 1878 deri në vitin 1913 u quajt Lagja e Muhaxhirëve, ndërsa me okupimin serb të Shkupit, në tetor të viti 1912, popullata shqiptare ishte e detyruar të shpërngulet për Anadoll dhe aty u vendos popullatë serbe, por menjëherë ndryshoi edhe emri i saj në Maxhir Maallo (Маџар Маало), e cila edhe sot e kësaj dite e mban këtë emër.¹⁰

Sipas planit urbanistik të shek. XIX për Kalanë e Shkupit, i cili ishte marrë nga Arkivi i Stambollit, kuptojmë se përreth saj ka pasur edhe objekte të tjera, si: Çarshia e Vjetër, Bezistani, Kulla e Ujit dhe disa lagje të tjera. Ndër lagjet përreth Kalasë ishte edhe Lagjja e Hebrenjve, Lagjja Islame, Lagjja e Katolikëve Shqiptar dhe Lagjja e Nënkalasë (që pas LDB-së shndërrohet në komunë).¹¹

Nga gjithë që u tha më sipër mund të konkludojmë se Shkupi është i pasur me një toponimi të larmishme, duke përfjetuar edhe transformime të ndryshme gjatë historisë së tij të gjatë. Por, me rëndësi jetike janë faktet shkencore, që emrin e Shkupit e lidhin me vetë gjenezën e kombit shqiptar dhe të shqiptarësisë së tij. Andaj Shkupi gjithmonë duhet të jetë në qendër të vëmendjes së të gjitha zhvillimeve që ndodhin sot dhe në të ardhmen në botën shqiptare.

¹⁰ Skender Asani, Shqiptarët e Shkupit ndër shekuj, Shkup, 2009, 24 – 25.

¹¹ Başbakanlık Devlet Arşivleri, Üsküb Kalesi ve şehir planı (XIX.yuzulün ikinci yarısı), BOA, Plan – Proje Tasniti, no: 868.

ZEQIRIJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

STANDARDIZIMI I TOPONIMISË SHQIPTARE NË MAQEDONI

Ashtu siç dihet në shkencën e historisë dhe të gjuhësisë, toponimet kanë një rëndësi të veçantë për interpretimin e historisë së një populli, por edhe të historisë së një gjuhe. Të këtilla janë edhe toponimet e vendbanimeve shqiptare në Maqedoni. Kur themi “toponime shqiptare” nuk kemi për qëllim vetëm ato toponime që ka mundësi të interpretohet përmes gjuhës shqipe e kulturës shqiptare, por të gjitha ato toponime që kanë lidhje me shqiptarët e Maqedonisë, qofshin vendbanime të shqiptarëve, vendbanime fqinje të shqiptarëve të Maqedonisë, emërtime të lumenjve e përrenjve, emërtime të maleve, kodrave, arave, çezmave ose toponime që janë krijuar nën kushtet gjuhësore të gjuhës shqipe etj.

Ndërkaq, ajo që na intereson në këtë studim është se cili është përdorimi i këtyre emërtimeve nëpër dokumentet zyrtare të shtetit, qoftë nëpër dokumentet e kadastrës, nëpër dokumentet personale të njerëzve ose në dokumente të tjera ku përdoren ato. Se sa është e rëndësishme të trajtohet kjo çështje, do t'i referohemi Ligjit për organizimin territorial të vetadministrimit lokal në Republikën e Maqedonisë, me të cilin në nenin 1, mes tjerash thuhet se me të: “.....; *përcaktohen lloji dhe emrat e vendbanimeve*;.....”, në nenin 2 të po këtij ligji thuhet se: “..... *ndryshimi i emrit dhe i selisë së Komunës mund të bëhet me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, pas konsultimit paraprak me qytetarët e rajonit të komunave*.....”, ndërsa në nenin 8 thuhet: “*Secili vendbanim ka emër*”¹ Kjo do të thotë se, pasi që janë botuar në Gazetë zyrtare, emrat e

¹ Shih: Gazeta zyrtare nr. 55, 16 gusht 2004, fq. 7–8

komunave/vendbanimeve janë sanksionuar si të tilla, vetëm ashtu duhet të përdoren në dokumentet zyrtare të shtetit dhe ndryshimi i tyre mund të bëhet vetëm me ndryshim të ligjit ose me pëlqimin e banorëve të asaj komune/vendbanimi.

Dhe, sikur të bëhej fjalë për ndonjë ligj tjetër që përkthehet nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe, kjo do të ishte fare normale, por me këtë ligj nuk është bërë përkthimi i tekstit të ligjit, por janë sanksionuar emrat e vendbanimeve në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë. Ndërkaq kjo ka rezultuar me shumë mangësi. Dhe, mangësitë nuk janë vetëm të natyrës teknike, si – fjala bie – që përkthyesit nuk kanë qenë të vëmendshëm dhe emrat e komunave/vendbanimeve i kanë regjistruar siç kanë qenë me radhitjen alfabetike të gjuhë maqedonase, ashtu që Manastiri (maqedonisht: **Битола**) është në fillim, ndërsa Çashka e Çuçer Sandeva janë në fund, ndonëse rendi alfabetik i shqipes i përcakton ndryshe. Ky gabim, po e quajmë teknik, është ndjekur edhe në radhitjen e emrave të të gjitha vendbanimeve/fshatrave që bëjnë pjesë nëpër komuna. Ndonëse ky mund të merret si lëshim teknik, ai e vështirëson kërkimin e toponimeve nëpër ligj sipas rendit alfabetik, andaj i bie që edhe në toponimet e shkruara në gjuhën shqipe kërkimi të bëhet me rendin alfabetik të maqedonishtes.

Ndonëse nuk është dashur të lejohet, kjo megjithatë nuk e dëmton thelbin e çështjes – regjistrimin e emrave të komunave/vendbanimeve në gjuhën shqipe. Megjithatë, aty ka ndodhur një përzierje dhe disharmoni e skajshme, sa fare nuk merret vesh se mbi çfarë kriteri janë mbështetur ata që janë marrë me përkthimin e ligjit në gjuhën shqipe. Herë–herë fitohet përshtypja se përkthyesi ka ditur të veprojë drejt, kur – fjala bie – Singeliqin e bën Hasanbeg, por kur Dikavecin e bën Dejkovec, duke e lënë njësoj siç është në maqedonisht, pra vetëm duke e shkruar me shkronja shqipe, merret vesh se aty nuk ka pasur asnjë kriter. Pastaj, se nuk ka asnjë kriter vërehet edhe në atë që Sveti Nikolla shkruhet Sveti Nikollë, ndërsa Star Dojrani bëhet Dojran i Vjetër, që detyrimisht shtrон pyetjen se mbi çfarë kriteresh “Sveti” është lënë ashtu, ndërsa “Star” është përkthyer.

Duke qenë ende në problemet, t'i quajmë teknike, do të themi se përkthyesit nuk kanë qenë të kujdesshëm dhe konsistent edhe në shënimin e atyre emrave, që është dashur të përdoren nga disa herë. Kështu, për shembull, Bogdancën, kur e regjistrojnë si emër komune, e bëjnë me gjininë mashkullore – Bogdanci, ndërsa si vendbanim e shkruajnë në gjininë femërore – Bogdancë. Këtë e kemi edhe te emërtimet – Jegunovci si komunë e Jegunovcë si vendbanim, Nagoriçan si komunë e vendbanim në fillim, ndërsa më pas në tekst, te pjesa e fshatrave që bien në të, e gjejmë si Nagoriç, që jep të kuptojmë se ose përkthyesi (nëse ka qenë vetëm një) nuk ka qenë konsistent ose ka pasur më shumë se një përkthyes, që pastaj kanë dalë dy trajta për një vendbanim.

Një çështje tjetër që meriton trajtim në këtë rast janë edhe gabimet thjesht gjuhësore që vërehen në përkthimin e ligjit. Fjala bie për emërtimin e tipit Неготино—Полошко shqip jepet trajta Negotinë e Pollogut, në vend që të shkruhet Negotinë – Pollog dhe, sipas kësaj logjike, kemi po ashtu edhe Речан—Зајаско – Reçani i Zajazit në vend të Reçan – Zajaz, Речани—Челопечко – Reçani i Çellopekut për Reçan – Çellopek etj.

Probleme gjuhësore paraqiten edhe shquarsinë e emrave. Ndonëse duket se përkthyesi insiston ato të mbeten në trajtën e pashquar, ne gjejmë emërtimin Sellca e Keqe për Sellcë e Keqe, Odri për Odër, Toska për Toskë etj.

Diçka që vihet re është edhe mungesa e një kriteri për shkrimin e ë-së në fund të disa emrave. Kështu kemi Седларце – Sedllarc; Кавадарци – Kavadar; Једоарци – Jedoarcë; Смилковци – Smilkovc; Стајковци – Stajkovc; Огњанци – Ognjanc; Богданци – Bogdanc; Митрашинци – Mitrashinc, por pastaj kemi Руѓинце – Rugjincë, Ласкарци – Llaskarcë, Страчинци – Straçincë; Бардовци – Bardovcë, Мојанци – Majancë e Орланци – Orllancë. Kjo do të se përkthyesit nuk kanë pasur ndonjë kriter, porse ato toponime që i kanë njohur dhe kanë qenë më shumë të sigurt se janë ashtu, i kanë shkruar me ë, ndërsa të tjerat i kanë lënë, megjithëse në analogji i binte të jenë njësoj. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë

shpjegim që **Кавадарци** të jetë Kavadar, **Стајковци** të jetë Stajkovc, ndërsa **Једоарци** të jetë Jedoarcë e **Страчинци** – Straçincë.

Në kuadër të gabimeve gjuhësore do të theksojmë edhe gabimet e tipit **Ехлоец** – Ehloec dhe **Кленоец** – Kllenoec, që në gjuhën shqipe nuk ka mundësi të shqiptohen, porse duhet të ketë një konsonant mes dy zanoreve të fundit. Andaj kujtojmë se ato duhej shkruar me “vec”, “hec” ose me “jec”, megjithëse nuk ka shpjegim pse njëri emërtim është me “L” e tjetri me “LL”. Një problem i këtillë na del edhe te toponimi **Чешме Маале**, që shqip është dhënë si Çeshme Maallë, që sigurisht duhej të kishte një “h” ndërmjet dy zanoreve, sepse kështu e kërkon natyra e shqipes. Megjithëse, logjika e shqipes e do që ky toponim, nëse i plotëson kriteret për të qenë toponim shqip, të ishte Mëhalla e Çeshmes.

Kur flasim për mungesën e kriterëve, do t'i marrim shembull edhe emrat e vendbanimeve që krijohen me dy emra, nga të cilët i fundit është “Doll”. Të tillë në Maqedoni ka shumë dhe në regjistrimin e tyre maqedonisht ato rëndom shkruhen ndaras – **Балинд Дол** – Balind Doll, **Добри Дол** – Dobri Doll, **Копачин Дол** – Kopaçin Doll, por nuk ka asnjë arsye që shqip këto të mos shkruhen bashkë: Dobridoll (madje, shqiptarët e quajnë Dobërdoll), Balindoll, Kapiçdoll etj.

Për mungesën e lartë të informacionit që kanë pasur përkthyesit flasin edhe këto toponime: **Агино Село** e Kumanovës është bërë Agino Selo (ndërsa shqiptarët e zonës e quajnë Agakoj); **Д’лга** po ashtu e zonës së Kumanovës është bërë Dllëg (ndërsa banorët e saj e quajnë Gllëgë); **Добарце** e Zhelinës është bërë Dobarce (ndërsa banorët e zonës e quajnë Debërc); në zonën e Tetovës kemi fshatin **Пршовце** që është bërë Përshovc (ndërsa shqiptarët e këtij fshati e quajnë Përshevcë); në Karshiakë kemi **Дејковец** që është bërë Dejkovec (megjithëse banorët e këtij vendbanimi e quajnë Dikavec); **Страхојадица** është shkruar shqip Strahojadicë (ndërsa fshatarët e këtij fshati quajnë Strugudicë); **Света Петка** është bërë Sveta Petkë (ndërsa banorët e saj e quajnë Setapetkë); **Рамни Габер** është bërë Ramni Gaber (kurse banorët e quajnë thjesht Gaber);

Бела Црква e Resnjës është bërë Bella Cërkv (ndonëse shqiptarët e zonës e quajnë Bellacërk); Нижеполе e Manastirit është bërë Nizhepolë (ndërsa banorët e quajnë Xhinxhipojë); Папрадник i Dibrës është bërë Papradnik (ndonëse njihet nga shqiptarët si Papranik); në Derven të Shkupit kemi shembujt: Арнакија është bërë Arnaki (fshatarët e quajnë Arnaqi); Дворце është bërë Dvorc (fshatarët e quajnë Dvorcë); Раовиќ është bërë Raoviq (fshatarët, sipas natyrë antihijatizuese të shqipes, e quajnë Rahoviq); Рашче është bërë Rashçe (shqiptarët e quajnë Raçe); Свиларе është bërë Svillare (fshatarët e quajnë Sullare) etj. Këto janë vetëm disa shembuj se shkrimi i emrave të vendbanimeve shqiptare në Maqedoni dhe i vendbanimeve fqinje me vendbanimet shqiptare këtu është bërë pa ndonjë kriter. Ndërkaq, si e thamë në fillim, këto emra tashmë janë sanksionuar me ligj dhe, nëse dikush nuk i shkruan ashtu në përdorim zyrtar, kjo i bie se nuk e respekton ligjin.

Pasi që kemi konstatuar se kemi para vetes një ligj që kaq rëndë e ka dëmtuar toponiminë me burim shqiptar ose atë toponimi që ka krijuar versione shqipe, do të flasim se cilat do të ishin, në fakt, kriteret e regjistrimit në gjuhën shqipe të toponimeve që janë përdorim zyrtar në Maqedoni.

Së pari duhet të thuhet se është krejt gabim që toponimet të shkruhen shqip duke pasur për bazë toponiminë maqedonase. Kjo le që nuk është shkencore, por është e dëmshme për historinë e atij toponimi, sepse ashtu shumë lehtë një emër i tillë ritrajtësohet dhe merr emërtim që pastaj humb shpjegimin e krijimit, historinë e tij etj. Që ta kemi më të qartë, kjo i bie që toponimin Qafa e Thanës, që e dimë të gjithë për shkak se është emër i pikës kufitare me Shqipërinë, përkthyesit e tillë, duke e marrë për bazë maqedonishten – Кафасан, do ta kishin bërë Qafasan. Që e humb krejt shpjegimin me fjalën shqipe “qafë” dhe “thanë”. Megjithatë, nga kjo nxjerrim përfundimin se nëse ne nuk ua mohojmë maqedonasve që Qafën e Thanës ta bëjnë Qafasan, Sellcën e Keqe – Sellca Keç, Mirditën e Gostivarit – Merdita, nuk ka asnjë arsye që ata të na detyrojnë që Sullaren ta bëjmë Svillare, Papranikun – Papradnik etj. Kjo do të

thotë se, për t'i shkruar në shqip, toponimet shqiptare ose ato të vendbanimeve fqinje shqiptare në Maqedoni, duhet të regjistrohen në terren nga ekspertë shqiptarë, e pastaj të përshtaten maqedonisht. Ndërkaq, sipas nesh, janë pesë kritere të tjera kryesore që e përcaktojnë regjistrimin e toponimeve:

1. Të ruhet ashtu siç është një toponim që e ka ekuivalentin që e përdorin shqiptarët, i cili mund të jetë edhe krejt tjetër nga ai që e përdorin maqedonasit dhe që është në përdorim zyrtar. Të këtilla janë toponimet Shkupi për Скопје, Manastir për Битола, Hasanbeg për Сигелиќ, Agakoj për Агино Село, Belinli për Белановце, Ramali për Роановце etj.
2. Një toponim, që është në përdorim zyrtar dhe përdoret në gjuhën maqedonase, duhet të shkruhet ashtu siç përdoret nga shqiptarët e atij vendbanimi. Këto janë toponime që në rrënjë janë po ato toponime që përdoren zyrtarisht, por që nga shqiptarët kanë marrë trajtë tjetër dhe ashtu përdoren. Këtu bien toponimet e tipit Ohrid, që shqiptarët e quajnë Ohër, Debar, që shqiptarët e quajnë Dibër, Kiçevo, që shqiptarët e quajnë Kërçovë etj.
3. Të bëhet përkthimi i attributeve “I Epërm”, “I Poshtëm”, “I Ri”, “I Vjetër”, kur ato përdoren nëpër vendbanimet shqiptare. Të këtilla janë Горно Нерези dhe Долно Нерези, që shqiptarët i quajnë Nerezi i Epërm dhe Nerezi i Poshtëm ose Горно Количани e Долно Количани, që shqiptarët po ashtu i bëjnë Koliçani i Epërm dhe Koliçani i Poshtëm. Por, kjo nuk duhet të vlejë edhe për vendbanime ku nuk jetojnë shqiptarë ose për të cilat shqiptarët nuk kanë krijuar emërtim të këtillë për vete. Prej kësaj mund të ketë përjashtim vetëm toponimet e reja, si Ново Лисиче (Lisicja e Re), por jo që edhe Novosella të bëhet Fshati i Ri. Kjo, në të vërtetë, mund të jetë çështje debati mes ekspertëve se cilat toponime, të cilave duhet t'u përkthet atributi e cilat jo.

4. Të gjitha toponimet hyjnë në sistemin gjuhësor të shqipes. Kjo do të thotë se ka plot toponime që janë sllave ose të tjera, që kanë një përdorim zyrtar, ndërsa shqiptarët i kanë përfshirë në sistemin e tyre gjuhësor. Të tilla janë **Ново Село**, që shqiptarët e quajnë Novosellë (pra Jo Fshati i Ri), **Добри Дол**, që shqiptarët e quajnë Dobërdoll, **Желино**, që shqiptarët e bëjnë Zhelinë, **Цепчиште** – Xhepçisht, **Копаница** – Kopanicë etj. Këto toponime janë bërë pronë gjuhësore e shqipes dhe i nënshtrohen sistemin gjuhësor të shqipes përkthimi me shquarsinë, lakimet e ndryshme etj.
5. Për ato vendbanime në të cilat nuk jetojnë shqiptarët ose për të cilat shqiptarët nuk kanë krijuar toponim tjetër ose shqiptim tjetër të atij toponimi, rregulla thotë se, ashtu siç nuk kemi të drejtë ta përkthejmë Nju Jorkun me Jorku i Ri, Beogradin me Qyteti i Bardhë ose Sarajin me Pallat, nuk kemi të drejtë t'i bëjmë “shqip” as toponimet Makedonski Brod, Nov Dojran, Sveti Nikollë etj. Ato toponime mbeten të njëjta, por vetëm i përshtaten sistemit gjuhësor të shqipes në kuptim të adaptimit të tyre gramatikor.
6. Analogjia. Për toponimet, për të cilat shqiptarë nuk kanë krijuar emërtim, sepse janë në zona ku nuk ka shqiptarë, më së miri mund të na ndihmonte analogjia. Kështu në analogji me Tetovën, shkruhet edhe Berova, pastaj në analogji me fshatrat shqiptare Gorancë, Rezhancë, mund të shkruhet edhe Bogdancë, në analogji me Reçan e Koliçan mund të shkruhet edhe Koçan, në analogji me Straçincë mund të shkruhet edhe Mitrashincë, në analogji me Jedoarcë do të shkruhej edhe Kavadarçë etj. Natyrisht, këto janë çështje që mund të diskutohen edhe më tej nga ekspertët e fushës.

Marrë në përgjithësi, konstatimi jonë është se standardizimi i toponimisë në gjuhën shqipe në Maqedoni nuk është bërë akoma, ndërsa ajo që është bërë është shumë larg asaj që duhet të bëhet. Ky është një mesazh për drejtuesit e institucioneve në vendin tonë që

kësaj çështje t'i qasen me seriozitetit më të madh, të krijohen ekipet për regjistrimin e toponimisë zyrtare dhe, konform atyre rezultateve, të bëhet edhe ndryshimi i ligjit dhe të miratohen versionet e drejta të këtyre emërtimeve, që si të këtilla në jo pak rast e dëmtojnë në rëndë edhe boshtin etnik të shqiptarëve në Maqedoni.

Burimet:

Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr. 55, 16 gusht 2004

BESNIK EMINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

DISA ASPEKTE TË MIKROTOPONIMEVE NË HAPËSIRËN E FSHATIT ÇELLOPEK TË TETOVËS

Vendndodhja e fshatit Çellopek të Tetovës është e atillë, që u ka mundësuar banorëve të këtij vendbanimi që t'i shfrytëzojnë edhe hapësirat malore, edhe ato fushore. Pozita e këtij fshati është rrëzë Malit të Thatë dhe poshtë fshatit vijon fusha. Gatë viteve, për orientim më të mirë nëpër këto hapësira, janë krijuar emërtimet e vendeve të kanë qenë në përdorim aktiv nga popullsia e kësaj ane. Megjithëse në të kaluarën përdorimi i këtyre toponimeve ka qenë më i shpeshtë, mbase i përditshëm, gjatë viteve të fundit, me ndryshimin e mënyrës së jetesës, gjithnjë e më pak vërehet përdorimi i këtyre emërtimeve. Kjo dukuri është më e shprehur në mesin e gjeneratave më të reja, të cilët thuajse nuk kanë asnjë lidhje “as me malin, as me fushën”. Në këtë mënyrë emërtimet e kësaj hapësire i janë nënshtruar harresës ose fshirjes nga kujtesa popullore. Duke u nisur pikërisht nga ky konstatim, vendosëm që në mënyrë modeste të japim një kontribut në regjistrimin e këtyre toponimeve, të cilat mund të dëgjohen prej personave të cilët në mënyrë aktive e kanë njohur këtë hapësirë.

Emërtimet e vendeve që përdoren nga banorët e fshatit mund të ndahen në disa grupe. Aty vërehet një dallim i theksuar në emërtimet që përdoren zyrtarisht nëpër hartat kadastrale dhe toponimet popullore të atyre hapësirave, por edhe të hapësira-

ve që nuk janë element i evidentimit në dokumentet zyrtare kadastrale. Në këtë mënyrë ndodh që të hasen dy emërtime të ndryshme për një vend ose një hapësirë të njëjtë. Me qenë se fshati ka përbërje të përzier etnike, shpesh në përdorim të përditshëm të haset përdorimi i emërtimeve të ndryshme për një vend të njëjtë, respektivisht në gjuhën shqipe dhe atë maqedonase.

Duke bërë një analizë të emërtimeve në një hapësirë të ngushtë, mund ta kuptojmë edhe atë se si është gjendja me emërtimet përtej regionit në të cilin jemi përqendruar. Duke qenë se njohuritë e mia në gjuhësi janë të kufizuara, nuk do të futem në analizë gjuhësore të emërtimeve, por kontributi im do të përkufizohet në qëllimin tim, që të evidentoj emërtimet që kanë mbetur në kujtesën e personave më të moshuar të cilët mikrotoponimet e shumta i kanë përdorur në jetën e përditshme, sepse – siç e theksuam më lart – gjeneratat e reja përveç se nuk e dinë ku gjenden toponimet e përmendura, por as edhe si emërtime mund të thuhet se nuk i kanë dëgjuar. Domethënë, këto emërtime janë në prag të harresës. Madje, edhe vetë emri i fshatit Çellopek të Tetovës haset si emër fshati edhe në rrethinën e Kërçovës dhe në atë të Kumanovës. Në dokumentet osmane të shek. XV të botuara nga Arkivi i Maqedonisë, vendbanimi është regjistruar si Çëllpek, ndërsa në një hartë austro-hungareze të vitit 1900 është evidentuar si Sulopek.

Nëpërmjet një liste të mëposhtme do të jap disa emërtime të këtij vendbanimi:

- Abdilivadhe – emër vendi në fushë
- Bigor – emër vendi në mal
- Bobosht – emër vendi në fushë, afër varrezave

- Bogaz – emër vendi në mal
- Bogorojc – emër vendi në mal
- Branejc – emër vendi në fushë
- Brazd – emër vendi në fushë
- Brezhinë – emër vendi në mal, që përket me një hapësirë të rrafshët
- Bunalesk – emër vendi në mal
- Çaushtic – emër vendi në fushë
- Çeshma e Hesatit – vendi i cili gjendet përreth çezmës me emrin e njëjtë
- Çeshma e hoxhës – vendi i cili gjendet përreth çezmës me emrin e njëjtë
- Çeshma e Xhetës – vendi i cili gjendet përreth çezmës me emrin e njëjtë
- Çeshmic – emër vendi ku gjendet çezma me emrin e përmendur
- Dëb – emër vendi në fushë
- Doblike – vend varrezash
- Galaramishte – emër vendi në mal me pjesë të rrafshët
- Gëllëbërdë – emër vendi në mal
- Gjoli –hapësirë rreth kënetës
- Gllavë – emër vendi në mal, majë një kodre gjendet një burim uji
- Gomish – emër vendi në mal
- Gradënejk – emër vendi në fushë
- Guri i shipes – emër vendi në mal me shkëmbinj
- Gurnillëk – emër vendi në fushë
- Hajmali – vend ku kryqëzohen tre rrugë
- Kalldërm – emër vendi në fushë
- Karamanic – emër vendi në fushë
- Ke çanui – vend malor me pyje

- Ke gjoli – emër vendi në fushë
- Ke Kami – emër për vend malor, ku ekziston një gur kult, ku është e skalitur një pjesë që ngjan me shputën
- Ke letheja – emër vendi në mal
- Ke llofkat – emër vendi në mal, ku kanë ekzistuar gropa të mbushura me ujë
- Klikovë – emër vendi në fushë
- Krast – emër i hapësirës me drunjt rrëzë të malit
- Krushovic – emër vendi në fushë
- Kunjabar – emër vendi në fushë
- Laçkovic – emër vendi në mal
- Ledinat e Liskos – emër vendi në mal
- Lipqën – emër vendi në fushë
- Llazi i Abduraimit – emër vendi në mal
- Llazi i Alicës – emër vendi në mal
- Llazi i Avramit – emër vendi në mal
- Llazi i Gjores – emër vendi në mal
- Llazi i Kadrijës – emër vendi në mal
- Llazi i Kadriut – emër vendi në mal
- Llazi i Kozmanit – emër vendi në mal
- Llazi i Zendelit – emër vendi në mal
- Llokarec – emër vendi në mal
- Maraski doll – vija e rrjedhës së ujërave malore
- Martinic – emër vendi në mal
- Miçibrest – emër vendi në mal
- Miçilep – emër vendi në mal
- Mollake – vend në mal, ku ka të mbjella molla dhe vreshta
- Mullejni i Nurçës – emërtimi i hapësirës përreth mullirit të përmendur

- Në doll të Miçilepit – emër i vijës së rrjedhjes së ujit të vendit malor me emrin përkatës
- Në mac – emër vendi në mal
- Në rusena niv – emër vend në fushë
- Në të Galos – emër vendi në mal
- Në të Seferit – emër vendi në fushë
- Nikolic – emër vendi në fushë
- Ograde – lëndinë e rrafshët rrëzë malit
- Orashe – emër vendi në mal
- Padin – emër vendi në fushë
- Përzhin – emër vendi në fushë
- Piskilivadhe – emër vendi në fushë
- Plloç – emër vendi në mal
- Poposhapkë – emër vendi në mal
- Potkrast – emër vendi në fushë nën hapësirën me drunjt rrëzë malit
- Potok – emër vendi në fushë, afër të cilit kalon rrjedhë ujore
- Prog – vend i thatë në fushë
- Ququl – emërtimi i majës së një kodre

Emërtimet e këtilla janë përdorur na popullsia lokale shpesh duke e shtrenbëruar formën burimore. Madje, edhe emërtimet që janë imponuar nga shënimet kadastrale janë shtrenbëruar nga popullsia lokale duke iu përshtatur formës më të lehtë të shqiptimit. Varësisht nga ajo se kujt i ka takuar një pronë e caktuar, mund të vërehet edhe përdorimi i emrit të pronarit të asaj hapësirë si mënyrë orientimi.

Në aspektin gjuhësorë mund të vlerësojmë se hasen emërtime që në origjinë janë emërtime popullore dhe emërtime zyrtare,

që janë regjistruar në dokumentet kadastrale. Këto të fundit përfshijnë hapësira më të mëdha dhe nuk i ngërthejnë në vete edhe emërtimet më të vogla. Megjithëse këto emërtime janë një pjesë që janë përdorur, ata japin një mundësi për t'u analizuar nga gjuhëtarët dhe të tjerët, të cilët merren me çështjet e toponimisë.

AGRON SALIHI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

TOPONIMIA E FSHATIT SLLATINË TË TETOVËS

Pozita gjeografike

Fshati Sllatinë shtrihet në verilindje të Tetovës, në rrzë të Sharrit dhe bën pjesë në Pollogun e Poshtëm. Në veriperëndim kufizohet me fshatin Tearcë, në jugperëndim me fshatin Leshkë, ndërsa me zhvillimin (zgjerimin) territorial të fshatit është bashkuar me fshatin Tearcë dhe Leshkë. Territori i këtij vendbanimi zë një sipërfaqe prej 6.6 km² dhe ka një lartësi mbidetare prej 540 m.

Edhe për këtë vendbanim, si edhe për të gjitha vendbanimet që shtrihen në komunën e Tearcës, mund të thuhet se ka pozitë të volitshme gjeografike dhe lidhje të mira komunikacioni, pasi është rrugë lidhëse që lidh Pollogun me Republikën e Kosovës, nëpërmjet kalimit kufitar të Jazhincës. Vendbanimi i f. Sllatinë është më pak se 9 km larg qytetit të Tetovës.

Lëvizja e numrit të popullsisë

Si vendbanim Sllatina përmendet që nga shekulli XV në defterët turk, aty me emrin Islatina, ku përmenden 72 familje¹.

¹ Архив на Македонија, Турски документи за историјата на македонскиот народ. Опширен пописен дефтер Н.4, (1467–1468), Скопје, 1971, ф. 344.

Në vitin 1545 fshati ka pasur 36 familje të krishtera dhe 17 familje myslimane².

Megjithatë, të dhënat për numrin dhe dinamikën e popullsisë as që kanë qenë përafërsisht të sakta ose janë dhënë vlerësime sipërfaqësore. Siç dihet, dikur të dhëna të tilla janë dhënë sipas numrit të shtëpive dhe anvisërive. Ndërsa nga tabela e mëposhtme do ta pasqyrojmë lëvizjen e popullsisë së këtij vendbanimi prej vitit 1953 deri më 2002.

Tabela: nr. 1. Lëvizja e numrit të popullsisë së f. Sllatinë në periudhën 1953–2002).

Vendbanimi	Viti i regjistrimit	Gjithsej	Shqiptarë	Maqedonas	Turq	Romë	Serbë	Të tjerë
Sllatinë	1953	1724	1605	112	1	/	1	5
	1961	2008	1870	88	46	/	/	4
	1971	2707	2591	85	22	/	/	9
	1981	3422	3326	61	2	11	/	21
	1994	3893	3834	39	/	18	1	1
	2002	4112	4018	11	/	7	1	75

Burimi: ESRM: Вкупно население на Р.М. според изјаснувањето на националната припадност, по општини и населени места според пописите, 1953, 1961, 1971, 1981, 1994, 2002. Скопје, Април 2002, Книга IX. Вкупно население, домаќинства и станови ,Скопје 2002. Книга X. (Përpunuar nga autori).

² Архив на Македонија, Турски документи за историјата на македонскиот народ. Опширни пописни дефтери од XV–век. Том III, Скопје, 1976. fq. 127

Për nga numri i banorëve, Sllatina është ndër vendbanimet më të mëdha në aksin rrugor Tetovë–Jazhincë, ku numri i popullsisë – sipas regjistrimit të vitit 2002 – është 4.112 bano-rë. Megjithatë ky numër nuk është i saktë, pasi që një numër i madh i banorëve që gjenden me punë të përkohshme në botën e jashtme nuk regjistrohen fare. Sidoqoftë, në këtë arti-kull nuk pretendojmë të bëjmë sqarime më të zgjeruara për numrin e popullsisë, por do të japim disa të dhëna për antro-poniminë dhe mikrotoponiminë e këtij vendbanimi, i cili ende e ruan me fanatizëm të lartë autoktoninë shqiptare.

Sllatina është e përbërë prej 14 mëhallëve, si³:

1. Mërlaskrët
2. Kapçet
3. Drizollarët
4. Odallarët
5. Përrët
6. Masllaret
7. Shkundet
8. Akulët
9. Topallët
10. Kolallaret
11. Amoqet
12. Dokurët

13. Trekalaçët⁴ me nënfiset:
 1. Ibishallarët
 2. Metallarët
 3. Demallarët

³ Informator: Beadin Beadini. F. Sllatinë, mosha 81 vjeç.

⁴ S, Etemi, Sllatina (Monografi), Tetovë, 2005, f.59.

4. Islamallarët
 5. Bajramallarët
 6. Xhelet
14. Torbeshët me nënfiset:
1. Beadinët
 2. Dënallarët
 3. Etemallarët
 4. Mustafallarët
 5. Hulet
 6. Hutët
 7. Shilkët.

Në Sllatinë ekzistojnë edhe 6 familje të vogla të ardhura, ndonjëra ma herët, e ndonjëra ma vonë. Ato janë: Emini Shtrazës (nga Shtraza e Kosovës), Hakia i Grupçinit (nga fshati Grupçin i Malit të Thatë), Vejseli i Orashës (nga fshati Orashë), Xhema i Breznës (nga fshati Brezë i Karadakut), Taipi i Xhermës (nga f. Xhermë i Malësisë së Sharrit), Sabit Muhaxheri (nga Leskoci i Serbisë).⁵

Ndërkaq disa nga mikrotoponimet e fshatit Sllatinë janë:⁶

Alavejca – arë në fushë

Ar'e Bajrëmit – arë në fushë

Ar'e Dabës – arë në fushë

Ar'e Hëmës – arë në fushë

Ar'e Madhe – arë në fushë

Ar'e Rufat Agës – arë në fushë

⁵ Po aty

⁶ Informatorë, Beadin Beadini, f, Sllatinë mosha 81 vjeç.

- Ar'e Tupukit – arë afër fshatit Tearcë
 Bafçja e Kishës – vend në fshat
 Barrja – vend në fushë me ujëra të cekëta.
 Biguri – gur gëlqerorë afër fshatit
 Bllatët – kopsht
 Brinica – vend afër fshatit ku i kanë hedhur kafshët e ngor-dhura
 Bunar'i Apës Elmas – bunar në fshat
 Bunar'i Apës Islam – bunar gjendet në fshat me ujë mineral
 Bunar'i Haxhi Izairit – bunar në fshat
 Bunar'i Merës Ferati – bunar në fushë tani nuk ekziston
 Bunar'i Mualla Bejtës – bunar në fushë i cili ende ekziston i cili gjendet në Kushpatejc
 Bunari Salihit – bunar që e ka ndërtuar Salihu, gjendet në fushë
 Çafet e Kullave – vend në bjeshkë
 Çeshma e Lazes – çezme në fushë, ende ekziston
 Çiftetash – vend me lëndina në mal.(Ku hasen dy gurrë bashkë)
 Di Udhët – vend ku kryqëzohen dy rrugë
 Dullubare – arë në fushë
 Dushkallejki – vend mal
 Dushki – arë në fushë
 Fer'i Madh – vend në bjeshkë
 Gjuri Bardh – arë në fushë
 Gllog – arë në fushë
 Gllog – arë në fushë
 Grika – mal me pyje të përziëra
 Gumnishte – vend me kullota
 Hendeki Manasterit – vend në fshat
 Hurdha – vend në mal

Indeki Baftës – vend në fushë
Jasejk' e Madhe – arë në fushë
Jasejk'e Shaqirit – arë në fushë
Jasejk'e Vogël – arë në fushë
K'epët e Dierdhëm – gjenden në bjeshkë
Ka Grika – vend në mal
Kalinuava – ara në fushë
Kalipica – vend në mal
Kepi i Plloçes – gur në bjeshkë
Kepi i Hutit – gur në mal
Kepi i Sallmënit – gur në mal; e ka marrë emrin prej Selmanit, i cili ka qenë bari dhish, i cili është ngjitur në të por e ka pasur vështirë për të zbritur.
Kepi i Zi – gur në bjeshkë
Kepi me golla – gur në mal
Kepi Shipes – gur në mal
Klitishta – vend në mal
Kozarica – arë në fushë
Krushët – arë në fushë ndërmjet Sllatinës dhe Tearcës
Kshtiët e Alirizës – vend me gështenja mbi fshat
Kuçova – arë në fushë
Kuëdër e Gllavejnës – mal afër fshatit
Kushpatejca – arë në fushë
Lama e Pajetishtes – vend në mes malit, hapësirë e zhveshur
Lama e Shushies – hapësirë e zhveshur në mes të malit
Lëmët – vend afër fshatit ku dikur i kanë fshejt lashtat
Lethëjë – vend në mal
Lidin'e Alitit Tishit – mal i zhveshur për kullota
Lisat Trauç – arë në fushë
Lisi Rrumllak – arë në fushë
Lugj – livadhe afër fshatit

Maj Bare – arë në fushë

Mullejni Izetit – i vetmi mulli që ekziston edhe sot në fshat.

Mullejni Avzis – vend ku dikur ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Mullejni Elmazit – vend ku dikur ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Mullejni Feratit – vend ku dikur ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Mullejni Idrizit – vend ku dikur ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Mullejni Sefedinit – vend ku dikur ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Mullejni Xhaferit – vend ku diku ka pasur mulli, ndërsa sot nuk ekziston më

Te mullejt – vend ku ishin të përqendruar të gjithë mullinjtë përgjatë lumit të fshatit.

N'ibranik – livadhe në fushë

N'Kallugjere – vend me kullosa në fshat

Ndër Bare – arë në fushë

Ograde – arë afër fshatit

Padina – arë në fushë

Pesë Jasejkët – arë në fushë

Pupunca – arë në fushë

Ras'e Madhe – gur i madh në bjeshkë.

Ras'e Vuagël – vend në mal

Shnejki – arë në fushë

Stëni Arifit – stan në bjeshkë nuk ekziston

Stëni Azizit – stan në bjeshkë ende ekziston

Stëni Hajdar Agës – stan në bjeshkë

Stëni i Nafiis – stan në bjeshkë

Stëni Muratit – stan në bjeshkë

Sudanec – livadh në fushë
 Tashllejk – arë në fushë
 Te Çiesën Çeriep – vend ku kanë marrë dhë për të ndërtuar
 çerepë
 Te Kisha – Vend në fshat, ku dikur ka pasur kishë.
 Tërbaki – livadhe afër fshatit
 Tershnejca – arë në fushë
 Udh'a Qore – rrugë pa dalje
 Udh'e Breznës – rrugë
 Udh'e Guvidarit – rrugë në mal.
 Udh'e Hënit – vend në mal, ku supozohet se ka pasur han, i
 cili ka shërbyer si vend pushim gjatë rrugës për në Prizren, ku
 kanë bërë tregti.⁷
 Udh'e Ngusht – rrugë që lidh fshatin Sllatinë me fshatin
 Leshkë
 Udh'e Pajetishtës – rrugë
 Udh'e Tiarcës – rrugë
 Udh'e Varvarës – rrugë
 Udha e Ratajës – rrugë
 Uji Trëndafililit – burim uji në bjeshkë
 Uji Shllejshët – ujë i njelmët në fshat
 Uji Tharët – burim uji mineral në fshat
 Ullubres – arë në fushë
 Vaga – vend ku i kanë peshuar të lashtat
 Vejdhi Amakit – arë në fushë
 Vejdhi Lëmës – vend në fushë
 Vejdhi Manasterit – vend në mal
 Vejdhi Thatë – vend në fushë
 Vërteshta – vend në mal (një vend që e kap shumë era)
 Vnieshtët – vend rrëzë malit (janë të mbjellura vreshta)

⁷ Informator Murtezan Salihi, F, Sllatinë, mosha 68 vjeç.

Vuarri i Xhip(ës) – vend në fushë

Xhibre – vend malor ku i kanë ruajtur bagëtitë.

Zabieli Pqak – vend në mal

Zbiralla T'iepra – hapësirë e fshatit (vend me kullota)

Zbiralla T'puështra – hapësirë e fshatit (vend me kullota)

Shumica e mikrotoponimeve të këtij vendbanimi janë toponime me origjinë shqiptare, por nuk mungojnë edhe mikrotoponimet sllave dhe ato turke.

Literatura

1. Архив на Македонија. Турски документи за историјата на македонскиот народ. Опширен пописен дефтер Н.4, (1467–1468), Скопје, 1971.
2. Архив на Македонија, Турски документи за историјата на македонскиот народ. Опширни пописни дефтери од XV–век. Том III, Скопје, 1976
3. Sllatina, Syrja, E. (monografi), Çabej, Tetovë, 2005.
4. Kërçova, Qemal, M. Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike. Shkup, 2008.
5. ESRM: Вкупно население на Р.М. според изјаснувањето на националната припадност, по општини и населени места според пописите 1953, 1961, 1971, 1981, 1994, 2002. Скопје, Април 2002, Книга IX.
6. Вкупно население, домаќинства и станови, Скопје 2002. Книга
7. Durmishi, Izmit, Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antropiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit. Gostivar, 2008.

DISKUTIME

QEMAL MURATI

Hulumtimet onomastike në arealin linguistik shqiptar të Maqedonisë deri më tani janë varur kryesisht prej nismave individuale. Kërkime dhe studime të organizuara institucionale nuk janë bërë përpara. Duke njohur rëndësinë e kësaj problematike, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup ndërmori të organizonte këtë konferencë shkencore më temë “*Toponimia shqiptare në Maqedoni*”, me pjesëmarrjen e një numri të përfillshëm të studiuesve të kësaj problematike, me qëllim që të ndriçojë sadopak çështje dhe probleme aktuale dhe historike të kësaj materie. Toponimet kanë rëndësi jo vetëm shkencore për historinë e një gjuhe, për të kaluarën e një vendi, por kanë edhe rëndësi praktike për të tashmen, sepse toponimet janë shenja komunikimi.

Toponimet janë emrat e vendeve, e emrat janë gjuhë. Në qoftë se këtu hyjnë elementë regresivë për t'i ndryshuar arbitrarisht: anarkia, ideologjia, diletantizmi, sharlatanizmi, ashtu siç dhe kanë hyrë, ajo bëhet “toponimi e keqe”. E toponimia e keqe nuk i shërben askujt. Toponimia, sikurse dhe historia, nuk bëhet me urdhra e me sentimente retrograde dhe në të s'duhet ndërhyrë.

Ky tubim shkencor, në të cilin u paraqitën 14 kumtesa, jeni të bindur se do të sqarojë çështje e probleme me interes për studimet tona albanologjike, çështje onomastike të lidhura me drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e toponimeve dhe antroponimeve, me etimologjinë, e çështje të tjera shkencore, dhe se vëllimi që do të botohet me këto referime do të jetë një ndihmesë e denjë për studimet e onomastikës shqiptare.

Dëshiroj të them këtu diçka për obsesionin tonë me autoktoninë e me iliricitetin. Jo çdo toponim që merr ta vështrojë dikush mund të jetë i krahasueshëm me një burim ilir. Në këtë fushë hulumtuesit e onomastikës duhet të jenë shumë të matur, t'i njohin mirë rregullsitë e fonetikës historike të shqipes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike, kur marrin të bëjnë krahasime dhe etimologjizime të tilla të pakrahasueshme. Etimologjive “patriotike” u ka kaluar koha. I shumëdituri Lumo Skendo (Midhat Frashëri) qysh një shekull më përpara jepte këtë porosi: “*Do t’u këshillojnë atyre që dëshirojnë, që munden dhe që kanë aftësinë të okupohen me gjuhën dhe gramatikën, me etimologjinë dhe filologjinë tonë, të studiojnë njëherë shkrimet e Zotit Joki!*” Kjo porosi e tij ka vlerë të pakapërcyeshme edhe për sot. Veçse duhet të plotësohet edhe në këtë: nuk mund të bëhen etimologji të qëndrueshme vetëm me dëshira, pa u okupuar mirë me anën shkencore, pa i përbluar mirë parimet etimologjike të një radhe të dijetarëve të shquar si: Gustav Meyer, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti, Petar Skok, etj.

Për kumtesën e Mustafa Ibrahimit do të them dy fjalë. Te toponimi maq. *Saždevo*, shq. *Sheshdovë*, i rrethit të Prilepit, nuk mund të bëhet fjalë për një vjetërsi të këtij topiku në shqipen, sikundër lëkundet autori, për punë kinse të reflektimit të bashkëtingëlloreve nistore *s – sh*, sepse në fakt këtu kemi të bëjmë me një emërtim të ri, të mesjetës së vonë, që nuk mund të krahasohet me toponimet e periodes antike *Scupi: Shkup, Scardus: Sharr*. Te forma shqipe *Sheshdovë* kemi një asimilim regresiv, jo një formë të vjetër fonetike të alternimit *s–sh*.

Te topiku tjetër *Margari*, që te shqiptarët shqiptohet si *Mallgari*, është e qartë këtu që forma primare është *Margari*, e cila me disimilim dha *Mallgari*.

DISKUTIME

XHEMALUDIN IDRIZI

Në fillim e përshëndes organizimin e këtij sesiioni shkencor nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve të Maqedonisë. Shpresoj se me organizimin e sesioneve të këtilla ky Institucion shkencor do të vazhdojë edhe në të ardhmen.. Mendoj se duhet pasur kujdes në lidhje me interpretimin e toponimeve dhe mikrotoponimeve të Maqedonisë, veçanërisht të atyre viseve ku jetojnë shqiptarët.

Nga hartat e përpiluara topografike shtetërore të Maqedonisë nga Enti Shtetëror i Punëve Gjeodezike (sot – Agjencioni për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme të Maqedonisë) proces i filluar në vitin 2004 dhe përfunduar në vitin 2010, duket qartë se aty mungon procesi i mbledhjes dhe verifikimit të emrave dhe emërtimeve gjeografike, përkatësisht të toponimeve, Mungesa e tillë nuk është e rastit, por vjen si rezultat i metodologjisë së përdorur për shënimin e tyre. Shënimet janë marrë nga hartat e vjetra topografike të përpiluara dhe botuara nga Instituti Gjeografik i Ushtrisë së Ish-Jugosllavisë në Beograd. Këto shënime i janë nënshtruar verifikimit formal zyrtar nga Drejtoria për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Maqedonisë pa asnjë minutë punë fushore për mbledhjen dhe formimin e komisioneve profesionale për verifikimin e tyre. Krahës kësaj, mënyra e verifikimit nga Drejtoria për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Maqedonisë ka qenë vetëm formale, duke keqpërdorur të drejtën e tyre ligjore për verifikimin e toponimeve pa kurrfarë pune fushore e profesionale. Meqë kjo Drejtoria në vitin 2006 nuk posedonte bazë të të dhënave,

verifikimin e bënte nëpërmjet institutit Kërste Petkov Misirkov – Shkup, duke harruar se Instituti është institucion shkencor dhe se mund të japë vetëm mendim profesional dhe kurrigjë tjetër. Andaj ,sipas meje të gjitha hartat topografike të Maqedonisë për Shqiptarët janë të papranueshme dhe kërkojnë rishqyrtim.

Kujtoj që duhet bërë një projekt me të cilin do formulohen prioritetet e mbledhjes së toponimeve dhe mikrotoponimeve, kështu që do të formohet topoteka në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve të Maqedonisë, që do shërbente për hulumtime më të thella në këtë sferë.

811.18'373'21(497.7)(062)

TOPONIMIA shqiptare në Maqedoni: (sesion shkencor - 03.06.2013).
V. 5 / [kryeredaktor Zeqirija Ibrahimij]. - Shkup : Instituti i
Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, 2014. –
204 faqe ; 21 cm. - (Biblioteka Scupi)

Fusnotat nën tekst. - Bibliografia në artikuj të veçantë

ISBN 978-608-4653-14-1

а) Албански јазик - Топонимија - Македонија - Собири
COBISS.MK-ID 96106762